

Ardon Ardoni

85H-72.

H 64

TE
KILOMETRI
39

tregime

89.6.83 - 22

11 0 7
11 0 7

854-32
A64

Andon
Andoni

KOTITINA
IBRAHIM CERMA

TE
KILOMETRI
39
tregime



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

Redaktore

MAJLINDA KODRA

Kopertina

IBRAHIM ÇESMA

TE
KILOMETRI
39

trigjete



Recensues:

Naum Prifti
Spiro Gjoni

PO ÇELTE LULE AKACIA

Në fshatin tonë rrallë kishte ndodhur të bëhej dasmë në fillim të pranverës, por kurrsesi që nusja të ishte nga fshati përmatanë lumit...

Mjegulla e treqind a më shumë viteve na pati lënë në miqësi me fshatin matanë lumit, por me krushqi jo! Dhe kjo pati ndodhur që kurse prifti i atij fshati kishte ndërruar kamillafin e bardhë. Se si ishin ato ngjarje të vjetra, hajt e i gjej, po pati mbetur një hendek midis dy fshatrave dhe askush s'po e kalonte.

Kostën në e kishim fqinj dhe vetëm një vijë uji na ndante prej shtëpisë së tij. Kur ishim fëmijë s'ndaheshim kurrë nga njëri-tjetri. Ai kishte trup më të bëshëm se unë, megjithëse moshatarë. Dilnim mëngjëseve të verës me bu-

kë në dorë, futnim këmbët e z bathura në ujin e vakur të vijës dhe më thoshte Kosta:

— Mbushe gojën plot me bukë, që të bëhesh i gjatë si unë, mos e ha ashtu kic-mic.

Pastaj vitet rrodhën shpejt. Unë mbarova shkollën e mesme dhe Kosta u bë traktorist, ndaj dhe tani shiheshim më rrallë, vetëm mbrëmjeve, në vatrën e kulturës.

Kështu që mua m'u duk e çuditshme në fillim, kur ai solli nusen nga fshati përmatanë lumit, se kishim qenë shokë... Po ka disa gjëra që ndodhin në jetë dhe në to nuk mund të jetë i pranishëm as shoku më i ngushtë e as vëllai.

Ishte fund gushti. Brigjeve të lumit dhe përrrenjve ujëpaktë pikonin kokrrat e kuqe të lajthive. Rrallëherë bashkë me to rrëzoheshin edhe kapustrat e tyre. Bulkthi ende s'e kishte prerë ligjërimin netëve.

Kosta lëronte në tokat moçalishte në të dalë të fshatit, matanë lumit. Ishte buzëmbremje kur çau brazdë. Laraskat uleshin me vrull mbi plisat e dheut dhe kërkonin insekte, derisa ndienin pranë zhurmën e fortë të traktorit dhe largoheshin të trembura. Reja e pluhurit, që dilte nga zinxhirët, tani humbiste nën dritat e fuqishme të fenerëve.

Kosta lëroi gjithë natën. Iu gëzua mëngjesit në të aguar, kur u shfaqën dalëngadalë konturet e maleve, fëshfërinë gjethet nëpër drurë dhe kënduan bilbilat majë plepave, anës lumit, pastaj drejtoi traktorin në të majtë dhe doli

në stërnishtë. E mbushi mirë me gaz drejt gar-
dhit të shtëpisë së fundit, aty ku kishte lënë
pompat e vajit dhe të grasatimit. Do t'i kryen-
te shërbimet. Ia uli gazin traktorit, pastaj e fi-
ku. Në katin e sipërm të shtëpisë u ndie kërci-
tja e kanatit të dritares që u çel. Ai ktheu
kokën, por s'dalloi gjë.

«U prisha gjumin», tha dhe vuri buzën në
gaz. Iu kujtuan Zotollarët në fshatin e tij, që
kishin shtëpinë afër hangarëve të SMT-së. Edhe
ata i zgjonte mëngjeseve me traktor. Stërnishta
kërciste nën rrezet e para të diellit.

Në tremën e shtëpisë doli një vajzë. Ajo
qëndroi një çast pa luajtur vendit, me vësh-
trimin derdhur nga traktoristi, që, hipur mbi
zinxhirë, vajiste në brendësi të motorit, pastaj
zbriti shkallët. Pasi mbaroi vajisjen e të gjitha
pjesëve të motorit, Kosta mori çekiçin dhe fi-
lloi të godiste fort kunjat metalikë të zinxhi-
rëve. Tingujt e rrahjeve përndareshin tejmbanë
në fushës. Si mbaroi edhe këtë punë, lëshoi çë-
kiçin dhe u ul mbi zinxhirë. Ishin ballazi. Vaj-
za ecte nëpër kopshtin e mbjellë me perime.

— Pse s'po punon? — ia pati vajza pa të
keq, duke pandehur se traktorin e kishte të pri-
shur.

Vajza ishte e gjatë, me trupin e drejtë e të
mbushur. Flokët e zez i kishte mbledhur gër-
shet në fund të kokës. Dy tufëza prej tyre i
ishin ngjitur mbi tëmtha.

— Apo punon natën dhe fle ditën, — tha ajo.

— E po, edhe traktori ka nevojë të pushojë një orë, — tha Kosta.

Ajo drejtoi trupin. Në përparëse pati mbledhur kokrra të kuqe domatesh dhe specat jeshilë. Me një lëvizje të shpejtë të kokës i dha mbropa gërshetit që i kishte rënë mbi gjoks. Eci shpenguar drejt shtëpisë. Ai vështronte vajzën, pastaj dritaren që ishte hapur në agim. Dhe iu duk se ajo dritare ishte hapur prëj dorës së saj. Buzëqeshi. Vajza doli përsëri në treme. Në duar mbante një broke. U drejtua për te gardhi.

— Pije, — i tha Kostës, duke i zgjatur broken, — është dhallë i freskët. — Ai e vështrroi paksa i çuditur. Kërceu nga zinxhiri dhe eci drejt gardhit. Mori broken me duart tërë vajra dhe e piu me një frymë. Vajza e vështronte vjedhurazi.

— Gjak e dhjamë t'u bëftë, — uroi ajo.

— Të falemnderit, por nga dhalli nuk bëhet as gjak e as dhjamë, — tha ai buzagaz. Ajo qeshi. Zgjati dorën të merrte broken.

Pushi ngjyrë floriri mbi buzët dhe mbi tëmthat iu ngjye në të kuq. Mori broken dhe u nis drejt shtëpisë.

Kosta mbështeti duart mbi kangjellat e gardhit dhe ndiqte me bisht të syrit hapat e vajzës.

«S'ia mësova dot emrin», tha gati me zë. Çoi kokën dhe thirri:

— Si e ke emrin? — Po tani edhe kindi i fundit të fustanit të saj ishte fshehur pas derës

së shtëpisë. Ndjeu dëshirë për ta takuar edhe një herë atë vajzë, që e gostiti me një broke dhallë e që s'ia mësoi dot emrin.

Kaluan ditë me radhë. Atë vajzë e pa pastaj mëngjeseve, tok me shoqet e saj të punës. E kishte përshëndetur, dhe ajo, si gjithë të tjerat, ia kishte kthyer përshëndetjen.

Atij i pëlqente. Dhe shpeshherë, pa ditur dhe padashur, ajo i dilte në sytë e mendjes dhe as vetë s'e kuptonte pse i bëhej ajo pranë dhe brokja me dhallë të freskët atje, midis të dyve.

Më tej ai e takoi dhe kishin folur për shumë gjëra: për punën, për vjeljen e të vonave, për traktorin, për grupin e estradës së rinisë së fshatit, madje kishin folur sa e sa herë edhe për veten. Si padashur dhe heshtazi ata po hynin thellë te njëri-tjetri. Kështu, për Fatin, vajzën që e kishte shtëpinë në të dalë të fshatit, matanë lumit, traktorist Kosta, ndiente diçka që sa vinte dhe i rritej, diçka që i bëhej e dashur, e ëmbël, e njohur, sapo të guxonte e ta sillte ndër mend.

Dhe ai ia tha këtë Fatit... Si e qysh ndodhi...

Ata u morën vesh me njëri-tjetrin ashtu siç mund të kuptohen vetëm dy të rinj që dashurohen. Kosta ia tregoi këtë edhe nënës. (Babai kishte vite që i kishte vdekur.)

Mos kënkon të tallësh me nënën?

— Nënë, kjo që të them, është e vërtetë.

E ëma e kishte parë, vëngër, sa vetullat mend i ishin bashkuar me njëra-tjetrën.

— Pse, u mbaruan çupat e fshatit tonë, sa të ma sjellësh që matanë lumit ti? Me ta s'ka bërë njeri krushqi nga fshati ynë!

— Por a e di ti, nënë, që gjyshji tregonte se në fshatin matanë lumit shumë kohë më parë kemi pasur kushërinj, hynim e dilnim nëpër dasma?! — i kishte thënë Kosta.

— Mirë, këtë e di, po di që edhe yt gjysh s'mbante mend të kemi bërë krushqi me ta, të kemi dhënë e të kemi marrë nuse andej, — ia kishte kthyer Sofija.

Nënë e bir e kishin ngarë edhe herë tjetër këtë bisedë, por asgjë s'kishin ndryshuar, megjithëse herën e fundit Sofija i ishte lutur:

— Pse, more bir, pak vajza të mira ka fshati ynë? Dëgjoje nënën, bir, t'u bëfsha!

— Po edhe ajo është shumë e mirë, moj nënë, ja, do ta shohësh vetë!

Nënë Sofija ishte hequr mënjanë me shpresë se ndoshta herë tjetër, kur të hapej përsëri kjo fletë, do t'i thoshte (dhe, ç'do t'i thoshte, ajo i radhiste ndër mend një e nga një) që të lëshonte pe e t'i bindej, se një djalë të vetëm kishte nënë Sofija, s'kishte dhjetë, që t'i martonte përmatanë lumit, veç botës.

Po sikur të mos i bindej?!

Sofija e kishte shkuar ndër mend edhe këtë, dhe këtu mendimet i mpiheshin, i ngjisheshin e i trazoheshin, i ngurtësoheshin dhe besonte se «gjëma» do të ishte disi e largët. Gjersa t'i trokiste në derë, do të kishte kohë...

Dhe kur t'i ndodhte (dhe këtë e mendonte me dhimbje) në atë kohë që i dukej e largët, kujtonte se do t'i vinte ngadalë, shkallë-shkallë: hyrje-daljet, fejesa, dhe në fund fare dasma. Kështu do t'i ndodhte të mësohej, mbase ja ashtu, siç i ndodh njeriut të mësohet me një shtëpi të re... Po gjërat u rrokullisën ndryshe, shumë shpejt, sidomos për Sofijen.

Një mbrëmje, në fillim të pranverës, Kosta solli nuse nga fshati përmatanë lumit.

Në fshatin tonë kishin ardhur nuse me karrocë, nuse me kalë të bardhë, nuse me kamion e me taksi, po nuse me traktor s'kishte ndodhur kurrë!...

Kishte rënë mbrëmja kur u dëgjua zhurma e traktorit në shesh të fshatit. Dritat e tij fek-sën mbi urën me qemer e nëpër degët e blirit të porsaçelur, në krah të saj. Makina e autokinemasë qëndronte përfund shkallëve të vatrës së kulturës.

— Paska shfaqje filmi, — tha Kosta. Fati pohoi vetëm me kokë dhe nuk foli. Ndërkaq mbyllën dyert e traktorit e morën rrugicën drejt shtëpisë.

— Nëna do të ketë shkuar në film, — tha Kosta e bëri të shtynte kanatin e portës së li-ruar nga kllapa. Dhogëzat e portës së vjetër kërcitën.

Teksa po hidhte çapin për t'u futur brenda, Fati i kapi dorën. Qëndroi. Disa metra larg tyre ndihej një zhurmë si dënosa e dikujt.

— Shih aty, sikur është një fëmijë, — i pëshpëriti Fati mbështetur në krahun e tij. Kosta u afrua.

— Genti, ç'po bën aty?

— Humba biletën e filmit.

Fëmija mezi fliste nga dënesat e psherëtimat. Lotët i rridhnin mbi faqe. Fati i përkëdheli flokët. Kosta i lëshoi në dorë një monedhë, u ul galiç përballë tij dhe i tha:

— Shko në film tani dhe i thuaj teto Sofijes se i ka ardhur nusja.

Genti e vështroi në sy Fatin, që po i përkëdhelte flokët e i fshinte lotët mbi mollëza. Pastaj ktheu kokën nga Kosta.

— Mirë, — i tha dhe u lëshua vrapthi nëpër rrugicën e kalldrëmtë, drejt vatrës së kulturës.

Kosta e Fati qëndruan pak kohë duke ndjekur e ndier vrapin e fëmijës nëpër terrin e natës. Në anë të fshatit dëgjohej kënga e qyqes. Frynte juga dhe guisnin degët e arrës aty pranë.

Mbi flokët e tyre shkundeshin petalet e bardha të luleve të kumbullës, që zgjaste degët mbi çatinë e llamarintë të portës. Të dy u futën brenda dhe ndezën dritat e shtëpisë.

Genti, ende pa hyrë mirë në sallën e kinasë, ia buçiti me zërin e tij:

— Teto Sofi, teto Sofi, moj, Kosta e sollinusen.

— E zeza!... — tha ajo me zë dhe brofi në këmbë. Mbi perden e bardhë të filmit u projektua trupi i saj.

— Kokën, kokën, — thirrën disa djem nga fundi i sallës. Sofija eci drejt daljes.

— Mos bëjë ndonjë të pabërë! — Ishin Marta e Lirika që u flisnin grave përreth. E ndoqën pas.

Sa mbërriti në oborr, Sofija mbylli portën me shpinë, shtyu llozin dhe u ul galiç pas gurit të rrumbullakët. Merrte frymë nxituar.

Zhugulli i inatit iu çua deri në fyt e pastaj zbriti me dënesat e lotët nëpër faqet e rreshkura.

Pse nuk e kishte dëgjuar i biri? Pse? Një nënë vetëm një kishte, për hatrin e saj të mos ishte ngatërruar gjer përmatanë lumit! Donte të qante, të ngopej, të shkulte inatin, dohte një vesh t'ia thoshte ç'kishte në zemër, donte një dorë a një gojë t'i merrte krahun...

Ata të dy venin e vinin nëpër dhoma, por Sofija s'po i shquante dot nëpër perdet e lotëve.

Hoqi llozin e portës dhe e çeli me vull. Donte të dilte në rrugë. Psherëtinte e fshinte lotët me mëngën e fustanit.

Në rrugën e vatrës së kulturës u dëgjuan zhurmë e zëra. Vinin drejt saj. Qëndroi një çast pa lëvizur, pastaj, kur zhurmat u afruan

edhe më, u hoq brenda portës e trembur. E shtyu me duar, por llozin nuk ia shkoi. Lotët, që i rridhnin nëpër lukthin e fytit e nëpër faqe, iu shtuan.

E kuptonte se ajo që kishte hyrë në shtëpi s'ishte një flutur, që ta përzinte me qëllesat e fshesës, as manare, që ta nxirrte jashtë e t'i mbyllte portën... Ishte njeri, ishte vajzë, që ia kishte sjellë i biri...

Zërat në rrugë po afroheshin pranë portës së saj. Kishte mbetur përfund shkallëve. I biri doli në krye, zbriti dy herë nga tri shkallë dhe e mori të ëmën në gjoks. Sofija s'e dëgjoji ç'tha. Mbështetur në gjoksin e tij, dëneste me lot.

— Përse ia bëre nënës, kështu, more bir, përse?! — pëshpëriste me zë të mekur, pa e vështruar të birin. Kosta i puthi flokët në tëmtha dhe e luste të pushonte, se nuk duhej, nuk bënte të qante. Sofija s'ua vinte veshin fjalëve. Ashtu hynë në dhomë.

Nëpër lot pa Fatin, me faqet e kuqe e me sytë përdhe, që po i vinte përballë.

Në oborr u dëgjuan tingujt e një kitare dhe zëri hokatar i Tashos, që thërriste të zonjën e shtëpisë.

Sofija fshiu lotët me përparëse dhe i bëri shenjë Kostës: «Nuk dal unë, po dilni pritini.»

Doli Kosta. U çapit edhe Fati pas tij. Sofija e pa vjedhurazi. Fytyrën e kishte të rrumbullakët, me mollëzat e faqeve të kuqe, me sytë të zez e të lëngëzuar. Cepat e buzëve i ishin

shtrirë dhe i formonin nga një gropëz të vogël në faqe. Në dhomën ku rrinte Sofija u derdhën Neta, Lirika dhe kunata e madhe e Sofijes, Marigoja.

Sa i pa në derë, Sofija rigoi lotët mbi faqe.

— Hajde, mjaft bëre si fëmijë, — iu shkreh Marigoja, — posi, posi! Nusen ma paske si dritë, si yll ma paske. — E mori Fatin në qafë.

— More, m'i lumtë Kostës, e bëri si burrat! — tha një mesoburrë tek hynte brenda në dhomë.

— Ku i vë karamelët? — pyeti Neta Sofijen.

— Në kuzhinën jashtë, në sënduk.

— Shko merri, nuse, — iu kthye Neta Fatit.

— Nuk i gjen dot nusja, — tha Sofija dhe u çua. Kaloi korridorin dhe bëri të humbte poshtë shkallëve.

Tashoja, sa pa Sofijen që zbriste shkallët, i thirri:

— Sofi, Sofi, moj, dale, se kam një histori me çarqe, dale!

— Ja, ja erdha, — tha Sofija dhe mbeti në prag. «Kushedi ç'romuze do të këputë, — mendoi me dhimbje. — U bëra dhe unë për romuzet e Tashos», dhe lotët gati përsëri po ia mjegullonin sytë.

— Si është ajo historia me çarqe, o Tasho, — dëgjoi ajo një që pyeti.

— Desha edhe unë që ai çarku im të më zinte një zog, — filloi, — se s'ka çark që të mos zërë zog, hë?! E po mirë. Unë desha të më

zinte ndonjë bilbil apo thëllëzë, që të ma mbushte shtëpinë me këngë e cicërima, me zogj plot. Do ti atij çarkut tim i vërtitej një rebeckë. Me zor e përzura, ç'e desha unë rebeckën?! Një herë m'iu vërtit ca kohë një laraskë, dhe nga ato laraskat pa bisht. Hajde edhe këtë mezi e përzura. Gjersa një ditë ra brenda një mëllenjë. Vërtet mëllenjën s'e kisha për këngë e cicërima, por ishte mëllenjë, ama, jo laraskë, e kështhu m'u mbush mendja e mora në shtëpi.

— E po sipas çarkut edhe gjahu, — ngacmoi një djalë.

— Hëhë, se edhe nusen edhe djalin shumë të mirë i ke, — i tha e shoqja, që i rrinte në krah.

— Të mirë, moj, i kam, s'them, — tha Tashoja, — se ka edhe çarqe që zënë rebecka e laraska, por ka edhe çarqe që zënë thëllëza, ama. — Në fjalët e fundit i rëndoi zërit dhe pa nga Fati. E uroi dhe e piu gotën me fund. U trokitën gotat me radhë.

Sofija u mbush me frymë. «S'e paska gojën të ligë sot, shejtani», mendoi për Tashon.

— Karamelet, — Mori nga sënduku shaminë me karamele dhe ia zgjati Lirikës.

Hynë dy-tre veta në oborr, djemtë e fshatit. Përballë tyre zbriste shkallët një mesoburrrë.

— Hë, hidhuni, hidhuni, se s'është thellë, — u tha të rinjve kur u kaloi pranë, — merrni mësimë nga Kosta...

Sofija ndjeu të ftohtë. U drodh. Fërkoj kra-
hët me pëllëmbët. Mpirja sikur po i arratisej
poshtë gjymtyrëve. Grupe të tëra njerëzish po
vinin drejt sokakut, për te shtëpia e dasmës.
Kineasti, në sallën e filmit, po mblidhte kab-
llot e telat. I vendoste në arka dhe i fuste në
makinë. Pas pak u dëgjua zhurma e autokine-
masë që largohej.

Sofija eci drejt kopshtit. Në fund të tij qën-
droi. Drita elektrike ndriçonte tërë skutat e obo-
rrit. Dhe hija e drurit të vjetër të akacisë ishte
fare e dobët. Sofija e vështroi drurin pa ia nda-
rë sytë.

Sa e sa herë i kishte thënë i biri:

— Nënë, ta presim këtë akacie, është shu-
më e vjetër, ç'e duam?! — Dhe ajo e kishte
kundërshtuar.

— Po lëre, more bir, pse ta presim, lëre, se
bën lule të mira!

Tani në degët e akacisë vëshinin gjethet e
thata që nga vjeshta e kaluar. Gjethet i kishin
rrahur erërat e dimrit, shiu, bora dhe koha ki-
shte bërë të sajën, por ato ende nuk kishin
rënë. Dhe nuk mund të thoshe as kur do të bi-
nin; pas një dite, dy, tri, apo pas një çasti. Po
nënë Sofija e dinte që ato gjethe do të binin,
se nën to po çelte sythi i blertë lulen e bër-
dhë të akacisë me erë të mirë...

THYHEJ AKULLI NË LUME

Çdo mëngjes Dhimitri del nga shtëpia me duart futur në xhepat e dollomasë blu, të dalë boje te mëngët e te supet. I gjatë, me flokët të krehur me kujdes, me fytyrë të porsalarë, të përskuqur nga uji i ftohtë, pa përsëndetur njeri, arrin në majë të urës me qemer dhe lëshon si padashur një kollë të thatë. Lë pas magazinën e parë. Ngadalëson hapin dhe, teksa zë të afrohet te magazina e dytë, ecja e tij ndërrohet papritur. Tërhiqet anës rrugës, ecën ngjitur me gurët e avllisë, gjithnjë me duart në xhepa, dhe të duket se atë copëz rrugë e bën duke u zvarritur. Te dera e magazinës zakonisht e presin gratë për të filluar punë.

— Mirëmëngjesi, — e përsëndetin ato. Ai ua kthen me një zë të hollë e të mekur. Kë-

shtu ndodh gjithmonë. Ato përshëndetin të parat, e pastaj Dhimitri. Ai çel portën dykanatëshe të magazinës. Gratë hyjnë brenda. Kështu fillon një ditë pune. Peshuesit i vijnë gjithmonë me vonesë, e ai rri e pret te dera e jashtme, mbështetur mbi kasën e përbaltur, me sytë nga rruga. Tek i sheh të vijnë, ul kokën e vështron përballë, në arën me kërcejtë e zhveshur të duhanit, ku qëndrojnë herë-herë harabelat. Ka kohë që gratë ankohen për vonesën e peshuesve. Ai i dëgjon qarjet e tyre që e cimbisin në shpirt dhe i vjen t'i përvishet vetë asaj pune... Ndërkaq, i pari nga peshuesit, Vangjeli, arrin në derë dhe lëshon vetëm një: «He, o, o, o.» Ai nuk arrin t'i përgjigjet. Pas Vangjelit vijnë Gjergji dhe Artani. Ende s'ka ardhur Peçi. Dhe kjo e nervozon disi. Kur më së fundi edhe Peçi duket te bërryli i rrugës, Dhimitrin e mbulon të kuqtë në fytyrë.

— Më ndje, o magazinier, — fillon Peçi me lajkat e tij tashmë të zakonta, — e pata një hall dhe u vonova... — Ndërsa ai vazhdon me lutje e pendesa të thella, Dhimitri ul sytë e në shpirt provon dhimbje të madhe. Peçi, pasi ka përfunduar një varg përgjërimesh, hyn brenda. I mbetur vetëm, Dhimitri mbushet thellë me frymë i lehtësuar.

«Sikur të hynte drejt e brenda, pa thënë asgjë, sa mirë do të qe, — pëshpërit ai gati me zë, — sa mirë, sa mirë!» «Pastaj bën gati pasqyrën e punës ku do të regjistrojë emrat e punëtorëve.



Puna e parë që bën pas kësaj, është të hipë te peshorja. Në peshore hipën rregullisht, çdo ditë. Punëtorët thonë se kështu kontrollon peshën, pavarësisht se nuk shkruan gjë në bllokun e vogël varur pas saj, ku edhe shkronjat «verifikoni peshën» janë mbuluar nga pluhuri dhe merimangat.

— Dhimitër! — thërret një nga peshuesit pas qoshes së magazinës. Sakaq ai shkon ku e thërrasin.

— Ku do t'i vendosim këto patatet e cilësisë së dytë, — thotë Gjergji.

Ai fërkon mjekrën me dorë. Ato duhen transportuar deri te dera e jashtme, nja pesëdhjetë metra larg. Hesht. S'ka asgjë për t'u menduar, ata thasë duhen çuar aty te dera dhe vetëm aty, por... sikur peshuesve të mos u pëlqejë urdhri?...

— Hë, fol, — thotë tjetri, — unë them t'i lëmë këtu në cep, — dhe tregon nja dy metra më tej një vend të ngushtë.

— Po mirë, lëri, — thotë Dhimitri dhe shton me mendje: «Hë, pa më vonë gjene e gjejmë.» Pastaj shkon të qetohet në kuvlinë e tij të ndarë me mur tulle, pas derës, në hyrje të magazinës.

Gjithnjë e ngacmon në vetvete rrëmuja e krijuar ditë më ditë në magazinë, mirëpo... hëm... «një ditë do t'i vijë fundi». Ai e di që nëpër thasët e Lirikës e të Dines ka edhe patate të prera, të kalbëzuara e jashtë standardit,

por nuk i jepet të ulet e t'i kontrollojë. Pa edhe kur ndodh që e bën një gjë të tillë, mend i merret fryma, skuqet në fytyrë, e aq më tepër kur e di që duhet të thotë: «Nuk ke punuar mirë», gjë që s'ka ndodhur kurrë. Ai mund të thotë vetëm kaq:

«Sikur ta shihnit pakëz këtë thesin, se sikur»...

Që të urdhërojë, është gjë që s'mund ta bëjë. Ai nuk të thotë dot «bëje këtë punë», por, «po të duash, sikur ta bëje këtë punë?»... dhe ndërkohë jo vetëm zëri, por edhe shprehja e fytyrës, përdredhja e gishtërinjve, tregojnë se ndihet i lumtur që ia ka dalë mbanë e s'ka thënë asnjë fjalë të rëndë, të vrazhdë e urdhëruese.

Kur i ankohet ndonjë nga punëtorët se dje, për shembull, nuk ishte shpërblyer sa duhej, ai i përgjigjet:

— Mirë, mirë, do ta shikoj edhe një herë, mund të jetë ndonjë gabim, — kurse në vetvete është fare i bindur që nuk mund të ketë asnjëfarë ngatërrese.

Qëllon ndonjëherë që Peçi t'i afrojë një dëftesë, ja, «ditën e shtunë ti kishë harruar të më regjistroje në punë...»

Dhimitri skuqet deri te veshët.

Ai e di mirë se kjo dëftesë është e rreme, por, ta kundërshtojë e t'ia përplasë në fytyrë të vërtetën këtij hileqari e dembeli, është gjë që s'bëhet. Tek mendon që mund ta bënte edhe

këtë veprim, një dridhje e lehtë i përshkon trupin, bulëza djerse i dalin mbi ballë. Firmos shpejt e shpejt dëftesën e vënë përpara dhe atëherë e ndien veten të lehtësuar.

Në kuvlinë e tij kalon një pjesë të mirë të paradites. Një tryezë e një stol. Në një qoshe të tryezës një vazo e vogël, në të një lule e tharë. I ka prurë që ditën e parë, kur filloi punë si magazinier. E kishte rregulluar si në një ditë feste. Kishte kujtuar se magazina e tij do të ndriste nga rregulli e pastërtia, se gjithë njerëzit që do të punonin aty, me mirësinë e tyre, do të ndihmonin që ky rregull të mos prishej e se çdo gjë do të ishte e gëzueshme, si në një ditë dasme.

Teksa vështron diku me sy të mbërthyer, me cigaren që gati po i djeg gishtat, dikush thërret:

— Pushimi i drekës!

Ai largohet i fundit. Kyç magazinën, zvarritet anës avllisë duke zhgërryer dollomanë e punës. Pasi ha drekën, del te sofati i portës së shtëpisë. Qëndron për një kohë të gjatë. Te qoshku i shkollës ndihen zërat e fëmijëve të kopshtit dhe edukatorja që i përcjell. Çohet edhe ai. Mbi urë lë pas fëmijët e zënë dorë për dorë, pastaj magazinën e parë e, kur sheh se te dera e magazinës së dytë e presin tri gra, nxiton anës murit.

E pyet Lefteria:

— Me se hëngre drekë, o Miti?

«Nuk është mirë të mos tregosh se me se

ke ngrënë drekë.» Por ai e ka mendjen pak të turbullt dhe ia kthen më kot:

— Me patate.

Gratë hyjnë brenda.

Në pasditet e vona gjithmonë luan domino me shokun e tij të ngushtë, Ilin. Dhe, megjithëse luan rregullisht, (këtë e tregon Ili), deri tani nuk ka mundur të fitojë një herë, sepse, edhe kur kryeson deri në fund të lojës, dorën e fundit e humbet. Dhe të lë kështu përshtypjen sikur i vjen turp të fitojë. Pastaj, në mbrëmje vonë, del nga shtëpia, lë në të djathtë çezmën e mbuluar me llamarinë, kalon rrugicën në të dalë të fshatit dhe futet në oborrin e shtëpisë së Verës, nga pas. Atij i vjen zor ta shohin rrugëve të fshatit, kur shkon tek e fejuara.

Hyn brenda dhe, ashtu i druajtur e i turpshëm, e tjerr muhabetin me vjehrrin te koha, te të vjelat e vjeshtës. Qëllon si padashur të diskutojë ndonjëherë për kontabilitet, si ekonomist i mesëm që është, dhe atëherë flet tërë pasion. Kalon kështu një copëz kohë të mirë. Kur bëhet gati për të dalë, Vera matet ta përcjellë deri tek oborri, megjithëse rrallë ka mundur ta bëjë këtë gjë, pasi Dhimitri ka kapërcyer pragun e portës së jashtme, ndërsa Vera ende kërkon në korridor pantoflat.

Kur ai arrin te bërryli i rrugës, dëgjohet nga pas kërcitja e shulit metalik në bravën e portës që ka mbyllur Vera. Ajo është një nga

ato kërcitjet që ngjajnë me një qortim të largët.

Kjo është e përditshmja e magazinier Dhimtrit, që porsa ka përfunduar shkollën e mesme të mbrëmjes. Dhe ai mendonte e ishte i sigurt se tashmë detyra e magazinierit i takonte, e kishte hak, e meritonte. Le ta gëzonte, meqë e kishte me djersë.

Bënte ftohtë në ditët e fundit të janarit. Akulli në dy anët e brigjeve të lumit ishte bërë një pëllëmbë. Harabelat kur e kur uleshin e rrinin më nge mbi degët e ferrave përballë magazinës. Tek-tuk anës lumit, në ledhin e ndonjë mezhde, mëllenjat çukitnin tokën e zbuluar nga bora. Edhe atë ditë gratë e prisnin përballë derës së magazinës. Por sot midis tyre ndodhej Vera. Pas organizimit të ri ajo do të punonte në brigadën që mbulonte edhe magazinën e tij. Gratë u futën me zhurmë. Ai mbeti te dera. Kaluan tufat e dhenve. Rruga e mbuluar nga bora u «qëndis» me gjurmët çifte të thundrave. Pas tyre qeni i madh leshtor çapitej ngadalë, përkudëj si dash. Si ndoqi me sy tufën e dhenve, derisa ajo doli te brigjet e lumit, u fut brenda. U ul në stolin përballë tryezës dhe ndezi një cigare. Në derën e hapur mbetën varur dryni e çelësat. Frynte erë. Dera

hapej e mbyllej dhe çelësat e varur në bravë fërkoreshin me xhamin e dritares, duke nxjerrë një zhurmë që të gërvishte në bark.

Sa herë dëgjonte gërvishtjen, ai shtrëngonte nofullat. Zhëk-zhëk çirreshin metalet. Deri në skutat më të largëta të magazinës dëgjohej ai zhëk-zhëk.

— E po si i duron ata të shkretë çelësa, — ia bëri Lirika, — na gërryen zorrët!

E thirrën. U çua dhe shkoi.

— Pa shiko, si i kam ndarë unë këto patate? — tha Vera.

U përkul mbi grumbullin e thasëve të saj.

— Aha, — bubulliu zëri i Gjenkës lfaqe të gjithëve, — nusja mësohet që në shtëpi, se ç'u kuptua që është nuse.

Gratë e vajzat ia dhanë gazit. Dhimitrin e mbulojtë kuptë në fytyrë.

Qeshte dhe Vera: Atë mbrëmje, kur e përcolli deri te porta, Vera i tha:

— Shumë rrëmujë e kishe punën në magazinë. Thasë të hedhur gjithandej, kapule më patate të shkelura, gratë punonin ku mundnin! — Ai heshte. Si për të tërhequr vështrimin e tij mbërthyer diku në errësirën e asaj nate, ajo i këpi dorën dhe ia mbajti për një kohë në të sajën.

— Nuk bën kështu... Nuk bën... — thoshte zëri i saj i butë.

Atij sesi iu duk. Kurrë s'kishin ndenjur kaq gjatë aty në oborr. Zgjatëshin hijet e murme

të shtëpive të mbuluara nga bora që binte me flokë të mëdhenj. Degët e arrës aty pranë kërcitnin me zhurmë. Gurgullonte uji i lumit. Flokët e Verës ishin zbardhur. Ai guxoi, u përkul dhe e puthi...

Pas pak u ndie zhurma e përhershme e shulit metalik që mbyllte portën, po këtë herë ajo qe një zhurmë e zvargur, e ulët, gati si e penduar pse po mbyllej.

Mëngjesin e së nesërme, në magazinë, gratë diç po kuvendonin me njëra-tjetrën.

— Magazinier, — thirri që atje tej Dina. Ai u afrua.

— Dje unë kisha tridhjetë e tetë thasë të mbushur me patate e jo njëzet e tetë, sa ke shkruar ti, dëgjove, — bubulliu zëri i saj, — dëgjova thuaj!

— Ta shikojmë, mund të jetë edhe ashtu siç thua ti, — ia ktheu Dhimitri.

— Jo ta shikojmë, po shkruaji tani, fët e fët, dhjetë thasë për ditën e sotme!

Ndërkohë arrin aty njëri nga peshuesit, Vangjeli.

— Sa thasë kishe dje? — i drejtohet ai Dinës, mu imbi arrëzë të qafës.

— Aq sa thashë... — ia ktheu ajo e befarsuar.

— Kujt ia thua këto, mua? — Zëri i tij ngjan me gurgullimën e përrenjve në moçadishtë.

— Këtij po, mund t'ia hedhësh, — thotë du-

ke e shkundur për supesh Dhimitrin, — por jo mua, dëgjove? Dëgjova thuaj!

Dhimitri hesht me sytë përdhe. Me vetullat e zeza të bashkuara mbi hundë e duke sharë me vete, Vangjeli drejtohet nga hyrja, te stiva me thasë të mbushur. Gratë shpërndahen e zënë vend.

— E po edhe njëzet e tetë thasë ndofta ishin gjene, — pëshpëriti Dina e u nis pas shoqeve, Pa luajtur vendit, ai mbeti aty i ngurtësuar.

«Më mirë të mos kishte folur fare ky Vangjeli, më mirë, më mirë», — pëshpëriti nën zë për disa çaste.

Punëtorët kanë filluar punë. Vera, me duart e mbledhura mbi gjunjë, ulur në ndenjësën e saj, qëndron pa lëvizur. Diku, pranë saj, ndihet një zhurmë, tërëk-tërëk. I dukej se ajo fshikull që për të. Të kuqtë ende s'i kishte ikur nga fytyra. Tërëk-tërëk e mierziste zhurma. Ajo mendohej të sillte ndër mend më hollësi atë që kishte ndodhur pak më parë.

«Si e bëri veten ajo Dina, — i thoshte zëri i brendshëm. — Por edhe ai fare buf u tregua.»

E shante me mend dhe nuk kishte asnjë dashirë t'i përmendte emrin. Tërëk-tërëk u dëgjua sërish zhurma, këtë herë më afër. Ajo ktheu kokën. Një mi i madh mendohej të brente me dhëmbë një patate mes grumbullit. Patatja rrokullisej, rrokullisej edhe miu pas saj, me atë zhurmë e pamje të neveritshme.

Disa kokërra të vogla u rrokullisën deri në fund të kavaletit, edhe një tjetër, një më e madhe, e bashkë me të u rrokullis edhe miu, që u zhduk diku, i trembur nga rrëmuja. Verës i erdhi për të qeshur me zë. Pastaj u përmend. Filloi punë. Tërë atë ditë diçka ndiente në vet-vete. Tek shihte Dhimitrin që vinte e vinte poshtë e lart, pa vënë re asgjë, me duart në xhepat e dollomasë, i bëhej sikur një valë e nxehtë gjaku i vërshonte nga kraharori, i ngjitej lart në fyt e i rrihte tëmthat si çekan. Atë mbrëmje, kur e përcolli deri te porta, as njëri, as tjetri nuk folën. Bënte ftohtë. Bora ishte e ngrirë nën këmbët e tyre dhe të dy sepse vështronin po aty, nëpër gjurmët. Dhimitri lëvizti. Tërë-tërë u ngjesh bora. Verën e përmendi prekja e tij e lehtë në dorë. Ajo s'lëvizti.

— Të të puth një çikë, — tha ai.

— Jo, — tha ajo dhe tërhoqi dorën me shpejtësi.

— Mirë, si të duash, — tha ai me po atë ton, — natën e mirë. Vera shtyu portën pas tij. Duart iu lëshuan poshtë si pa jetë.

«Jo», kishte thënë. As vetë s'e kuptonte se pse nuk e kishte lënë ta puthte. Dhe sa qetë ia kishte kthyer ai: «Mirë, si të duash.» Tek e sillte ndër mend, tani që kishte rënë në shtrat, atë fije zëri, i cingëriseshin nervat. Pastaj sërisht iu kujtua miu që rrokullisej së bashku me

ato dy patatet e vogla. Shtrëngonte qepallat në shtrat, po gjumë s'i vinte.

«Kushedi sa mund të jetë ora», tha me vete. Pastaj i foli pranë një zë i brendshëm: «Në fillim qetësia e tij më gëzonte pa masë, pastaj sikur më pëlqente kur gjithçka e bënte duke më pyetur mua, pastaj... Hëm, pastaj, ai është një nga më të humburit e botës, ja kjo është e gjitha», përfundonte zëri i saj. U mundua të flinte.

«Po ti ç'do të bësh me të?» i tha zëri.

Ajo hapi sytë. Errësirë.

— Vërtet, ç'duhet të bëj unë, — tha gati me zë dhe u çudit si nuk i kishte shkuar ndër mend më parë kjo gjë.

«Ai është djalë i zgjuar, por ja që nuk mund të... — Zëri nuk gjente dot fjalë të përshtatshme... — Nuk mund të...»

«Kushedi sa është ora, duhet të fle, tani duhet fjetur.» Vetëm kur filloi të agonte e zuri gjumi.

Në mëngjes Dhimitri përcolli për në depot e shtetit një makinë ngarkuar me patate të cilësisë së parë. Pastaj në depo u vendos prapë ajo çrregullsia monotone e ditës. Gjithçka mbeti si më parë, stivat e thasëve (veç atyre që ishin ngarkuar në makinë), peshorja bojë jeshile, dy kapule me patate të shkelura, thasë bosh të hedhur e të varur diku nëpër trarë, lulja e tharë mbi tryezë... Vetëm letrat e fle-

tëdaljeve ishin shtuar edhe më në një cep të kuvlisë.

Kishte kaluar pjesa më e madhe e ditës. Dielli kishte ngrohur murin e pasmë të magazinës, megjithëse dita po thyhej. Frynte juga. Diku në kodrat e fshatit ndihej zëri i fëmijëve që rrëshqitnin në borë. Era përkundte majat e drurëve të bardhë të mështeknave. Nga strehët këputeshin akuj në formë thikash me majë e binin poshtë.

Dhimitri i kundronte më nge këto të gjitha, mbështetur me shpinë në murin e ngrohur mirë. Në fund të rrugës u ndie zhurma e motorit të një makine. Ajo uturoi drejt magazinës.

«I kthyen», mendoi ai me një frikë të përzier me keqardhje. U fut në magazinë. Nuk diti ç'të bënte. Nga makina zbritën përgjegjës Nesti, agronom Aliu dhe një burrë i gjatë hijerëndë, me vetulla të rrëzuara mbi sy, veshur me një mushama të zezë.

«Ky do të jetë grumbulluesi», tha me vete Dhimitri dhe hapi rrugë.

— Ju vafte mbarë, — përshëndetën ata thujtë njëri pas tjetrit. Gratë luajtën vendit. Pastaj u bë një heshtje e shkurtër.

— Ti je magazinieri? — pyeti burri me mushama.

— Po, ky është, — u përgjigj Aliu më parë.

— Këtë makinë që kishe nisur për në depot e grumbullimit, e ke jashtë standardit shtetëror, — tha grumbulluesi.

— Ku e ngarkove këtë? — tha Nesti. — Se mos ke ngatërruar stivat, o derëbardhë.

— O po ç'të ngatërruar! Lesh e li i ka bërë të gjitha! Ke punuar pa përgjegjësi, more djallë, pa kujdes, — shfryu agronom Aliu. Ai ecte, përkulej mbi thasë, mbushte duart me patate të prera, të kalbura e jashtë standardit.

Peshuesit po shkarkonin makinën.

— Mirë, moj, lëre ky që e ka bërë lëmsh, por edhe juve si s'jua ka vrarë syrin kjo gjendje? — iu kthye grave përgjegjësi i sektorit. Ato heshtnin.

Vera kishte ulur kryet.

«Këto i thotë për mua e për asnjeri tjetër», i thoshte zëri i brendshëm.

— I kemi thënë, nuk punojnë të gjitha një-lloj, — fliste një nga të brigadës, — po ku ta di unë, ore ti, këtë sikur i vjen turp t'u thotë se nuk e kamë punën mirë.

— Po kjo duket sheshit, bre! — ia bëri Vangjeli, që, së bashku me peshuesit e tjerë, qëndronte përballë të gjithëve. — Ai është sjellë si shqerrë me këto, pa, të isha unë në vendin e tij, dhe e shihnin!

— Hë, hë, pa, — ia bëri Dina e ngriti zërin, — shumë mirë na ka vajtur puna, — tha duke lidhur shaminë me dy cepat në tëmtha, — por është dhe vendi i ngushtë, ç'të bëjë, i ziu Dhimitër, hë?..

— Pa edhe ndonjë do ngatërrohet, sy është, — ia pasoi Lirika.

Vera po rrinte si në gjemba. Fjalët e Dinës e të Lirikës e pickuan keqas. Ajo e dinte mirë pse e bënin ato një mbrojtje të tillë. Vështroi Dhimitrin, që rrinte gojëkyçur, mbështetur në direkun që mbante një tra të çatisë.

Dëgjohej zhurma e krimbave që brenin atë direk. Verës i hipi gjaku në kokë. Diçka duhej të thoshte edhe ajo. Iu duk se të gjithë pritnin të fliste edhe ajo.

— Ai nuk është për këtë punë, — tha Vera me një frymë.

— Si?! — tha përgjegjësi, që dukej se nuk e dëgjoji mirë.

Të gjithë kthyen kokat nga Vera. U përmend edhe Dhimitri. E pa me habi, me trishitim. Vera e vështroi drejt në sy dhe tha me zë më të fortë:

— Nuk është për këtë punë ai!

— Duket! Duhet t'ia lërë vendin një tjetri, — tha pas saj Aliu.

U ndie zhurmë. Kanati i portës së magazinës kërciti i shtyrë nga era. Mëllenjat kërcenin nëpër degët e thara të manaferrave e të trëndafilave të egër.

— Qetësi, qetësi, — tha Nesti, — Vera më duket ka të drejtë, por të shohim, brigada ç'thotë?

— E ç'do të themi ne më tepër! — tha Dina plot kuptim. «Gjersa ia tha vetë e shoqja?» lexuan të gjithë në vështrimin e Dinës.

— Po, po, ne s'kemi ç'themi, — tha një

grua tjetër, — ama edhe disa nga ne kanë shirë dhe ia kanë hedhur që ç'ke me të!

Vera dëgjonte e heshtur. Tani gjithçka ishte vendosur. Folën edhe të tjerët. Si padashur ata e kishin bërë një mbledhje.

Dhimitri mbylli derën e magazinës për të fundit herë. Te qoshku i rrugës e priste Peçi. U shëmtua në fytyrë.

— Ah, i dashur Dhimitër, — filloi Peçi me të tijat, — ah, si është kurdisur kjo dynja. Sa keq më vjen. Po ju duhet ta dini se unë...

Dhimitri u kollit pa ia vënë veshin dhe diçka mërmëriti nëpër dhëmbë pa kuptim.

— Urdhëro, — tha Peçi.

Dhimitri qëndroi. E vështroi me ngulm.

— Si e ke hallin? — e pyeti më në fund.

— Hë, po, — tha ai duke e ulur zërin edhe më, — ja, më ka mbetur një dëftesë e pafirmosur nga ana juaj...

Dhimitri e zgjati dorën dhe e mori dëftesën pa e parë. Pastaj, po ashtu, e grisi copa-copa. Shtrëngoi dhëmbët, që i kërcitën, dhe i shfryu për herë të parë në jetën e tij me zë të lartë:

— Turp, turp të kesh, delenxhi, qelepîrxhi!

— Dhe hoqi më tej me nxitim, në anë të rrugës, mbi dëborën e pashkelur.

Këtë grindje të shkurtër e dëgjuan edhe Vera me Gentën, që ecnin para tyre. Vera ndjeu të dridhej lehtë. «Mbase nga të ftohtët», mendoi. Mbajti hapat. Qëndruan dhe pritën. Sa ki-

KUR SHKRUAJA PËR DEMKËN

Ditët e fundit të marsit bëri ngrohtë. Bari ndanë gjerdheve rroniti fletëzat e thata dhe po çelte krupëzën jeshile në dheun e ngrohur nga dielli. Dëbora, si copa letrash të shpërndara nga era, mbeti pllajave të malit. Çifti i pëllumbave të fqinjit tonë kishte ca ditë që ngrohej nën rrezet e diellit të fundmarsit, mbi degët e arrës së mbështjellë me myshk të murmë.

Lumi gurgullonte nga ujërat e turbullta që zbritnin përrenjve. Strehët e shtëpive, nga përfundimi, pikonin ujin e borës së fundit.

Dukej se po trokiste pranvera.

Në një nga këto ditë unë kisha zënë vend në murin e godinës së shkollës të ngrohur nga dielli. Ishte mesditë. Lart, në kodrat mbi fshat, dëgjoreshin zërat e njerëzve që hapnin vllaja duhani.

Te kthesa e rrugës bëri ballë përgjegjësja e

vatrës së kulturës me një tog gazetash dhe revistash nën sjetull. U çova nga vendi dhe eca drejt saj.

— Revistën «Hosteni», — i thashë ende pa iu afruar mirë.

— Ma kthe përsëri, — tha ajo dhe ma zgjati. E mora dhe ia tunda para fytyrës buzagaz.

— Ke shkruar edhe këtu? — pyeti ajo, që, siç dukej, nuhati diçka nga fytyra ime.

— Po, një fejtton, — i thashë duke u kthyer te vendi i parë. Ajo u largua drejt urës me **qemer, për nga lagjja e sipërme e fshatit.**

Mbeta vetëm. U ula dhe hapa revistën. Këqyra me një frymë pasqyrën e lëndës dhe lexova emrin tim: Ylli Thanasi.

E hapa në faqen tetëmbëdhjetë dhe fillova të lexoja, i paduruar, shkrimin. Titulli ishte ai që i kisha vënë unë: «DEMKA NUK DI TË GËNJEJË».

...Demkën s'e njihnin të gjithë, se s'kishte bërë emër përpara se t'i ndodhte ajo historia me vëçin laraman. Shokë dhe miq kishte pasur ai, si jo! Sa e sa herë i kishte tokur te **banaku i bufesë së kooperativës. Por të njohur** e të dëgjuar në tërë zonën, siç thamë, e bëri ajo historia me Laramanin, dimrin që shkoi. Doemos, gjersa shkallët e bufesë së kooperativës i ngjite shpesh Demka, shok do të kishte edhe përgjegjës Fevriun, dhe veteriner Ilon, që nuk lajthitnin kollaj për punë gote dhe rakie. Ama edhe Demka hovardha i madh. Por kurrë s'u kishte rënë më qafë

Por, si i thonë fjalës, miku i mirë të di edhe se ku të pikon çatia dhe fap të jep dorën e të ndih.

Duhej një rojë nate në stallën e viçave të kooperativës, në sektorin e dytë.

— E pse të mos vëmë Demkën, — i kishin thënë ata njëri-tjetrit, — i mirë ky Demka, bekri, pa edhe punën e rojës e bën, pse të mos e bëjë. Kishin kërkuar edhe Llaqi i Vitës, edhe Todi me Zinën, po në stallën e viçave një rojë duhej, s'duheshin dhjetë!

Dhe, se kush do të ishte rojë, këtë punë e dinte Favriu e, gjersa e dinte Favriu me Ilon, Demka e pa veten rojë nate në stallën e viçave...

Do të thotë kush: A pati të grindura dhe debate? Kjo është punë tjetër. Por, ama, Demka filloi nga puna.

Ditët rridhnin një e nga një. Herë me diell dhe herë me shi, por ai s'mund të qajej, se punën e kishte brenda dhe natën, kështu që dita as që i hynte në punë.

Kaloi kështu plot kohë. Gabime pune edhe kishte bërë Demka, por që rregulloheshin, se ishte gjallë Favriu dhe lloja. Pastaj, kush punon edhe gabon, thotë populli.

Sapo kishte dalë nga bufeja e kooperativës. Ftohtë vërtet. Edhe akulli në lumë ishte bërë një pëllëmbë. E, si për inat, Demka atë natë duhej të kujdesej për Laramanin e sëmurë. Ur-dhrin e kishte ai. Sa ta shihte që Laramani do të keqësohej, thikën dhe mbaronte puna.

Siç thamë, ftohtë! E në kohë të tillë, shishja me raki, që mbante nën kokën e krevatit, i duhej për të nxehur gjoksin e për të shpirë damarët. Hoqi disa gllënjka dhe i shkuan të ngjethura. Edhe një herë tjetër dhe sërish s'po e ndiente të nxehtët, t'i rrëmbente tëmthat dhe t'i vlon-te trupin. Pa ia kthen gurmazit edhe një galop të mirë, të mirë dhe përsëri asnjë ndryshim. Palcë dimri që s'thyhej kollaj as edhe me raki. Po, ndërsa të nxehtët s'po i futej që s'po i futej në trup, shishja e rakisë po boshatisej...

U kujtua se duhej parë njëherë edhe Laramani i sëmurë, gjer ku ishte dhe si i kishte punët:

U çua me këmbët që s'i bindeshin dhe eci drejt fundit të stallës, ku dergjej Laramani gati në të ngordhur.

Me të keq, duke u zvarritur pas murit të lyer me gëlqerë të bardhë, arriti deri te Laramani. E kapi për zverku dhe ai nuk lëvizi. I kapi veshët dhe ata iu dukën si në të ftohtë, i shtiu veshin nën sqetullën e majtë dhe zemra mezi i dëgjohej.

«Oburra, ta ther!» — mendoi ai. Shtie dorën në brez, te rripi i pantallonave, për të nxjerrë thikën dhe thikë s'ka! Vrap, duke u penguar, shkoi dhe e mori në dhomën e tij, pas derës së stallës, atje ku flinte.

U kthye shpejt dhe, sa të hapësh e të mbyllësh sytë, koka e Laramanit u gjend e prerë...

Kështu shkoi dhe fjeti rehat Demka. Bëri gjumin e shqerrave. Të nesërmen ndodhi gjëma:

Kur hyri në stallë veteriner lloja, zuri kokën me duar.

Laramani kishte ngordhur dhe Balashit në krah të tij i ishte prerë koka...

Si e qysh, ishte e qartë:

Demka s'di ç'thotë. Po hajde si i bëhej punës tani! Po të ishte sa për llon dhe Favriun, mbyllej kjo punë po se kush e kishte shpuar më thellë çështjen e Balashit dhe të Laramanit, prandaj... Demka e sheh veten në kryesi të kooperativës.

Në sallën e madhe burra e gra presin të dëgjojnë Demkën.

E pyesin si e qysh ndodhi.

Ngrihet Demka e bën të flasë, por hiç...! Ama në kryesi ka edhe llo e Favrinj. Në radhën e parë të burrave, ata i bëjnë shenjë dhe i japin zemër të flasë. Dhe Demka merr zemër dhe flet siç di vetë dhe siç e ndien;

— E thera, o shokë, Balashin, se ai m'u duk më i sëmurë se Laramani!

Zhurme e çuquritje në sallë. Pa edhe ndonjë thumb se Demka na qenkej mjek i mbaruar për këso punësh. Po ku u lë radhë Demka i rysur.

— Po, ore shokë, po! Se edhe mua, Tefiku, dentisti i kooperativës, njëdizaj më shkuli dhëmbin e mirë në vend të të keqit. Me atë dhëmb unë thyeja edhe arrat gunga! Po e dini si ma ktheu: «Atë punë, se cilin të shkuli e cilin të lë, e di unë, o Demkë, gjersa më kanë vënë mua këtu dhe jo ty...»

Pëlçet e qeshura dhe Demka s'arrin ta mba-

rojë fjalën. Pastaj flasin edhe lloja me Favriun, se vërtet edhe Balashi kishte shfaqur kohët e fundit ca simptoma të dyshimta dhe se...

Kështu, Demka zbriti shkallët e kryesisë së kooperativës dhe ngjiti ato të bufesë...

E lexova edhe një herë fejttonin dhe më pëlqeu. Një gazmend më kishte pushtuar të tërin e më davaritej mbi fytyrë.

Eca rrugëve të fshatit.

Duhet të shkruaj edhe ndonjë gjë tjetër, pas këtij sukcesi, thashë me vete gazplot, pa e fshehur krenarinë.

Ecja nëpër bllokun e mollëve. Preka me gishta revistën në xhep.

— Edhe babait do t'i bëhet shumë qejfi, — mendova.

Hyrë në fshat. Bëra për nga bufesja. Bufetier punonte im atë. Te dera mend u përplasa me Halitin e Çipit.

— O nip! — ia bëri ai duke më penguar hyrjen. — Ama bukur ia ke ndezur bajgat në atë revistën atij shokut të tët eti, Demkës, hë...! Shko, shko! — tha dhe më tregoi me dorë hyrjen e bufesë duke kakarisur një kollë të thatë.

Mbeta si i shastisur.

Vërtet që im atë kishte shoqëri me Demkën dhe sa e sa herë, kur kisha shkuar ta thërritja mbrëmjeve, të vonuar, e gjeja te tavolina e fundit e bufesë, afër banakut, ulur me Demkën.

Kapërceva pragun dhe hyra brenda. Nëpër tavolina nuk kishte shumë njerëz. U mundova të kapja vështrimin e tim eti, që më vidhej. Vërtet im atë ishte inatosur me mua për punën e shkrimit në revistë?

Dola nga bufeja dhe shkova u ula te sofati i portës së shtëpisë sonë, përballë sheshit të shkollës.

Dalëngadalë po binte mbrëmja dhe nëpër fshat dëgjoheshin kërkëllitjet e çarçive të portave që mbylleshin si me ankim.

Pastaj im atë mbylli dhe derën e bufesë dhe u nis me çapa të mëdhenj drejt shtëpisë.

— Hajde brenda! — tha ai kur kaloi pragun e portës pa u ndalur. Ndjeva vrazhdësinë e zërit të tij, në terrin e mbrëmjes, që më pezmatoi. E ndoqa pas. Hyra pas tij në dhomën e bukës. Mbylla derën nga pas dhe përshëndeta nënën. U bë heshtje. Dëgjoheshin vetëm lidhëset e gjata të këpucëve të tim eti që përplaseshin fort pas meshinit dhe dyshemesë, shtizat e punëdores së nënës që këmbeheshin me njëra-tjetrën dhe drutë e lisit që digjeshin në stufë. Qëndroja në këmbë afër derës.

— E njeh Demkën ti?! — m'u drejtua im atë.

— E njoh, — ia ktheva.

— E di ti që e kam shok unë? Hë?! Apo s'kishte me kë të talleshe tjetër dhe oburra t'ia ngop Demkës?! — tha vrazhdë.

Nëna ndaloi punëdooren.

— Hë, more, fol!

— Ç'ka ngjarë? — tha nëna.

— Ka nxjerrë në revistë Demkën, ja ç'ka bërë. — Heshti një çast. S'm'i ndante sytë inatçorë dhe ironikë.

— Se mos ia ndezësh edhe për ato mëlçitë që na solli njëdizaj, — tha.

Më hipi gjaku dhe belbëzova. Vërtet që kisha ngrënë para ca ditësh në shtëpi një supë me të brendshme viçi, por as që më kishte shkuar ndër mend se edhe ato do të ishin fryt i Demkës...

— More, po ç'të kruhej me Demkën?! — ia bëri im atë me mllef.

— Po ato janë të gjitha të vërteta, more baba!

— E çë pastaj! — tha me sek. — Të mos gabojnë kurrë njerëzit thua ti?! Jo, po ndonjë ditë do ma ndezësh edhe mua kashtën ti! Se kështu vjen. — Pastaj u bë sërish heshtja. Im atë ziente nga marazi. Se, si mund t'i dilte përpara Demkës, pas kësaj...

— Demka, — nisa të flisja, por im atë më ndërpreu.

Ishte nxehur keq dhe kishte marrë të krisur si akulli në lumë, që fryhet e fryhet, derisa teptis arave duke thyer edhe gjerdhet...

— Lëre, lëre, se më paskërke nderuar sot përpara shokëve. Të lumtë, të lumtë!

Mori frymë thellë dhe, sikur ta kishte shpuar diçka nën vete, m'u shkreh:

— Kritikues i madh ti! Parimor! Do të bë-

hesh edhe shkrimtar ti! Ja, nga bërryli, — tha me mllef.

Hapa derën dhe dola në oborr. Me tim atë nuk mund të flitej. Më pengojë fryma. Kohë më parë, kur i vija në dorë gazetën, ku kisha botuar shkrimet, e lexonte me një frymë dhe më përgëzonte duke më uruar «edhe më shumë të tjera», kurse sonte... Sedra e sëmurë për shokun ia kishte ndjellë gjithë atë mllef dhe pezëm kundër meje.

M'u bë përpara Demka, me sytë e skuqur e buzën e poshtme të varur mbi mjekër, që kundërmonte erë raki e duhan. Por unë, kur kisha shkruar fejtounin për Demkën, as që kisha menduar se ai ishte miku i tim eti, i pajtuari i tavolinës së fundit pas qoshkut të banakut...

Futa duart në xhepa. Gishtat e djersitur tokën fletët e revistës. Buzëqesha hidhur. Ngrita kokën drejt qiellit dhe vështrova yjet e rralluara. Lëngu i trashë, pa ngjyrë, që pikëlonte nga lastarët e prerë të hardhisë, më ra në fytyrë. Qante hardhia e vjetër e oborrit nga degët e krasitura.

Unë e dija se lëngu i trashë do të lagte pllloçat e oborrit edhe dy a tri ditë, pastaj do të vraponte nëpër degëzat e njoma për të fryrë sythat e blentë që të çelnin gjethet jeshile me push të bardhë...

Ngjita shkallët e vatrës së kulturës dy e nga dy. Nga brenda dëgjohej herë-herë ndonjë e qeshur. Hyra në sallën e bibliotekës. Disa djem

ishin grumbulluar rreth tavolinës. Ishin edhe shokët e mi, moshatarët. U derdhën drejt meje duke bërë zhurmë e duke folur pa radhë. Edhe xha Tasi mbante në dorë revistën e hapur me syzet e rrëzuara mbi majën e hundës.

Flisnin më zë të lartë. Kujtonin fraza dhe fjali të tëra nga fejtoni, shpotitnin, hidhnin romuze e qeshnin. Qeshja edhe unë. Gazi i tyre nuk më linte të mendoja për atë shakullimë fjalësh që derdhi im atë, i yshtur nga sedra e lënduar për Demkën. Jashtë dëgjohej buçima e maleve që shkundrin borën e fundit që zbriste përrenjve e do të dukeshin pastaj guralecët e bardhë dhe rrënjëzat e kuqe të shelgjishtave, bari i jeshiluar; gjithçka që ishte fshehur gjatë vjeshtës së vonë dhe dimrit.

Dolëm nga vatra e kulturës thujse të gjithë bashkë.

Bënim zhurmë. Shoqëruam xha Tasin deri te shtëpia e tij në lagjen e poshtme, dhe Pepi Kujali, kitaristi i fshatit, propozoi të dilnim te bregu i fshatit. Dikush tha se edhe mund të uleshim e t'ia merrnim njëherë këngës nën degët e kumbullave që po përgatiteshin të çelnin lulet e bardha.

Ecnim të gjithë tok. Këndonim, flisnim dhe qeshnim me zë. Kishte kaluar plot natë. Kur u ktheva në shtëpi, ndihesha i lehtësuar dhe plot gaz.

M'u kujtua babai. Unë e njihja mirë tim atë. Ai do të më kuptonte. Ndoshta e kishte të vë-

shtirë se kishin qenë shokë rakis me Demkën,
dhe ta kritikoja unë...

Ngjita shkallët e drunjtë të shtëpisë dhe ngadalë hyra në dhomën ku flinte im atë. Ndeza dritën. U ula ndanë krevatit dhe i mbështeta dorën lehtë mbi tëmthat e zbardhur nga thinjat.

— Baba!

Kuisi kanati i dritares së lëkundur nga era e ngrohtë e pranverës. Trokitnin mbi xham lashtarët e hardhisë plot sytha...

Ishte pranverë!

MYSAFIRË NË SHTËPINË E KOVIT

— Te, Kovi do shkojmë, — tha Ropi tek mbyllnim derën e zyrës së shefit të kulturës të rrethit, si për të mos e vënë në dyshim të nesërmen.

— Mirë, tek ai shkojmë, — thashë unë dhe m'u bë para sysh Kovi Boduri.

Po mblidheshin ditët për një veprimtari folklorike në rreth dhe neve ende na mungonte materiali që do të përfaqësonte zonën e Shpatit, zonë me tradita të pasura në folklor. Kishim shkuar asaj vjeshte katër-pesë herë, kishim regjistruar me dhjetëra këngë nëpër shirita magnetofoni që nga Zavalina e largët e deri në Lleshan, por ende s'po sillnim ato vlera që mendonin shokët e seksionit në rreth se gjendeshin në këtë zonë. Këtë radhë vendosëm të shkonim në Seltë dhe

natën do ta kalonim te shtëpia e Kovi Bodurit, babai i të cilit shquhej për këngë. E patëm bërë mend me Ropin që herën e fundit, kur qemë në Shpat, të shkonim te kjo shtëpi, por sesi na ishin ngatërruar punët dhe s'kishim mundur. Kovi na ishte zemëruar.

— S'më lë rehat as plaku, — thoshte, — më ngacmon gjithnjë. Si ta bënë kështu ata shokët e folklorit?!

E kishim njohur Kovin në një nga rrethet e pallatit të kulturës, në atë të valltarëve. Ishte i gjatë, me sy të kaltër, me flokë të lëpirë pas kokës, shpatullgjerë e me duar të mëdha. Punonte në metalurgji. Vite më parë kishte zbritur nga Selta e largët, që kur kishte filluar shkollën e mesme, pastaj ishte bërë metalurg.

— Mirë, mirë, të Kovi shkojmë, — përsërita unë, duke sjellë ndërmend dëshirën e tij, por dhe të të atit (nuk më kujtohet si e kishte emrin). Qëndronim atë natë aty, pastaj të nesërmen shihnim ndonjë burim tjetër.

Atë pasdite shkuam dhe e kërkuam Kovin në kombinat. I thamë se kishim vendosur t'i shkonim në shtëpi, në Shpat, ditën e shtunë. I qeshën sytë.

— Do t'ju bëj nun, — na tha gazmend. Ne ishim vështruar në sy.

— Ka një javë që më ka lindur trashëgimtari i dytë.

E kishim uruar gati me një gojë.

— Aq më mirë atëherë, një rrugë e dy punë,

— kishte shtuar Ropi dhe kishte shkelur syrin. Kovi kishte tundur koken dhe, duke ngritur gishtin tregues para hundës, kishte shtuar:

— Por jo si radnën e parë, hë?! Do vini!

— Jo, jo, — qeshi Ropi, — këte herë do të ta zëmë shtëpinë me gjithë mend.

Pastaj vendosëm në çorë do te niseshim. Kovi nuk e kapte dot autobusin e linjës, ndaj do të nisej me ndonjë kamion nja dy orë më vonë se ne. Kur u ndamë, Kovi përsëriti:

— E po kështu e lamë. Unë po nisem me ndonjë makinë, ju drejt e në shtëpi. Me të pyetur, kanë thënë, gjendet Stambolli.

— Po do të ta gjejmë, ore, shtëpinë, — ia ktheva unë.

— Gjallë a vdekur, në mbrëmje mua më keni atje. Bëni ca punë me plakun. Di këngë ai! Se, kur të vij unë, do të kemi punë tjetër pastaj, dhe hapi krahët në mënyrë kuptimplote. Ne bëmë buzën në gaz.

— Unë s'kam shumë kohë që kam filluar të pi raki, por jam bërë i mirë, ama,, — ia bëri Ropi kur po largoheshim. Kovi kish qeshur me zë të lartë.

Shiu ishte i imët. Mbi majën e Bukanikut davaritej një mjegull e bardhë, si festja mbi kokën e një njeriu. Ropi mori në dorë rripin e

magnetofonit «UHFR», që kishte nën këmbë. Po afroheshim te Fusha e Kuqe. Autobusi qëndroi përpara klubit. Ropi shkundi këmbët e mpira dhe, pa folur, u drejtua nga hyrja. Zumë vend përballë banakut. Bufetieri na përshëndeti me kokë. U çova unë dhe porosita dy kafe.

— Për ku? — më pyeti bufetieri.

— Për në Seltë, — thashë unë, — shkojmë për të regjistruar këngë, që...

— E di, e di, — ma preu fjalën ai duke rrotulluar nëpër dhëmbë filtrin e cigares «DS», — ju jeni të vendit për ne shpatarakët tani.

— Po, po, — pohova fytyrëqeshur.

Qyteza ishte e vogël dhe të ardhurit nga qyteti binin në sy menjëherë.

Dolëm në sheshin e vogël përpara klubit dhe u nisëm drejt Seltës.

Përrenjtë ujëpaktë në fund të shpateve të kodrave rridhnin degë-degë dhe bashkoheshin tutje në një luginë të vogël. Në krah të malit të Tomorit, andej nga shtrihej deti, qielli ishte ndezur nga perëndimi i diellit.

Ecnim pa folur. Lamë pas monopatin e ngushtë dhe ramë në përrua. Filloi të binte shi i imët e dalëngadalë rruga po përbaltej. Shiun gati nuk e ndjenim mbi vete, por, kur pashë vrugat e para të ujit që më vareshin nën mjekër, vura duart mbi supë.

— Mor po qenkemi lagur mirë! — i thashë Ropit. Nuk ma ktheu menjëherë se këndonte nën zë, ua, ua, ua,

— Futemi te hajati i kishës së Onufrit, sa të pushojë, — tha pas pak. U futëm nën hajat. Hodha sytë nëpër të çarat e derës për të parë afresket në mur. Ropi ndezi një cigare. Kishim kohë që ecnim, dhe tani fshati nuk duhej të ishte larg.

Vendi mbante erë të mirë, erë manushaqe të porsaçelura që, pas shiut, në pranverë, kundërmojnë nën kaçubat e lajthishtave. Vrapova nëpër shi, kalova rrugën dhe u përkula nën një shkurre. Këputa disa tufëza manushaqe dhe u ktheva përsëri në hajat, ku priste Ropi. Ia tunda përpara fytyrës.

— Po ku i nuhate, ku? Si... si... si ndonjë... — qeshte Ropi. Ndenjëm edhe pak nën strehë. Ropi, s'ia ndante sytë litarëve të shiut.

— Hë, o Kovi, o Kovi, ç'na nxore në këtë ditë! — thashë unë.

— Po, po, për hatrin e Kovit, vërtet, se ne s'niseshim sonte për Seltë në këtë shi, — tha Ropi.

— E po s'qenka aq lehtë të bëhesh nun, — ia pata unë. Ropi nuk foli. Shiu u rrallua. Dolem dhe u vumë përsëri për rrugë. Gati ishte errësuar.

— Nga do marrim? — pyeti Ropi, kur u ndodhëm përballë një bregoreje, në krah të stallave të kooperativës.

— Këtë monopatin më të majtë, — thashë unë, — se kështu tha edhe Kovi.

— Jo, o! — kërcëu Ropi. — Kovi na tha do

merrni rrugën në të majtë, po kur të afroheni te stallat!

— Po ja, ti s'i shikon stallat? — thashë unë dhe hoqa udhë.

— Ëhë, po, — miratoi Ropi.

Ecnim buzë korijes me lisa. Herë-herë rrëshqitnim në rrugën e përbaltuar nga shiu. Në një moment Ropi mend u rrëzua. Dhurata që kishim blerë për trashëgimtarin e dytë të Kovit, i shpëtoi nga duart.

— Ptú, ku gjetëm ditën sot! — shau nëpër dhëmbë.

— Hë, se edhe pak rrugë duhet të kemi, — thashë unë. Pastaj u ndodhëm përballë një përroi të vogël, nga ku niseshin dy monopate. Njëri të çonte lart në kodër, ndërsa tjetri bënte në të djathtë, përbri rrjedhës së përroit.

— Hë, cilën rrugë do ndjekim? — tha Ropi.

— Ja, këtë që na shpie në hënë, — ia ktheva unë me të qeshur.

— A, ti, ti, je fare ti, — u hakërrua ai buzagaz. — Hë, se u lagëm, — tha pastaj me qortim.

— Prit, ore — ia ktheva unë. U bë heshtje. Veç ujit, që gurgullonte në përrua, u ndie edhe zhurmë hapash. Dikush vinte drejt nesh. Ropi ndezi një cigare. Të porsaardhurit flokët i ishin lëpirë pas koke.

— Për ku, more djem, — tha ai, si vuri re që ishim të ardhur.

— Për te Kovi Boduri, — thashë unë.

— Cilën rrugë të marrim? — pyeti Ropi.

Tjetri u kthye me fytyrë nga maja e kodrës dhe zgjati dorën duke thënë:

— Do shkoni kësaj rruge, përpjetë kodrës dhe, kur të arrini në majë, do merrni më të majtë. Duket një shtëpi. Jo tek ajo, po do ecni edhe nja dyqind metra më poshtë dhe do dilni mu mbi shtëpinë e Kovit.

Morëm frymë të lehtësuar.

— Po a rrimë sonte tek unë, — tha tjetri, kur ne po bëheshim gati të niseshim.

— Faleminderit! — i thamë.

Ecnim me kujdes nëpër errësirë. Shiu herë pushonte dhe herë fillonte përsëri.

— Kohë të keqe zgjodhe për dasmë, o Safa, — imitoi Ropi. Unë nuk i ktheva përgjigje, po buzëqesha. Sapo u ngjitëm në majë të kodrës, përmes degëve të një arre të madhe dalluam konturet e shtëpisë së parë, siç na pati thënë fshatari.

— Tani do zbresim edhe nja dyqind metra, hë? — dëgjova zërin e Ropit, që më ndiqte pas në errësirë. Pohova. Nga pas na shoqëruan të lehurat e një qeni. U duk, atëherë kur duhej t'i kishim bërë ato dyqind metra, shtëpia e Kovi Bodurit. Thirra unë drejt saj.

— O Kovi!

Pritëm. Heshtje. Ropi mendohej të shikonte rrobat e lagura e të përbaltura nëpër fashën e dritës që vinte nga shtëpia.

Në derë doli një djalë rreth të tetëmbëdhjetave.

— Urdhëroni brenda, — tha djali, që mundej të shquante në errësirë siluetat tona. Bëmë për nga hyrja. U përshëndetëm me djalin dhe e ndoqëm pas në një dhomë me oxhak, ku flakët e zjarrit lëpinin ca kërcunj të trashë lisi. Hoqëm pardësytë e lagura, lamë magnetofonin nën tavolinë dhe u ulëm në cep të divanit, afër zjarrit, të lehtësuar nga tërë ajo maratonë e rrëshqitshme. Në dhomë hyri edhe e zonja e shtëpisë, nëna e Kovit, që na uroi mirëseardhjen. Doli përsëri.

— Shiko si jemi bërë, — thashë duke vështruar veten.

— Ti sikur ke bërë zvarritje, — ma ktheu Ropi, që ishte lerosur më pak se unë.

U hap dera dhe u duk një fëmijë i vogël, që qëndroi në prag të saj.

— I madhi i Kovit ky?! — tha Ropi, por unë s'e kuptova në pyeste apo pohonte.

— Hajde këtu, hajde këtu te xhaxhi! — i thashë unë. Ropi qeshi, se as që më shkonte mua kjo fjalë për moshën që kisha. Fëmija u afrua pa droje. E mora në duar dhe fillova ta pyesja për emrin. Nga dera e hapur dëgjohej zëri i gruas, që fliste me dikë.

— Njëri të veshë pantallonat e Kovit, tjetri të Petrit, janë lagur shumë, është gjynah të rinë ashtu.

Në dhomë hyri djali, që na kishte pritur te dera.

— Kovi s'ka ardhur akoma?! — pyeti Popi.

— Tani në të ardhur do jetë.

Unë desha t'i thosha se e kishim takuar djë në kombinat dhe na kishte thënë se do të nisej me makinë, po ndërrova mendje, se Kovi më siguri do t'ua kishte bërë të qartë me telefon që do të kishin mysafirë... Ropi ndezi një cigare tjetër dhe fërkonte duart me njëra-tjetrën drejtuar nga zjarri. Përjashta shiu ishte bërë më i rrëmbyeshëm. Këmbët i ndieja të lodhura. U dëgjuan hapa në korridor dhe pas pak hyri në dhomë një burrë rreth të gjashtëdhjetave. Flokët i ishin thinjur mbi tëmtha. Me fytyrë të gjerrë, me pantallonat kilota të futura në çorapet prej leshi të dhirtë, i qeshur, duke na zgjatur duart e ashpra nga kallot, na përshëndeti. Pastaj u ul përballë nesh.

Ropi pa nga unë për të më lënë të kuptoja se duhej ta filloja bisedën me të zotin e shtëpisë. Më erdhi për të qeshur. Sa herë që ndodheshim diku mysafirë, Ropi më bënte shenjë mua që të filloja.

«Ti di ta lidhësh», më thoshte.

«Si s'më kujtohet emri i babait të Kovit», — mërrita veten. Me siguri Kovi do të na e kishte përmendur ndonjëherë nëpër bisëda. Heshtim. Vështrova nga Ropi, që dukej i përhumbur pas flakëve të zjarrit.

— Ç'thonë punët? — pyeti Ropi.

— Mirë, — tha ai dhe i hodhi kutinë e duhanit, — ja, me mbjelljet e pranverës.

— Keni shumë plani si brigadë? — pyeta unë si njeri që merrja vesh nga bujqësia.

— Kemi ca, nja njëqind e dyzet dynymë. — U bë përsëri heshtje. Më vinte inat si nuk po ia kujtoja dot emrin babait të Kovit! Ngrita kokën dhe e vështrova. Ai u bë gati të thoshte diçka, por foli Ropi:

— Dje takuam Kovin në Metalurgji. Na ishte lutur gjithë ato herë: Do vini një natë në Selltë, se babai do t'ju këndojë ca këngë të bukura kurbeti, ca këngë të vjetra, që nuk i keni dëgjuar kurrë, — fliste Ropi dhe herë-herë shihte nga unë.

Plaku tundte kokën në shenjë miratimi.

— Po këtë radhë do vini me gjithë mend, — na tha, — se do t'ju bëj nunër.

— Mirë ju ka thënë, — tha plaku më shumë sikur fliste me vetë.

— T'ju rrojë dhe nipi, jetë të gjatë, — thashë unë, që hiqesha se dija t'i vija pikat mbi i kur duhej. Plaku tha «faleminderit», pastaj u bë qejfprishur, ngaqë s'po i ndizej zjarri në vatër. Vështroi pas shpine derën që u hap. Hyri një nuse e re. «E shoqja e Kovit», mendova.

— Nusja e djalit, — tha plaku pa e vështruar.

Nusja na zgjati dorën, Ropit, pastaj mua. Kërkoj djalin që mbaja në prehër, por unë nuk ia dhashë. I thashë se nuk më pengonte. Plaku u çua, në ecje e sipër drejt derës, tha:

— Mos u mërzitni, se ja, erdha.

— Vazhdo, ti, vazhdo, — thashë unë.

— Sa shkoi ora?

— Ka kaluar nga nënta, — tha Ropi, që mbante vesh me kokën anuar nga dritarja.

— Bie shi, — tha si me dyshim e habi. U çova dhe mora magnetofonin. E pastrova nga ndonjë pikël uji dhe e vura në spinë, afër tavolinës.

— Po Kovi, çu bë?! — thashë unë.

— Do jetë vonuar për makinë, — gjykoj Ropi.

— Vjen ai, vjen, — tha i ati, duke tundur kokën i menduar, tek hynte në derë.

— Sa të vijë Kovi, punojmë pak edhe me magnetofonin.

Plaku më vështroi në sy sikur të mos kishte dëgjuar asgjë, asnjë fjalë.

— T'ia marrim njëherë këngës, thotë, — sqaroi Ropi.

— Ëhë, do t'ia marrim, posi! — tha plaku pas pak i menduar. Jashtë binte shi i dendur. Babai i Kovit mbajti vesh. Zjarri kërciste. Unë afrova një karrige tek ai dhe vura mbi të «UHER»-in. Hyri e zonja e shtëpisë me një tryezë të rrumbullakët druri në duar. Ne pamë nga plaku.

— Fillojmë ne njëherë me nga një gotë, se edhe zhaba s'këndon më të thatë, — bëri shaka plaku. U ulëm rreth tryezës. Babai i Kovit e mori gotën i pari dhe e toku me tonat. Piu tri-katër gota radhazi. Ne e uruam për nipin.

Pastaj na pyeti gjerë e gjatë për nga shtëpitë, si i kishim ata njerëz.

Hyri e shoqja.

— Kovi, t'ju sjell edhe ca domate të regjura me kripë, se ndofta u pëlqejnë djemve, — tha për ne. Unë e Ropi u pamë në sy të habitur. Ajo i kishte thënë të shoqit Kovi. Plaku e pikasi habinë tonë dhe na u kthye buzagaz, pa iu përgjigjur së shoqes.

— Keni parë ju! Kjo plaka ime në vend që të më thotë Petri, emrin tim, më thotë të djemve, një herë Kovi e një herë Stavri, — qeshi ai. Plaka doli e hutuar, duke belbëzuar.

— Edhe nëna ime, — tha Ropi, — ne vëllezërit na thërret shpesh me emrat e njëri-tjetrit. Mua më thotë Beni e Benit Ropi. — Babai i Kovit qeshi përsëri.

— Ç'punë bëni atje në pallat të kulturës? — tha ai dhe mori frymë thellë.

Filloi të shpjegohej Ropi. Mendova se do të ishte më mirë, meqë e solli fjala, t'ia kujtoja edhe një herë atë punën e këngëve, për të cilat na kishte folur edhe Kovi.

— Ne kemi qenë edhe herë të tjera këtej, — po thoshte Ropi, po plaku e ndërpreu.

— E di, e di, ju kam parë.

— E, po ja, na duhen akoma këngë, — tha shë unë.

Plaku uli kokën. Në prehër erdhi e iu fut i nipi. Ashtu kokulur, ai filloi të këndonte nën zë, ngadalë, me kokën e të nipit në duar. Ropi

shkeli butonin e magnetofonit. Në derë u dhanë e reja dhe e shoqja me një regëtimë buzëqeshjeje në cepat e buzëve të hapura nga habia.

«Im shoq është ky që këndon?»

«Zëri i tim vjehri është ky?»

Kënga duhej të ishte e vjetër dhe e pakënduar, të paktën ne nuk e kishim dëgjuar ndonjëherë atyre anëve. Ajo bënte fjalë për një vajzë me emrin Bardhyle, që e kishte vrarë hasmi ditën e dasmës. Plaku këndonte me zë të paktë, por të pastër. Mbaroi kënga. Gratë lëvizën vendit buzagaz. Ropi ktheu çelësin e magnetofonit i kënaqur. Po matesha ta pyesja babanë e Kovit në dinte shumë këngë të tilla sa për të ngarë bisedën rreth tyre, kur u dëgjua dikush që thërriste përtej lesës së oborrit. Doli nusja dhe u kthye prapë.

— Kush është? — e pyeti i vjehri, kur i porsaardhuri do të ishte në korridor duke hequr këpucët.

— Kovi.

— Erdhi Kovi? — pyeta unë. Plaku nuk mami fjalën. E reja po vështronte nga ai, që u çua dhe mend u përplas në derë me Kovin, i cili i zgjati dorën dashamirës dhe i tha:

— Si je, o xha Kovi. — Pastaj bëri për nga ne, që s'po kuptonim ç'po ndodhte.

— Kam tërë natën që po ju kërkoj, bre Ropi, dhe ju mëja paski shtruar. — Ndërhyri xha Kovi, pa na lënë kohë të flisnim.

— Nuk kanë faj djemtë, por ulu njëherë, —
i tha Kovit të Metalurgjisë.

— Ne jemi dy Kovi Boduri në fshatin Seltë,
unë dhe ky Kovi Boduri i Metalurgjisë, — u
shpjegua i zoti i shtëpisë.

Unë brofa në këmbë. Isha skuqur nga tur-
pi. Ishim futur në shtëpinë e tjetrit pa ftuar
dhe ishim shtruar sikur të kishte qenë jona.
Ropi u çua dhe shkuli spinën e magnetofonit
nga priza në mur.

— Të na falësh, o xha Kovi, por...

Xha Kovi zgjati duart drejt gjoksit të tij.

— Na ndiej, xha Kovi, — thashë unë, — po
ne ishim mysafirë në një tjetër shtëpi sonte!

— Dale, dale, — tha xha Kovi dhe më rrë-
zoi atë pëllëmbën e tij të madhe mbi gjoks.

— Edhe unë i dua mysafirët dhe... — Ndoshta
deshti të thoshte edhe diçka tjetër, por sekush
nga ne përmendi edhe djalin e dytë të Kovit
të Metalurgjisë. Po përsëri plaku s'hoqi dorë
nga e veta.

— Këta kanë ardhur edhe për punë, për të
mblodhur këngë, — tha Kovi i Metalurgjisë me
një lloj sigurie se këtë radhë do ta thyente pla-
kun.

— Dhe unë po ju këndoj këngë, — tha xha
Kovi duke e parë në bebëza Kovin tjetër.

— Ti? — tha Kovi i Metalurgjisë, i habitur
ngaqë s'kishte dëgjuar të thuhej për Kovi Bo-
durin e fshatit të tyre se dinte të këndonte. Ma-

ndej s'e kishte parë kurrë nëpër dasma t'ia thoshte këngës.

— Babai, si sonte, s'ka kënduar as në dasmën time, — tha e reja dhe sytë i ndritën nga gazi. Unë dhe Ropi e pamë plakun ngultas. Bulezat e djersës i kishin mbuluar ballin dhe faqet e rreshkura nga dielli.

Ai tha diçka për nderin që i duhej bërë miut, pa vështruar njeri në sy. U ulëm si veti aty ku kishim qenë. Xha Kovi mori Kovin e Metalurgjisë dhe e uli pranë vetes.

— Po s'dinë gjë ata të shtëpisë... — filloi të thoshte Kovi i Metalurgjisë.

— Edhe atë do ta rregullojmë, — tha xha Kovi, — ja, dërgojmë njeri. Atëherë Kovi u rehatua dhe filloi të na tregonte se si kishte shkuar në shtëpi dhe s'na kishte gjetur, si kishte takuar bufetierin, që i kishte thënë se ne rrugës e patëm pyetur për në Seltë dhe...

Xha Kovi mori gotën, uroi për djalin e vogël dhe filloi të këndonte me zë të plotë.

Zjarri flakëronte në vatër. Rrobat e Kovit të Metalurgjisë nxirrnin avull dhe shiriti i magnetofonit mbështillej e mbështillej në njërenë bobinë.

DITË QË SI HARROJ

Sapo dukej fshati, që nga maja e Bregores së Lisave, një rrahje të shpejtë ndieja në gjoks dhe mbushesha thellë me frymë, si i çliruar nga një barrë e rëndë.

— Ja fshati! — pëshpëritja i lehtësuar nga malli.

Tërë ajo ngajasje, që më lodhte sa herë merrja rrugën për në fshat, bëhej përpëlitëse atje në majë të Bregores së Lisave dhe malli më tërhiqte drejt fshatit me një forcë të patreguar, aq sa këmbët i hidhja kuturu nëpër plisat e tokës së lëruar në vjeshtën e vonë, nëpër borën e imët si pluhur në dimrin e ngricave, apo nëpër stërnishtën e grurit të korrur në fund të korrikut.

Kur gjendesha te selishtat e para të ndara

me gjerdhe, në mëhallën e poshtme, ajo ndjenjë malli, marramendëse dhe përpëlitëse më bëhej e papërmbajtshme.

Hyja në rrugicën e çezmës dhe merrja drejt shtëpisë së tretë për të takuar Pandon. Kjo tashmë kishte marrë rrugën e një zakoni të vjetër për mua: gjithmonë ngutesha të takoja Pandon!

Ndoshta ngaqë prania e tij më kujtonte vitet e rinisë sime të hershme, që kishin zënë fill këtu e pesëmbëdhjetë vjet më parë, (në ato vite kisha punuar me Pandon), por më tepër unë, ndoshta, e nderoja Pandon se ai kishte vendosur një prag në atë që ne e quajmë ndërgjegje dhe që njeriut i duhet aq shumë në jetë...

Ne ishim tre. Unë, Pandoja dhe Xhokja. Unë isha më i vogli. Atë qershor kisha mbaruar klasën e tretë. Pandoja dhe Xhokja mund të ishin moshatarë, ose Xhokja një vit apo dy më i madh. Por burra, ama!

Ecnim përbri ledhit të lumit me ujë të pakët. Pandoja në krye, me pompën e spërkatjes në shpinë, Xhokja me çantën e bukës në njërin dorë, pastaj në fund unë, me pompën e vogël tetëlitroshe me një rrip hedhur në krah.

— He, bre Andrea, ç'ma mban akoma këtë pordhalaqkë? — më kishte thënë aty e një javë më parë Pandoja duke treguar me dorë pompën time, tek ishim ulur nën degët e mollës së Ki-

cit e prisnim të fillonte mbledhja e brigadës.

— Merr, bre, një «Pomozë», si kjo e Mitit, — kishte vazhduar ai buzagaz dhe kishte shtrënguar Mitin fort prej supesh. Miti kishte kërcyer nga dhembja.

— Ua, po djalë je ti, o! — kishte thënë Pandoja duke qeshur, ashtu siç dinte të qeshte vetëm ai: shtrëngonte fort gjuhën pas dhëmbëve, puliste sytë dhe e qeshura i shpërthente mbyturazi. Unë isha skuqur dhe kisha heshur si i zënë në faj. Pandoja më kishte ngulur një gozhdë që po më digjte.

Mbaj mend se Xhokja më kishte dalë krah. Kishte thënë se isha i vogël dhe...

— Pastaj, hidhi dy pompa më shumë ti, Tulua i djallit, se s'bëhet ndonjë gjë e madhe, — i ishte kthyer ai Pandos. Pandoja kishte qeshur përsëri me gulçime nga shpotia e Xhokes. Pastaj, me gazin që i kishte mbetur mbi buzë, ishte kthyer nga unë e më pati shkelur syrin me intimitet:

— E po, mirë, bashkë do t'i ndajmë, o Xhoke, një ti e një unë.

Po atë ditë Xhokja ishte grindur pa të drejtë për punën me Pandon. Ishte nxehur, se e kishte thumtuar paq Pandoja për një rrënjë mollë, aty në bllokun e madh, që Xhokja e kishte krasitur keq asaj pranverë. Puna dukej sheshit, se fliste vetë.

— Pandua ka të drejtë, — kishte thënë Ili i Dinos.

— Mirë e ka Pandua, mos ia kishe ulur kurorën; — kishte pritur me mllëf:

— Hë, more, na nxorët mendtë, Pandua kështu e Pandua ashtu. Pandka, thoni! — Kjo fjalë i ishte dukur sikur do ta zvogëlonte Pandon përpara burrave...

Ne kishim qeshur me të madhe. Kishte qeshur edhe Pandoja. Pastaj Miti i kishte thënë Xhokes:

— Po çne, o, emri s'të prish punë! Thuaji, o, në daç, Kasem! — Përsëri kishim qeshur. Xhokja ishte zënë ngushtë dhe kishte heshtur i turpëruar.

Rruga për në arat e Bobishtit, ku do të spërkatnim atë ditë, gjarpëronte ndanë lumit, pastaj merrte të përpjetën nëpër pyllin e dendur me lajthishtë. Në të dyja anët e rrugës kishte shkurre manaferrash dhe unë herë pas here kacavirresha aty ku ishin kokrrat më të zeza. Pandoja këmbente ndonjë fjalë me Xhoken.

— Ta bëjmë një pushim, o Xhoke, — tha Pandoja kur dolëm te Lëndinat e Gjata dhe, pa pritur përgjigje, e uli pompën mbi bar. Xhokja u ul larg nesh.

— Pse u ule aq larg, — e pyeta pa të keq. Pandoja qeshi.

— Ka frikë se i bie erë ilaç nga pompat dhe kominoshet tona, — tha ai dhe qeshi për së dyti.

— Allahut, ç't'i kërkosh, të jep, — ia pati Xhokja duke bërë me kokë për nga pompat. — Ti i kërkon ngordhjen, ngordhjen do të të japë!

Unë dhe Pandoja qeshëm sërish.

Pastaj Pandoja u çua dhe i shkoi pranë Xhokes. I fërkoj kokën gjysmë tullace me një kapelë fëshfësheje që e vinte në kokë sa herë spërkaste. Xhokja u nxeh dhe bëri ta largonte, po Pandoja e kapi nën gjunjë dhe e solli zvarrë deri te pompat. E lëshoi mbi bar dhe pastaj ia hodhi kominoshet mbi kokë. Xhokja turfullonte.

— Po rri, o Pando, po rri, bre Tulo! Po si të të thotë njeriu, bre. Po ik, o, se më mbyte me helm!

Xhokja filloi të kollitej. Pandoja nuk dëgjonte ta lëshonte.

— Po ne si nuk na gjen gjë, xhanëm, — flistë ai duke dihat.

Unë nuk kisha më shumë se një muaj që punoja me ta dhe kisha vënë re se Pandoja vetëm me Xhoken bënte shakara të tilla.

Më në fund ai e lëshoi dhe bëri tutje nga togu i lajthishtave, prej nga kundërmonte një erë e mirë luleshtydhesh. Ndenjëm edhe pak atje, pastaj u vumë për rrugë.

Kur arritëm tek arat e mbjella me patate, mushkaxhiu që larg po na tregonte vendin ku kishte lënë fuçinë, dy kovat, lopatën, preparatin kimik dhe pompën e Xhokes.

Ecnim nëpër rreshtat e patateve. Pandoja, herë-herë, përkulej dhe vështronte mbi gjethet. Drejtonte trupin, shikonte përreth dhe na e kthente:

— Te kjo kumbull duhet rënduar ca dora. Ka shumë infeksion dhe është mirë t'i shkojmë dy herë.

U afruam te vendi i fuçisë. Unë dhe Pandoja lëshuam pompat mbi barin e njomë të livadhit. Xhokja vari çantën me bukë në degën e lisit aty pranë dhe u shtri mbi bar. Pandoja u drejtua për nga gropat ujëmbledhëse. Më digjnin supet nga rripi i pompës. Fshiva djersët mbi ballë dhe psherëtiva.

— U lodhe? — më pyeti Xhokja pa lëvizur nga vendi.

T'i thosha s'isha lodhur, gënjeja, po dhe t'i thosha të kundërtën s'më vinte mirë. Heshta. U ula mbi kominoshë. Era e athët e preparateve kimike të shponte hundën. Xhokja largoi kominoshët e Pandoş, që i kishin mbetur pranë vetes. Unë buzëqesha. Ai i zhvishte kominoshët dhe qëndronte larg nesh, edhe kur bënim ndonjë pushim fare të shkurtër gjatë punës.

Pandoja u kthye pasi kishte kontrolluar edhe përroin e vogël, që gjarpëronte mes lajthishtave, përbri arës me patate.

— S'ka ujë, Xhoke! — tha ai.

— Si? S'ka ujë? — pyeti Xhokja dhe u çua ndenjor.

— S'ka. Uji i gropave ujëmbledhëse është

tharë, — tha Pandoja dhe vështroi vetullngrysur diku poshtë korijes.

— Ç'do bëjmë?! — thashë dhe pyeta veten: «Do ikim?»

— Gjumë! — ma ktheu Xhokja, që rrinte ende shtrirë mbi bar, me sy gjysmë të mbyllur.

Pandoja qeshi dhe këtë radhë, si për çdo marrëzi që thoshte Xhokja. Pastaj vështroi nga unë. Ai vështrim thoshte se as do të iknim dhe as do të bënim gjumë. Erdhi qark fuçisë, dy kovave, lopatës me bisht të shkurtër dhe preparatit kimik, pastaj tha:

— Xhoke! Çohu, mjaft fjete! Çohu, se do të fillojmë punë! — dhe e ngacmoi me majën e këpucës në ijë.

— Me se, me sh... do t'i mbushim pompat? — bëri Xhokja i bezdisur nga maja e këpucës së Pandos. Pandoja shpërtheu gazin.

— Jo, me ujë, — tha pastaj.

— Ka gjëkundi? — pyeti Xhokja, i sigurt se do ta kapte Pandon.

— Ka.

— Ku? — pyetën vështrimet tona.

— Në lumë! — tha këtë radhë Pandoja.

Fryu erë nëpër degët dhe gjethet e pemëve. Lareshat fluturonin lart, mbi majat e lisave, Xhokja u çua ndenjurr.

— Me gjithë mend e ke ti?! — pyeti i llah-tarisur në fytyrë.

— Doemos, Nuk bëj shaka, — tha tjetri.

I vështrova të dy. Të sillje ujë në krahë që nga lumi, gati një orë larg...

— Të sjell unë ujë që nga lumi?! Jo, or tungjatjeta. Ka brigadier këtu, t'i kish marrë masaf, t'i kish bërë mirë planet që t'i bënim punën ne. Unë s'zë kovë me dorë të mbush ujë në lumë. Sikur përmbys të kthehet!

Pandoja kafshonte cepin e buzës.

— Vërtet është ca larg, po një radhë ti e një radhë unë, — tha menduar. Vështroi nga unë.

— Andrea s'i ngjit dot kovat në tërë atë të përpjetë. I thonë njëzet litra. — Heshti një çast.

— Ndofta, rendimentin që do arrinim, po ta kishim ujin këtu, s'do ta arrijmë, por ama kot nuk do rrimë. Do përpiqemi ta justifikojmë, me sa të mundemi. Jemi tre burra, — shtoi pas pak.

Zukatnin mizat. Zhubrica erëmirë, që thahej aty pranë, kërciste.

— Çohu! — tha Pandoja.

— Unë nuk të sjell ujë nga lumi, flije mendjen, kokë! — tha Xhokja prerë. Pandoja e dinte që për këtë rast s'mund ta urdhëronte, veç po të donte Xhokja, me dëshirë...

«Vërtet, tre burra, sa jemi ne, turp është të rrimë gjithë ditën shtrirë nën hijen e lajthishtave, pa ia bërë çëk, — thosha me vete. — Po, fundja, brigadieri të kishte siguruar ujë! Nuk i falet ky gabim. Ç'faj kemi ne tani?!» «Po të ngjitje ujë në tërë atë të përpjetë, një orë larg, kur e nxehta, që përplasej pas shkëmbit, të binte mbí fytyrë...

— Rregulloje fuçinë dhe bëj gati pompat,
— tha Pandoja dhe mori kovat në dorë.

— Unë do sjell ujë, ju të dy do spërkatni.
— S'priti më, por u var nëpër korijen me laj-
thishta. Vrig-vrig dëgjohej zhurma që bënin
dorezat e kovave në duart e tij.

Xhokja gati po gërhiste. Ndieja të nxehtë.
Ndoshta nga turpi që Pandoja më kishte për-
jashtuar nga puna si të njomë apo nga vapa e
korrikut...

Vendosa fuçinë dhe mata sasinë e prepara-
tit me një kuti shkrepëseje që e kishim si ma-
së. Vështa, kominoshet, hapa kapakun e pompës
dhe prita ujin. Sipër, mbi kokat tona, gjithnjë
e më ulët fluturonin laureshat. Diku larg në
koriye dëgjoheshin të rrahurat e sëpatave.

... Ato ditë kisha marrë rrogën e parë. Ia
kisha dhënë nënës. Asaj i ishin mbushur sytë
me lot nga gazi.

— Të keqen nëna, barra me burrat, barra
me burrat, — pëshpëriste duke vështruar lekët
që mbante në dorë dhe më përkëdhelte flokët.

Pastaj më kishte thënë nëna:

— Të punosh mirë, bir i nënës. Atë që ta
bësh, ta bësh të mirë, që të të duan shokët,
mirë?

— Ehu, — ia kisha kthyer unë i fyer, — se
s'e di unë që s'të duan shokët po s'punove mirë.

Nëna më shikonte në bebëzat e syve me një lloj merak. Këtë unë e ndieja nga tërë qenia e saj.

— T'u urdhërohesh shokëve, bir, të mos përtosh kur të të dërgojnë gjekundi, dëgjon? Të bëhesh i mbarë, hë, bir!

Sesi më dukej. Po filloja një jetë tjetër. Më bëhej se isha rritur befas, isha burrëruar, ja, gati me Mitin, Pirron. Dhe gjersa punoja krah Pandos, Maçit, Xhokes, që ishin burra, doemos që dhe unë...

Pandoja u duk te shtegu i lajthishtave.

— Xhoke, çohu, se erdhi, — thashë unë. Xhokja u shëmtua në fytyrë dhe e vështroi nën vetullat e ngrysurat Pandon, që vinte ngankuar.

Po rri, o ditëzi, rri, — tha nëpër dhëmbë. — S'ka ujë! Rri! Ditën e merr. Doemos që e merr, se s'është faji ynë. — Pandoja po afrohej.

— Po jo, — mermëriti Xhokja, — kërkon të buhasë. — U ngrit dhe veshi kominoshet. Pandoja qëndroi te fuçia. Djersët i ravijëzoheshin mbi ballë me bulëza të mëdha dhe i rridhnin mbi faqe. Derdhi ujin në fuçi. Njëren kovë, pastaj tjetren.

— Xhoke, — i tha atij, — atje ku ka infektion më shumë, rëndojeni një çikë dorën. Ja, fillojeni që lart. — Dhe sakaq, duke kapërcyer e çapitur nëpër rreshtat e patateve, u nis

përsëri drejt lumit. Vrig-vrig bënin kovat në duart e tij. Vura kullësën prej teli mbi grykën e pompës dhe u mata ta mbushja me solucion.

— Prit! — ma zuri dorën Xhokja. Vështroi andej nga largohej Pandoja, nga shtegu i lajthishtave dhe, pa ia ndarë sytë tragës së ngushtë, që të çonte në lumë, shtyu me duar fuçinë e mbushur për fundi me ujë, mbi një vijë të mbuluar nga bari i dendur.

Vendi duhej të qe rërë dhe uji i derdhur u zhduk përnjëherë nëpër fijet e barit.

— Për gjysmë ore, gjersa të vijë ai, s'mbetet gjë këtu. Ky diell më than edhe mua, jo ato dy kova ujë, — tha Xhokja. Kisha mbetur i shtangur me hinkë në dorë. Ai zgërdhiu dhembët.

— ... Ngordhjen t'i kërkosh, atë të jep...

Nuk daja ç'të thosha. Po sikur ta marrë vesh Pandoja? Këtë ia thashë edhe Xhokes, që u shtri si më parë, mbi barin e livadhit, pa ma vënë veshin. U ulë. Dielli i nxehtë i fundit të korrikut, hija e lajthishtave, fëshfërimita e gjetheve të pemëve, laureshat lart në qiell, zukatja e një mize dhe Xhokja që gërhiste ngadalë më ndillnin gjumë, por... Po e mori vesh Pandoja, ka punë Xhokja, jo shaka, u belbëzova. Sikur vetëm Xhokja! Edhe unë, shtova pastaj. Xhokja u rrotullua mëkrähëzaj.

E ç'mund të bëja unë përpara Xhokes, thashë vetullngrysur. Xhokja i di punët! Unë një muaj

kam që po punoj me ta, kurse Xhokja ka tërë jetën. Pashë nga ai.

— Bën gjumë, — belbëzova. Vura duart nën kokë dhe u shtriva në shpinë. M'u bë se më shpuan gjembat nën vete. U çova. Asgjë. Bari i butë i shkelur drejtohej ngadalë.

Po sikur të na e kuptojë Pandoja, më rrihte në kokë si çekan. U ngrita dhe pashë vendin ku Xhokja derdhi ujin. Nuk dukej gjë. Kurse patatet e spërkatura nuk mbanin shenjë.

Atëherë nga do ta marrë vesh Pandoja? Kush do t'ia tregojë? Xhokja jo që jo!... Fryu erë dhe u përkundën gjethet.

Po sikur të më pyesë mua?! Si do më pyesë? Po ja, se gjer ku shkuam me solucionin e fuçisë. Apo... Unë s'e gënjej dot! Le që do të më kuptojë nga fytyra pa hapur gojën. Djersë më kullonin mbi ballë. Te shtegu u duk Pandoja.

— Çohu, — i thashë Xhokes, s'di se pse me zë të paktë, që më dridhej. Pandos i kishin dalë djersët mbi këmishën e pambuktë me katrorë të mëdhenj. Ishte vonuar më shumë se radhën e parë. Gjatë kohës që ai ishte atje, nuk guxoja ta vështroja ballazi. Shihja përtokë dhe bëja sikur rregulloja pompën.

Xhokja fërshëllente nën zë. Pandoja u largua shpejt. Që aty i dukej këmisha me katrorët jeshilë të ngjitur në kurriz nga djersa.

Vuuuu, u derdh uji i fuçisë në vijën e mbuluar nga bari. Qeshte Xhokja. Unë e shikoja

si i mpirë. Pastaj filloi me atë të tijën: «Ngor-dhjen»...

U thye dita. Xhokja e pati derdhur edhe tri herë ujin e fuçisë. Me ujin e së fundit kishim përgatitur solucionin dhe kishim mbushur pompat. Pandoja na kundronte ulur që nga livadhi i vogël afër lisit. Xhokja ecte para dhe unë pas tij. Kur u kthyem, vure re se Pandoja ishte përhumbur. Fytyra i kishte marrë një gaz të ëmbël dhe sytë i ishin picërruar si të përmalluar. Dukej i lodhur.

— Hë, Andrea, u lodhe? — më pyeti mua.

— Jo! — thashë unë i befasuar dhe bëra të mbuloja vendin rreth fuçisë me dhé të thatë.

— Se ky Xhokja deshi të flinte nën hije, de! — tha ai dhe e kapi me shaka për qafe.

— Po më lësho, bre Tulo, —mërmëriti Xhokja. Si u lirua nga duart e tij, m'u kthye mua:

— Bëmë një punë, Andrea, hë? — U zura ngushtë dhe belbëzova. Iu vodha vështrimit të tij. Pastaj, si kishim mbledhur veglat dhe kishim nxjerrë fuçinë në rrugë, për ta marrë mushkaxhiu kur të zbriste nga mali, u nisëm për në fshat.

— Si, bre Xhoke, deshe ta bëje festë sot, hë? — S'i dilte nga mendja Pandos. Xhokja diç pëshpëriste.

— Po mirë, bre Xhoke, ti për vete delenxhi u preve e delenxhi do grisesh, po këta djemtë e rinj pse kërkon t'i bësh dembela? Se kështu

deshe, apo jo, të flije gjumë pa filluar punë akoma?

— A, ç'më çan... — shau Xhokja. Pandoja u kthye nga unë dhe shpërtheu në të qeshur:

— S'i vjen mirë, — më tha mua duke më shkelur syrin. Buzëqesha me një buzëqeshje të ngrirë. Ndieja zagushi dhe lëviza pompën mbi shpinë.

Mua të më mësonte Xhokja delenxhi e dembel? Ndieja turp. Më digjnin veshët. Nga të dyja anë e monopazit zgjateshin degët e njoma të lajthive dhe aheve, të varura deri afër tokës. Ecnim të tre, njëri pas tjetrit. Së shpejti do të këndonin gjinkallat. Më vinte për të qarë. Ndieja një toph, që sa vinte e ma ngushtonte fytin. Degët e lajthive trokitnin mbi metalet e pompave, trak-trak. Më fshikulluan edhe mua.

— Ngadalë, — dëgjova para meje Pandon që qëndroi. Ngrita kokën. Ai mbante në dorë, të ngritur lart, një tufë degësh ahu dhe lajthish, që i kishte lëshuar Xhokja me forcë para nesh.

— Kalo, — më tha dhe unë u futa nën krahun e tij.

Këtë histori ia pata treguar Pandos vite më pas. Me druajtje e turp, por s'mund t'ia fshihja. Në fillim ishte rrudhur në fytyrë, pastaj kishte vënë buzën në gaz dhe kishte tundur kokën.

— Hë, Xhoke, Xhoke! — kishte thënë me

mllëfin e një të sulmuari, por që nga sulmi ka dalë i fituar.

Desha t'ia kujtoja këtë histori edhe Xhokes verës që shkoi, kur e pashë rrugëve të fshatit. Ishte plakur dhe kërrusur mjaft. I fola në emër.

Më vështroi me habi, me mëdyshje, sikur të mos më kishte parë kurrë ndonjëherë, apo sikur më kishte frikë dhe u largua i ngutur ndanë mureve pa më folur.

Vura buzën në gaz.

Ndoshta nuk është ai, mendova, dhe e ngatërrroj me ndonjë tjetër. Atëherë ai njeri, që largohet i kërrusur ndanë mureve, m'u duk i largët, fare i largët, i panjohur, sikur të mos e kisha parë kurrë në jetën time...

BABA NASJA

Raqi më priste tutje, mbi ledhin e bllokut të mollëve. Unë isha pak kararsëz dhe mbetesha mbrapa për të zgjedhur, nën kurorat e tyre, kokrrat më verdhoshe e më të kuqe. Ai qëllonte me një degë të zhveshur trungun e mollës më të vjetër të bllokut të mbjellë mbi mezhde, kufiri i parë dhe i fundit, mbi të cilin dukeshin gjurmë gozhdësh e tabelash të vogla druri «Rrezik helmi!».

U afrova dhe u ula rrëzë trungut të saj. Raqi qëlloi trungun mbi kokën time dhe bëri me shenjë andej.

— Çfarë? — pyeta unë.

— Të kujtohen këto? — tha ai. Vështrova ku tregonte.

Dy shkronja të thelluara me thikë, në lëvoren

e mollës, kishin marrë trajtat e plasave.» P.B.
Poshtë tyre një datë 20.3.196...

— Inicialet e emrit tim, — thashë unë duke u fshirë me dorë baltën. Raqi buzëqeshi.

— Sa kohë ka! — tha menduar.

— Vërtet, — thashë unë.

— Ja, pranverë ka qenë, mars, — tha Raqi dhe fërkoji me pëllëmbë drurin, ku shkruhej, 20.3.196...

— Këtu e njëzet e pesë vjet të shkuar, — tunda kokën unë.

— A e mban mend ç'ditë ka qenë? — pyeti Raqi. Unë nuk fola menjëherë.

— Atë ditë mbylli shtëpi Baba Nasja, — thashë me pak zë.

Pastaj nuk folëm më. Të dy dukej se kotehim nëpër kujtime.

Kujtonte Raqi:

Baba Nasja kishte pasur një djalë dhe gruan. Të dy i kishin vdekur kur Baba Nasja ishte ndodhur larg, përtej deteve. Nga tuberkulozi i kishin vdekur. Djali, pastaj, pa mbushur viti, gruaja.

Baba Nasja, atëherë djalë i ri, kishte marrë rrugën e kthimit.

Fund dimri ishte te ne. Binte shi dhe lumenjtë ishin fryrë nga ujërat e borës që shkruhej maleve.

Kishte shumë varre me dhé të butë, atëherë, po Baba Nasja e gjeti të të birit që atë natë. I pikëlluar ishte sa s'thuhej. Kishte lëshuar hejbetë

mbi dheun e butë e të lagur nga shiu dhe qante. Qante dhe nata. Pastaj Baba Nasja kishte gërmuar me thonj baltën, kishte hapur një gropëz më lart se guri i varrit, kishte nxjerrë një lastar të njomë me rrënjëza dhe pak dhé, të ngjizur në to, dhe e kishte futur në gropë. Si purtekë që ngasin kuajt ngjante ai filiz i njomë. Pastaj e kishte mbuluar me baltë e fletë të kalbura ftonjsh e plepash.

Kishin kaluar vite. Baba Nasja vinte shpesh te varri i së shoqes dhe i të birit. Dhe filizi që kishte mbjellë atë natë me shi ishte bërë një pemë e madhe, që tani bënte ca kokrra të kuqe të ëmbla, varur nëpër degë me një bisht të shkurtër, që pikonin në vjeshtën e vonë.

Si e qysh i kishin hyrë për zemër mollët Baba Nases, kjo ishte tjetër punë, po Baba Nasja iu vu t'i shtonte, që kokrrat e kuqe e të ëmbla, plot lëng, të pikonin në vjeshtën e tretë në tërë fushën e vogël të fshatit, mbi mezhda e lëndina. Kështu që një vjeshtë ai mori plot kokrra mollçinash të egra, i preu me thikë dhe farat e zeza, të futura nëpër ca këllëfë të fortë, i thau në diell dhe pastaj i mbuloi me pak pleh të ngrohtë e të shkrifët në ca gazina katrore, me fundet plot vrima.

Farat mbinin dhe lëshonin filiza.

Baba Nasja kishte sjellë edhe një libër të trashë me ca shkronja të zeza që askush s'i kuptonte. Unë ia kisha parë edhe vetë atë libër. Kisha parë edhe sharra druri të vogla, si ato të

marangozëve, por me ca dhëmbë kataroshë, kisha parë gërshërë që ndryshonin nga ato të rrobapësve. me ca krahë si lugë të shtrembra, thika me mill të zi, që s'ngjanin fare me ato të shtëpisë e plot të tjera.

Kisha parë pastaj dhe lloj-lloj gjërash të tjera; degë pemësh me ca qeska të bardha varur në to, që kishin nga një krimb brenda, si krimbat që gjenim nëpër gjethet e manaferrave, me shumë këmbë.

Dhe Baba Nasja shih në librin me kapakët e trashë e bëj, shih në libër dhe hidhu ujë e pleh teneqeve ku kishin mbirë filizat e murmë të mollçinave. Pastaj kishte marrë në pranverë filiza nga molla që lëshonte kokrra të kuqe.

Çante me thikë lëvoren e njomë të filizave që kishte mbjellë në gazinat prej teneqeje dhe fuste në të sythat e njomë me pakëz dru të mollës me kokrrat e kuqe. Pastaj vendin e lidhte mirë me leckë e ç'të mundte, si t'ia merrte mendja për më mirë.

Çuditej mëhalla me Baba Nasen, pa thoshte edhe ndonjë fjalë që s'thuhet (se ishte marrosur paq teneqeve me filiza), por nga ai vesh s'dëgjonte Baba Nasja. Sythat lëshonia filiza e bëheshin degë, degët mbusheshin me fletë.

Pastaj u korrën të grunjëtat dhe u mblodhën misrat, pa zuri edhe dëbora e bardhë, gjersa erdhi një kohë tjetër, që mezi e priste Baba Nasja. Kishin filluar të lëvrinin lëngjet nëpër

drurë, dhe bari të shponte dheun ndanë ledheve të arave.

Baba Nasja ngarkoi në kalë teneqetë me filizat që tashmë ishin rritur dhe me lopatën në dorë bëri tutje nga Ara e Zhukave, një lëndinë e vogël, buzë kodrës, që nuk e zinin erërat. Kishte hapur ca gropa me lopatë sa për të futur një kosh brenda, nga tetë çape burri larg e larg. Në fund të gropave kishte hedhur dhe të thërrmuar me pëllëmbë e pleh të ngrohtë bagëtish. Kishte futur filizat e mollëve, një shtresë dhe të butë, një shtresë pleh, e pastaj e kishte ngjeshur me këmbë.

Dhe për aq kohë sa fëmijët e lindur atë mot kur Baba Nasja kishte mbjellë filizat e mollëve u bënë zot për të shkelur mezhda e sinore gjer tutje fshatit, filizat u bënë pemë dhe lëshuan kokrra. Çamarrokët mbushnin xhepat dhe gjinjtë me to dhe vraponin sokakëve. I provonin pleqtë e asaj kohe, i provonin dhe të rinjtë. Më pas Baba Nasja i mbushi sërish teneqetë me filiza, se i donte xha Tasi nja pesë filiza, tre i donte Dini t'i mbillte në oborrin e vogël pranë shtëpisë, që, kur të plakej, t'i kishte pranë e të lagte gojën. Donte edhe Fanija dhjetë rrënjë, dhe Mitrovica, pa donte edhe për vete, se plot vend kishte në anë të Arës së Zhukave.

Dhe porsa ujërat e borës u terën pakëz dhe plisat e vegjël në pellgjet e lumit u plasaritën, Baba Nasja filloi nga puna. Një ditë te Tasi e një ditë te Dini, një te Mitrovica e një te

Llazoja për të mbjellë filizat. Librin s'e merrte me vete. Tani e dinte mirë se si do t'i vinte rrënjët në tokë e sa pleh do t'u hidhte. Libri do t'i duhej më vonë, tani jo.

Kështu, pas ca vitesh, tërë fusha e madhe në të dalë të fshatit ishte mbushur me mollë të kuqe e verdhoshe, që Baba Nasja i kishte mbjellë njëren pas tjetrës.

Atëherë ndërtoi atë dhomëzën e vogël si kolibe, në krye të Arës së Zhukave. Verë ishte. Baltë e gurë kishte plot mezhda ndanë lisit të madh. Qereste pak i duhej, fare pak, sa për një dhomë.

Thoshin se e kishte ngritur që të ruante mollët netve, të mos ia vidhnin djelmuria. Po kjo s'ishte fare e vërtetë, se Baba Nasja pak net flinte në dhomën e vogël, vjeshtës, kur bëheshin mollët, fare pak. Kurse tërë pranverën e deri në verën e thatë gdhiehej me ditë e me javë të tëra pranë tyre, te dhoma që kishte ndërtuar vetë. Herë ndizte zjarre me kashtë të lagur, që lëshonte vetëm tym, herë me gërshërë në dorë, herë me pompën e spërkatjes në kurriz e herë duke hapur vijat e ujit rrumbullak rreth trun-gjeve në vërë, kur këndonte gjinkalla netve.

Bile edhe më vonë, atëherë kur tërë fusha me mollë u bë e kooperativës, bashkë me dru-rët e mollëve të Zhukave, Baba Nasja nuk hoqi dorë nga e tija.

— Tashi rri rehat, mja u fingjillose pas tyre,
— i kishte thënë një ditë xha Dini Baba Na-

ses, kur e kishte parë të kthehej nga Ara e Zhukave me pompën e spërkatjes në kurriz.

— Ti s'merr gjë, — ia kishte plasur Dini duke mbledhur buzët, — tashi i merr kooperativa të gjitha...

Baba Nasja ishte errur dhe nxirë si nata. E kishte mbërthyer nga jaka e palltos dhe e kishte shkundur fort, se mend i kishte marrë frymën.

— Si the, more?! S'marrkam gjë?!

— ...

— Thuaje, bre! Thuaje, bre, edhe një herë!
— Ishin mbledhur burrat atje te Ura dhe Dini kishte mbetur as gëk, as mëk. Baba Nasja, që s'mbahej mend të kishte ndezur sherr, kishte marrë spicë si ai druri i njomë i ahut, ja ashtu me një fjalë.

Përtypej Dini e s'dinte si t'ia kthente fjalën, por s'mbahej Baba Nasja.

— Turp, turp, o Din! Më dashkërke të mirë?!

— Ecte me pompën që i trokonte pas kurrizit dhe drejtonte stekën e saj drejt qiellit.

E kishte shkelur Dini, po hajt të ulje Baba Nasën. E kishin marrë vesh edhe ata të kryesisë së kooperativës këtë histori dhe, si në hesh-tje, ishte vendosur që Baba Nasja të kujdesej përsëri për mollët, edhe për ato të Arës së Zhukave, edhe për ato të fushës, sa të arrinte. Se ata s'mund të harronin që tërë atë fushë të madhe me mollë e kishte mbjellë dhe rritur Baba Nasja në kohën e tij...

Doemos që shumë histori për Baba Nasen unë do t'i kisha të dëgjua, se atë e mbante në gojë fshati, por, meqenëse jetonim prej vitesh në shtëpinë e madhe të tij dhe në një-rën dhomë, në atë më të madhen, që shikonte me dritare nga rruga, jetonte ai vetë, unë dija më shumë historira për të se tërë moshatarët e mi...

Ato ditë kisha qenë pranë tij. Gjethet e pemëve ishin shkundur në tokën e murme. Frynte erë. Erë bore. Tymi i oxhakëve zvarritej pas qeramidheve të myshkulluara dhe pas ploçave të murme të çatiye. Baba Nasen e pashë te kupi i madh i tallashit që nxirrnin sharrat e drurit, në të dalë të fshatit. Kishtë mbushur një thes të madh dhe bënte ta tërhiqte pas vetes. Më pa dhe, duke tundur në erë bastunin, bërtiti:

— Hëeej! — Ai bërtiste gjithmonë kështu, me një «e» të zgjatur. Renda drejt tij.

— Më lodhi, bre bir, më lodhi, — tha ai dhe i ra thesit me bastun. Ishte dirsur mbi faqe.

— Ta marr unë në kurriz? — thashë me seriozitet. Ai më vështroi pakëz dhe pastaj qeshi me gulçimë. Mustaqet e bardha i hovnin përjetë. Qeshte dhe qëllonte thesin me bastun.

E tërhoqa thesin fort pas vetes, duke u çapitur për nga rruga. Baba Nasja erdhi shpejt pas meje, me një-rën anë të thesit të shtrënguar në dorë.

— Dale, de, dale, se më rrëzove! — thoshte

ai. Por unë s'dëgjoja të qëndroja. Kalonin njerëz afër nesh dhe unë as që desha t'ia dija për «dalet» e Baba Nases.

— More, po kur është i fortë, qerratai! — Te blloku i mollëve qëndruam. Për ta zbratur ishte kollaj puna. Unë isha skuqur dhe djersa më ishte tharë mbi tëmtha nga era e vjeshtës.

— Ç'do ta bëjmë këtë tallash, o Baba Nase? Do ta djegim?

— Jo, de, jo! — tha ai.

— Pse, nuk e djegim si atëherë? — thashë unë duke sjellë ndër mend se Baba Nasja edhe vitin e kaluar kishte sjellë një thes të tillë të madh të mbushur plot me tallash. E kishte përzier me kashtë të lagur dhe i kishte vënë zjarrin, ja, atje në fillim të arës, te ledhi i kumbullës. Por ishte fillim pranvere, ama, vetëm manushaqet kishin çelur anës lumit, e mbaja mend mirë unë.

— Jo, jo! Do t'ua hedhim rrënjëve të mollëve, ja kështu. — Dhe Baba Nasja mbuloi dheun poshtë asaj mollës së ëmbël që bëhej në korrik. E hapi me pëllëmbë rrumbullak, si dyshëk e bëri. Pastaj mbushi krahët dhe bëri për te tjetra. Dhe unë s'prita. Vërtet që duart e mia merrnin pak, por unë dy rrugë e Baba Nasja një.

— Ma kaloi, bre, qerratai, hëë! Pa shikojeni, shikojeni! — Dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë, tallashi ishte hapur vullata—vullata, nën degë, afër trungjeve.

— Pse e mbuluam dheun ashtu nën mollë, o Baba Nase?

— Që të mos ngrijnë rrënjët.

Unë rrija dhe mendohesha. Rrënjët që ishin nën tokë, të mbuluara me dhé, u ngrinin mollëve, apo degët që i zinte dëbora?!

— Po degët, o Baba Nase, nuk u ngrijnë? — ia prita.

— U ngrijnë, u ngrijnë, po... dalin mirë nga dimri pemët..., kalbet tallashi i mbuluar me një cipë dhe... pleh bëhet... Sikur i hedh gjak njeriut prej njeriut kur plaket dhe është i dobët, kështu edhe mollët... — tha Baba Nasja sikur fliste me vete.

Unë e vështroja në sy i habitur. Ai buzëqeshte dhe më guduliste me mustaqet e bardha nën gushë. Nga tëmthat, djersa i zbriste gjer poshtë mbi faqet e rreshkura. Ndjeu të dridhura dhe u çua. Çapitesha edhe unë në krah të tij, drejt shtëpisë sonë.

Frynte erë e ftohtë dëbore.

Që të nesërmen e asaj dite Baba Nasja zuri krevatin e ra keq i sëmurë. Shpesh kollitej me një kollë të thatë e të çjerrë. Kishte ardhur edhe mjeku një ditë dhe i kishte dhënë ca happe të verdha e të hidhura. Sa i shtinte në gojë, Baba Nasja ligej në fytyrë. Tërë dimrin nuk luajti nga krevati, me fytyrën e kthyer nga doli i futur në mur. Rënkonte. Babai pëshpëriste për vdekjen e Baba Nases. Sesi më vinte! Të na vdiste Baba Nasja!

Mbrëmjeve, mbuluar me velenxën e leshtë, qaja dhe dënësja mbyturazi gjersa më digjte gjoksi e më merrte gjumi. Jashtë frynte erë që e përplaste borën pas mureve të shtëpive dhe tutje fushës kishte nxjerrë ledhet e ngrira të arave si kurrizet e ca peshqve të mëdhenj që notonin në det të bardhë.

Një ditë më kishte pyetur Maria e Urës (kështu i thoshim, meqë e kishte shtëpinë mbi urën e fshatit).

— Ç'bën Baba Nasja, more bir?

Unë kisha mbledhur buzët dhe sytë po më rrëmbusheshin ngadalë.

— Nuk vdes ai, jo, dëgjo teto Marien ti... Le të më thotë kush të dojë mua... — Dhe, pasi ishte futur brenda, kishte dalë sërish. — Ja, mba-je mend ti! Ehuuu... Ka punë me mollët ai, do t'i presë, pa do t'i mbledhë se do t'i... Nuk vdes, jo! — kishte shtuar në fund. Unë s'kisha pritur më. Vrapin e kisha mbajtur në shtëpi, te nëna. E kisha gjëtur në trem.

— Nuk do të vdesë Baba Nasja, nuk do të vdesë! — ia kisha pritur unë. Nëna kishte shtangur.

— Si the, ore?!

— Nuk do të vdesë Baba Nasja! Më tha teto Maria e Urës mua. Se do t'i presë mollët e do t'i spërkatë, pa do t'i mbledhë e do t'i... Ka punë me mollët Baba Nasja, nuk ka nge për të vdekur, më tha. — Nëna më kishte shtrenguar fort në gjoks. Ishin ditët e fundit të dimrit

ato. Pastaj erdhi një kohë tjetër. Buçiste mali. Kullonin strehët.

Një mëngjes Baba Nasja ishte ngritur herët, ndoshta që në mesnatë. Zjarrin e kishte ndezur vetë në stufë. Kërkëllinte teneqeja e deriçkës së stufës. E thëthinte nata zjarrin. Pastaj ulej në cep të krevatit dhe mbante vesh. Vështronte tej dritares. Errësirë. Qëndronte përballë saj gjersa era hynte nëpër të çarat e kanatit dhe i mpinte zverkun.

Sapo zbardhi, Baba Nasja doli në derë të tremit.

— Heeej! — thirri.

U derdha unë i pari drejt tij, pastaj babai dhe nëna.

Ishte çuar Baba Nasja nga krevati i dimrit të gjatë. Qëndronte në këmbë, mbështetur në bastun, përballë dritares. Flisnim të gjithë. Unë dridhesha në duart e Baba Nases. Fërgëllonin gjethet e thata të akacies. Dridhej uji në pendën e mullirit, ngjitur me shtëpinë tonë.

— Sytë s'para më shohin, — belbëzoi më shumë për t'ia thënë vetes Baba Nasja. — Dimri m'i paska veshur me cipë, po do më kullohen, ja, sa të pëlcase gjethi jeshil i mollëve. — Që atë ditë filloi të mprichte sharrën me dhëmbë katastrohë të krasitjes. Mprehu edhe tehun e lugët të gërshërëve. Priti. Dy ditë, tri. Ditën tjetër tërë gaz ishte Baba Nasja. Nën zë belbëzoi ca tinguj kënge, që i dilnin herë-herë si fërshtëllima të zgjatura:

Xhavella, raaa, raaa, hop!
Poçari, ruuuu, uruuu, hop!

Dhe e tundte bastunin në erë. Mundohej të ulej e të ngrihej mbi gjunjë, por s'mundte, aq më tepër të rrotullohej edhe rreth vetes. Unë i zgjajtja duart e mia të vogla për ndihmë.

Pastaj unë përpara dhe Baba Nasja pas. Sharrën me dhëmbë kataroshë e mbaja unë në dorë. Balta e rrugës ishte terur fare. Frynte erë pranvere.

— I than ujërat, — tha Baba Nasja për erën. Vështroi tutje për nga Ara e Zhukave, fill pas së cilës shtrihej tërë fusha e madhe e mbjellë me mollë. Mugëtirë i dukej kudo: edhe drurët, edhe kodra e vogël, edhe lisi i madh i ngatërrroheshin me njëra-tjetrën.

— Më qenkan dobësuar sytë fare! Bre, bre, bre! — ia bëri ai dhe tundi bastunin.

Hymë në Arën e Zhukave. Baba Nasja vështroi në krah të kumbullës. Vinte erë manushaqe nga gëmusha. Vërtet nuk i shquante dot lulet e vogla, lajmëtarët e pranverës, po pranverën e ndiente, ama, ashtu siç e kishte ndier atë natë kur arratisej dimri. Ndenji pak në prag të kolibes së gurtë. Vështrome nëpër degë herë-herë e kapsalliste sytë.

— Nuk i ndakam dot filizat e hollë majë degëve, — tha. — Degët e trasha po, por filizat...

Heee, hall! — Përplasi buzët me njëra-tjetrën duke i lëpirë.

— Do të na mendojnë ca ditë më shumë, bre bir, — më' foli mua, — ja, këtë do të na bëjnë, ç'do të na bëjnë më shumë? — U çua dhe kërkoi sharrën. — Shiko duart dhe këmbët, hë, më rrofsh, — tha me pauzë, — pa të tjerat kollaj.

Baba Nasja e filloi krasitjen me mollën e ëmbël të beharit, me degët e trasha. Sharrën e tërhiqte ngadalë. Tallashi i imët i mbulonte majat e këpucëve dhe i ngjyoste pantallonat e shajakta.

Nxehej tehu i sharrës, nxeheshin dhëmbët kataroshë dhe një cipë e bardhë shkumëzonte në cepat e buzëve të Baba Nases. Dega ishte e trashë, pastaj edhe sharra e hante drurin ngadalë. Kur mbeti edhe një gisht dru i paprerë nga dega, Baba Nasja i vuri shpatullat nën degë.

— Që të mos thyhet e të dalë spicë, — tha. Sharrën e tërhiqja unë. Me zor e shtyja përpjetë, se më duhej të ngrihesha në majë të gishtërinjve të këmbëve. Baba Nasja më vështronte me bebëzat e syve si të lagështa.

Krak, u pre dega dhe u lëshua përtokë. Krak, u thyen majat e saj, që u përplasën në tokë.

— Pse qenkan tharë majat? — pyeti me zë ai pa i parë.

Duke u penguar pas plisave të tokës, u derdh drejt tyre. I preku me dorë majat e degëve të thyera, i afroi te sytë.

— Bah, qenkan tharë! — tha me gudi Baba Nasja. Pa drejt majat e mollëve.

— Ç'zor kanë pasur që janë tharë, xhanëm?!
— U mundua të kapte me bastun, kuturu, njërën prej degëve që përkundej lehtë nga era. E afroi te duart.

— E thatë! — tha. Kapi edhe një tjetër.
— Ua, ua, ua, — ia bëri dhe me një mendim të errët në kokë u çapit me bastunin e ngritur lart drejt trungjeve të mollëve të tjera. Degët ia kapja unë dhe, i varur i tëri, ia afroja Baba Nases te duart. Theu një lastar të degëzuar që te pjesa e njomë. Nuk e shquan- te dot me sy ç'kishin degëzat e thata, po me dorë diçka ndiente. Ca si mornica të vogla, por të forta, si ato që i dalin njeriut nga të ftohtët.

— Ptu, djall o punë! — i sëmboi diçka e keqe në shpirt. Seç po ndodhte me mollët. Një gjë e keqe u kishte mpirë sythat dhe lëvoren e murme, gjersa u kishte terratisur lëngjet e i kishte kthyer në shkarpa degëzat e njoma!

— Librin, librin! — pëshpëriti Baba Nasja. Unë, që e ndiqja me sy, më s'prita. Baba Nasja kishte kërkuar librin, dhe unë vrap rrugicave të kalldrërta të fshatit për t'ia sjellë. Librin nën sjetull e tek Ara e Zhukave u gje- nda me një frymë. Baba Nasja aty, mbi gurin e sofatit, me degëzat e thata të mollëve mbi gjunjë. Ia vuç librin mbi prehër. Fërgëlloi dhe lëvizi mbi gurin e sofatit.

— E solle?! Të shohim ç'thotë për këto mor-
nicat. — Hapi dhjetë faqe, njëzet. E afroi pra-
në syve aq, sa fletët e librit i tokën në hundë
e në qepalla...

Katër shkronja dhe një datë, të gdhendura
mbi trungun e mollës më të moçme të bllo-
kut, na e kishin sjellë kaq pranë jetën e Baba
Nases...

Ishte mbrëmje vjeshte. Shkundeshin fle-
tët e zverdhura nga degët e mollëve, që në
pranverë do të mbusheshin përsëri me gjethe,
lule dhe mollë...

IM VËLLA

Në oboër m'u ngatërruan këmbëve lastarët e prerë të hardhisë, që ime motër i përdorte në vend të litarit, për të kërcyer me shoqet. Mend u rrezova dhe u mbështeta mbi kanatin e portës... që u çel. Ishte e lëshuar nga brava.

— Edhe porta e brendshme e shtëpisë ishte e hapur, lëshuar nga brava, — belbëzova duke pulitur sytë.

Qysh prej disa muajve bravat e portave nuk kishin luajtur vendit, ndërsa këtë mbrëmje... — buzëqesha me ironi.

— Im vëlla e ka lënë hapur, — thashë me zë të paktë, — domethënë do të kthehet vonë sonte në shtëpi.

U ula mbi gurin e sofatit, në krah të portës. Përpara vatrës së kulturës kishte njerëz. Në anët

e lumit, aty ku fillojnë blloqet e reja me mollë, këndonin bilbilat. Një tufë harabela fluturuan drejt strehëve të çatisë së shkollës për të kaluar natën. Po binte muzgu.

— Si, more kapedan, si? Do na bësh dashuricka sonte? thashë me mllëf duke kafshuar buzën. U ndezën dritat e rrugëve. U çova dhe hoqa rrugë andej nga kishte më pak njerëz. Desha të qëndroja vetëm.

Në fillim sa s'kisha bërtitur kur kisha zbuluar të fshehtën e portave të lëshuara nga bravat. Im vëlla takohej me Lejlanë e Gjatollëve. Kurse më tej, sa vinte e më shtohej një ligësi e patreguar, që as vetë s'e dija me cilin e kisha: me tim vëlla, me Lejlanë e Gjatollëve; apo me veten...

Te çezma e fshatit, mbuluar me llamarinë të murrme, qëndrova. Më tej, në të sipërm të saj, dalloheshin mugët vllajat e duhanit mbuluar me plastmasë. Përgjegjëse në to ishte ajo, Lejlaja e Gjatollëve, për të cilën thoshin ato ditë nëpër fshat se kishte fidanin më të mirë në tërë kooperativën. Sërish m'u ngritën nervat dhe u ktheva shpinën. Nën dritën elektrike lodronin flutura me krahë ngjyra—ngjyra. Ato shkonin deri te gjethet e reja të kumbullës, përbri rrugës, dhe ktheheshin sërish nën llambën e madhe, varur mbi shtyllë. Psherëtiva. M'u kujtua një ditë, kur më pati thënë Dullë rrobaqepësi, duke zgjatur atë mjekrën e tij të parruar nëpër hekurat e dritares:

— Ta hodhi yt vëlla, ta hodhi. Rri ti, rri. Da-

shuron me Lejlanë, me Lejlanë e Gjatollëve.

Kisha ndier të më mbulonte të kuqtë në fytyrë e një topth në fyt të më merrte frymën. Dulla kakariste me një zë të ngjirur, që kuterbonte erë duhan e raki. Edhe tani, kur e sillja ndër mend, më bëhej se ndieja erën e keqe të frymës së tij.

Pastaj kishin kaluar ditë dhe unë e kisha ndier edhe vetë se im vëlla me Lejlanë duhe-shin...

Ditën e Vitit të Ri, siç e kishim zakon fshatçe, uronim në të gjitha shtëpitë. Nëna, mua dhe tim vëlla na dërgoi për të uruar, ndërsa vetë, së bashku me motrën e vogël, prisnin e përcillnin në shtëpinë tonë. Në shtëpinë e Gjatollëve shikuan në mbrëmje! Ai, mbaj mend, u ul në krah të kundërt me mua, përballë derës. Pas tij, në dritare, ishte vendosur një vazo e vogël, ku gjetihonte një lule e bukur, që se kisha parë gjëkund tjetër. Ne na qerasi me ëmbëlsirë Lejlaja. Ishtë veshur bukur. Në gropëzën e faqes së majtë i shquhej nishani i zi sa një kokë gjilpërë. Mbi gushë e mbi buzë një push i hollë me ngjyrë floriri i mbulonte të kuqtë që i pati rënë në fytyrë.

Në shtëpinë e tyre ndenjëm mjaft. Kur po bëheshim gati të largoheshim dhe Lejlaja po na merrte pjatëzat e vogla të ëmbëlsirës nga duart, im vëlla i kapi dorën dhe i pëshpëriti diçka në zë. Unë, që isha përballë tyre, i vura re. Im vëlla e ndjeu këtë. I shtyu tabakanë Lejlasë së hutuar

dhe pecetën, që i kishte mbetur në dorë, e futi në xhep.

Më erdhi për të qeshur, por e mbajta veten. Edhe kur dolëm në rrugë, nuk e kujtova. Vetëm kur hymë në shtëpi i thashë nënës:

— Xhuvi të ka sjellë një pecetë. — Vetëm kaq.

Me dorën futur në xhep, ai ishte skuqur deri në tëmtha. Pastaj edhe pas disa ditësh, në të ftohtët e janarit, kur e përçolla në qytet për të kryer detyrën ushtarake, ai dhe Lejlaja u takuan te Qafa e Lepurit. Atje punonte rinia e fshatit, në çeljen e tokave të reja. Kisha hungërruar, se e dija që shkonte më shumë për të takuar atë sesa shokët, por atë ditë s'i kisha thënë gjë. Nuk më vinte mirë t'ia prishja gazin.

Kishin kaluar kështu që nga ajo ditë tre muaj, tre muaj e ca ditë.

— Dhe sonte do të kthehet vonë, domethënë do të takohet me të, — thashë. Frynte era e lumit. Mbi degët e mollëve, të mbushura me lule, fluturonin fluturat.

— Dashuria duhet të jetë e fshehtë, — thashë me zë të paktë. Këtë të tyren e ka marrë vesh gjithë fshati! — Mblodha buzët pa qejf. M'u bë se dëgjova zhurmë dhe dikë të pëshpëriste: «Ta hodhi yt vëlla...» Vështrova rreth si i trembur. Nga sylinari i çezmës, mbi postafin e guntë, derdhej uji me gurgullima nanuritëse. Mbi

rrugë fërgëllonin gjethet e reja të blirëve. U dëgjuan zëra njerëzish që vinin drejt meje.

Ishin shokët e mi, që ktheheshin nga shkolla e mbrëmjes. Më përshëndetën. U mundova t'u flisja miqësisht, po nuk munda. Qëndrova edhe pak rrugëve, pastaj u nisa drejt shtëpisë. Nuk kisha uri. Zieja nga mëria. Kështu u ngjita në dhomën e gjumit pa hyrë në kuzhinë. Ndeza dritën e abazhurit. Siç isha i veshur, u shtriva në shpinë mbi krevat. Më buçitnin veshët.

Edhe nëna mbante anën e tij.

— Nënë, a e di që Xhuvi ka nuse? — i kisha thënë unë një ditë.

— Posi, posi, — ma kishte kthyer nëna, — dashka edhe Muçua kafe?! — Më ishte dukur se ajo dinte diçka. Unë kisha dalë dhe ajo kishte pëshpëritur pas meje:

— Ja, ja, na dalka përpara teje. Është shpejt për të. Por një fije gazi kishte regëtitur në sytë e saj.

Shtrengova qepallat dhe shpupurita flokët me gishta. Kishin kaluar muaj dhe unë kisha dëgjuar që marrëdhëniet e tyre ishin forcuar edhe më shumë. Tani po këmbeni edhe letra. Mua s'më kishin rënë kurrë në sy, megjithëse herë-herë ua kisha hedhur ndonjë fjalë ashtu larg e larg, kur i kisha parë bashkë. Ata kishin bërë sikur nuk kuptonin, sikur s'binin për ta ato daulle.

U çova ndjenjur. Më pas u ula në karrigen

përballë tavolinës. Jashtë era fëshfërinte. Druri i antenës së televizorit, mbështetur pas murit të shtëpisë, kuiste tek fërkohej pas strehës së çatisë. Në varësen mbi mur, në vendin e kitarës, ishin varur kapelja me yllin e kuq dhe rrobat ushtarake të tim vëllai.

— Ti ke vesh muzike, por s'do të punosh, — më thoshte shpesh ai.

Përplaseshin qepenat e dritares nga veriu. Përsëri më vajtën sytë mbi varësen në mur. Pardësyja që kisha qepur ato ditë në rrobaqepësinë speciale të qytetit mungonte. U çova dhe lëviza togun e rrobave të varura në të.

— Do ta ketë veshur Xhuvi, — thashë si me frikë.

Unë kisha vendosur ta vishja për herë të parë në përvjetorin e ditëlindjes së motrës, që afronte pas dy javësh. Do vinin edhe shokët e shoqet e mia atë mbrëmje, dhe ja, ai e kishte veshur edhe pa lejen time. Dhe përse pa?...

— Patjetër ai e ka veshur! — shfryva nëpër dhëmbë. Dola në korridor. Ngrita bravën e portës dhe i mëshova lehtë. E tërhoqa dorezën pas vetes. Tani s'mund të haqej nga jashtë. I vura edhe çelësin.

— Le të çohet nëna t'ia hapë portën pas mesnate, dhe t'i japë llogari, pastaj, ku ka qenë, Le të na e pohojë se ka qenë me nusen, po që burrë, — thashë me inat, i sigurt se s'ia mbante as prej nënës as prej meje.

— Me nusen, — përqesha me neveri.

Nuk e di pse, por sa vinte dhe Lejlanë nuk mund ta vështroja ballazi. Më duket se im vëlla, dhe ajo ca më shumë, më kishin poshtëruar me dashurinë e tyre, që e kishte mësuar tani tërë fshati...

U shtriva në krevat dhe u mundova të mbyllja sytë. Era u bë edhe më e fortë. Nuk dëgjohej as kënga e zogjve të natës. Xhamat e dritareve dridheshin lehtë. Nga fundi i fshatit dëgjobeshin të lehurat e një qeni. Fika dritën e abazhurit.

Tani mbase po troket me guralecët e vegjël të vijës së ujit në dritaren poshtë rrugës, ku fle Lejlaja. Hë, çilimi, çilimi, shpërvola buzët në errësirë.

Ose bëjnë dashuriçka fshehur pas murit të murmë të ndonjë avllije.

Se do të mbetej pa nuse, posi! Zëri u përnda nëpër skutat e dhomës. Kërcita dhëmbët si vetiu. Nga pullazi i shtëpisë sonë shkanë poshtë dy-tri tjegulla, që u thyen me zhurmë nën strehë. Në dhomën përballë përplasej dera me zhurmë.

Para se të ikte ushtar, e patëm sjellë rrotull bisedën për punën e Lejlasë, po të dy sikur druheshim. Unë desha të ma pohonte, pastaj, hë, dija unë se si i përgjigjesha, se e kishte marrë si shumë kaluar, i kishte rënë në sy fshatit dhe ndaj po më shihnin dhe mua vëngër. Por ç'e do, më vidhej kur ia sillja fjalën rreth saj.

Njëherë kishte guxuar e kishte thënë diçka për radhën e martesës, se s'kishte rëndësi vëllai

i madh, apo i vogli. Një gjë të tillë kishte thënë, po Lejlarë s'e kishte zënë me gojë. Unë isha ndezur e kisha marrë zjarr. I kisha thënë diçka si klasike.

— Po të ngriheshe e ta propozoje ti këtë rregull në mbledhjen e fshatit, dije se do të të luanin në hu. — Ai më kishte dëgjuar në heshtje. Pastaj kishte ngritur kokën, më kishte parë drejt në sy dhe më kishte thënë:

— Jo të gjithë, po ndonjë si Dulla dhe si ti mundet.

Pas kësaj kishte dalë, se kishte parë që mua më ishte dredhur buza nga inati.

Û mbusha thellë me frymë. Gjumi s'po më vinte. Shtrëngova qepallat kushedi për të satën herë gjatë asaj nate. Te ndërtesa e shkollës u thyen xhamat e ndonjë dritareje të çelur. Kërciste dera e dhomës fqinje herë-herë. Kushedi sa mund të ishte ora. Lastarët e hardhisë gërvishtnin mbi xhamin e dritares me hekura.

— More, po ç'kishin le ta mbanin të fshehtë, mos e merrte vesh fshati. Pastaj, unë e gjeja një nuse ashtu shpejt e shpejt dhe çdo gjë mbaronte për bukuri, e jo kështu...

Hapa sytë. Errësirë. Ndeza dritën e abazhurit dhe u çova mbi bërrylë. Kjo që kisha thënë, nuk më pati shkuar ndër mend më parë dhe më çuditi.

— Sa lehtë, hë, sa lehtë, — thashë duke ngërdheshur fytyrën e duke shfryrë nëpër hundë. Trokitën pikat e para të shiut mbi xham.

— Thua të vijë tani, — pyeta veten.

Desha të isha dëshmitar i asaj që do të na thoshte mua dhe nënës e pastaj do të shihte ç'e priste! Të nesërmen ai duhej të ndodhej në repartin ushtarak. Nga fshati ynë deri aty duhej të ecje katër orë nëpër monopatet e ngushta të pyllit. Mbase nuk do të kishte kohë fare për të fjetur. Mblodha buzët.

— Le që ku pyet dashuria për gjumë, — ironizova. U çova përsëri. Hoqa nga varësja kapelën e tij me yllin e kuq. E mbajta në dorë dhe pastaj e vura në kokë. U përplas përsëri dera e dhomës përballë. Dola ta mbyllja. Shiu dëgjohej më qartë tek zhurmonte mbi pllloçat e oborrit dhe shkallët prej guri. Mbylla derën e dhomës nga veriu dhe mbeta në korridor.

— Mbase tani është mesnatë dhe ai do të vijë. — M'u bë se ndjeva të shtyhej porta. Futa kapelën me yllin e kuq nën vete. Dëgjoja frymëmarrjen time të rënduar. Heshtje. Çirrej era.

Nuk ka njeri, fryn era, qetësova veten. Shiu duhej të ishte dendësuar edhe më. Zhurma e traktorit, që lëronte në të dalë të fshatit, në tokat ndanë lumit, nuk dëgjohej më.

Toka do të jetë bërë baltë, mendova, le që në anët tona mjafton një vesë shi që të mos lërohet. Diku nga shtëpia e Muçkollinjve dëgjohehin të lehurat e një qeni. Andej e kishin shtëpinë dhe Gjatollët. Disa herë kisha menduar se ku mund të ndodheshin ata. Shtrembërova fytyrën me neveri. Pastaj çela portën. Lagështia

e natës dhe piklat e shiut më bënë të ndieja të dridhura. Këmbët e zbathura m'u lagën.

Edhe ai i lagur do të vinte.

Befas, në rrugë, në errësirën e natës, u ndie zhurma. Një si zë njeriu. Kërciti gardhi i vjetër i oborrit.

Erdhi, thashë dhe u drodha, mbase nga të ftohtët. Kapa me dorë kanatin e portës dhe ajo më ngriu mbi të.

T'ia mbyll? — pyeta veten si nëpër dhëmbë. Ai çapitej nëpër kopsht drejt shtëpisë. Silueta e tij nuk shquhej në errësirë, por unë e ndieja nga hapat se ku ishte. Më erdhi turp që po e përgjoja. Këndonte ai me zë të ulët, apo zhurmonte shiu ashtu? Lëshova ngadalë portën e çelur të korridorit dhe u hoqa me të shpejtë në errësirën e dhomës. U futa nën batanije.

Më mirë shtirem sikur më del gjumi kur të hapë dritën, sesa të kuptojë që po e prisja dhe po e përgjoja.

— Ku ke qenë, — do t'i them, — sa e ke orën? E di?

— Jo, po ja, ishim me shokët në vatrën e kulturës, — se nuk do t'ia mbajë të thotë të vërtetën, s'ka si të thotë ndryshe.

— Ku, more, atje s'ka pasur as dritë e as zëra!

Nëna do të zgjohet nga fjalët tona. Do të ngjitet shkallët e drunjtë për në dhomën tonë dhe pastaj... E di ai pastaj se ç'e pret. Merrja frymë me të shpejtë nën batanije. Ai hyri në dhomë.

Freskia e natës hyri pas tij. Ndezi dritën. U dëgjua një tingull i kitarës. Dukej se po e fshinte nga shiu. Edhe kur e vari në varësen e murit, e ndjeva nga përplasja e lehtë e saj.

«Mbase tani po bëhet gati të flerë, dhe unë duhet t'ia them ato që kam menduar. Apo do niset për në repart? Ndoshta ka kaluar mesnata dhe ai duhet të niset.»

Për herë të parë u kujtova për kapelën e tij ushtarake që më kishte mbetur nën vete. E gjeta afër jastëkut. Ndjeva zagushi dhe të nxeh-të mbi faqe. Ç'deshi kapelja e tij nën jastëkun tim?...

«Tani do ta kërkojë.» Më rrihnin tëmthat. U çova mbi bërryla. Ishim ballazë. Xhuvit i ndriste fytyra, ndoshta nga bulëzat e shiut që ende nuk i ishin tharë. Petale nga lulet e një molle i ishin ngjitur afër ballit, mbi kokë. Krahët e zhveshur i kishte të bulëzuar dhe pantallonat i kullonin ujë. Mbi dysHEME, këmbët e zathura i kishin lënë gjurmë. Pa ngritur kokën, i zgjata kapelën. Edhe pa e parë, më dukej se ai buzë-qeshte. Nuk dija ç'të thosha. Kisha mbetur go-jëkyçur. Ai zhvishej shpejt dhe gatitej për të veshur rrobat ushtarake. Nuk guxoja ta vështroja në sy. Duart i kishte të lagura, këmishën të lagur, pantallonat të lerosura, të hedhura mbi dysHEME, ndërsa pardësynë... E kërkova me sy, por nuk e pashë gjëkund nëpër dhomë.

Kushedi si do ta ketë bërë? Dhe për herë

të parë gjatë atyre çasteve më hipi inati dhe mendova me neveri se ku kishte qënë deri në atë orë nëpër shi.

— Pardësytë? — e pyeta me zë të plotë.

Kushedi ç'gënjeshtrë do të këputë, mendova dhe picërrova sytë mbi të.

Ai më pa një çast drejt e në sy, pastaj uli kokën.

— Ia lashë... — foli dhe zëri iu drodh.

— Si? — pyeta unë, që dūhej të isha ndezur keq nga inati.

— Isha me Lejlanë dhe ajo... — Krahët i lëshoi si padashur pas kofshëve të lagura dhe anoi kokën lehtë. I pengohej zëri.

— Shiu filloi papritur... Ajo ishte veshur hollë dhe unë... Ti e di që e dua. — Fjalët e fundit i tha ngadalë, shumë ngadalë, saqë mua m'u bë se kishte pëshpëritur era. Shiu kishte reshtur.

— Ti e di që e dua, — kishte thënë ai dhe mua sesi më ishte dukur. E vështroja te këmbët. Kisha menduar sa e sa gjëra për ta dhe, për çudi, të dy as që e kishin pasur frikën time. Nuk dija ç'të thosha. Kjo më kishte përhumbur e topitur të tërin. Në zërin e tij të dridhur s'kishte frikë, por druajtje, respekt,

E si mund të ma tregonte ndryshe im vëlla të fshehtë e tij për Lejlanë më mirë se ashtu, me sy të dhembshuruar, me zë të paktë dhe ngalëz të thellë, i lumturuar? Kurse unë kisha menduar...

Strehët pikonin. Hapa dritaren. Kisha vapë.

Hyri era e athët e barit dhe e luleve të çelura ndanë lumit. Gjumi më ishte larguar. Zbërtheva kopsën e këmishës nën fyt. Kushedi për të satën herë po pëshpëritja me vete. Sa turp, kisha menduar aq gjëra të ulëta për tim vëlla dhe Lejlanë e Gjatollëve....

U çua nëna dhe pas saj edhe motra e vogël. Nëna pyeti për gjurmët e ujit mbi dysheme dhe vështroi nga unë. Buzëqesha duke e parë me lutje e qortim në bebëzat e syrit. «Mos e qorto!» — i thashë me sy. Pastaj ia mori kokën e qethur në gjoks. U ktheva shpinën dhe psherëtitja i lehtësuar. Unë u vështa i fundit dhe Xhuvin e përcollëm të tre deri te porta e jashtme. Shiu kishte pushuar prej kohe. Nëna i jepte porositë e veta.

— Mollët që të kam vënë në çantë, janë të fundit që kisha ruajtur. T'i hash me shokët. — Ndërsa motra e vogël përsëriste herë pas here numrin e repartit ku shërbente im vëlla, për të mos e harruar. Ajo do t'i shkruante letra veç neve të tjerëve.

TE KILOMETRI 39

Makina e kooperativës la pas kthesën e fundit të rrugës nga ku dukej bora e bardhë e Gramozit e rënë rishtas ditët e fundit të nëntorit. Agronome Doli, mbështetur në xhamin anësor të kabinës, kundronte ngastrat e fundit që mbilleshin me grurë.

Shoferi u mat të thoshte diçka dhe vështroi nga pasqyra fytyrën e agronomes. Doli ishte përhumbur në një ravijëzim buzëqeshjeje, që i përndahej mbi mollëzat e kuqura të faqeve.

«Mbasë mendon për dikë, — tha me vete. — Ku të jetë ky dikush? Atje tek shkojmë, apo atje ku ishim?» Shofer Ilia do të donte që dikushi të kishte mbetur pas, aty te kavaletat e mollëve mbuluar me rrogoza kashte. Dhe sepse i bëhej ky si brigadier Hektori... Psherëtiu. Diçka iu kujtua

nga rinia e tij. Doli lëvizi mbi ndenjëse. Tokat e lumit të sipërm nuk prisnin më, duheshin mbjellë ato ditë. I kishin pluguar në mot të mirë dhe ato ishin derdhur. Atë natë, kur i pluguan, ajo kishte qenë aty, së bashku me brigadiere Lirinë. Qëndronte në ndenjësen e plugut, kur traktoristi kishte qëndruar traktorin dhe ata të gjithë kishin vrapuar drejt një lepuri të egër të tulatur në brazdë nga dritat e forta të traktorit. E kishte kapur Agroni. Atë natë e kishin mbajtur në traktor, të nesërmen e kishin mbyllur në një kafaz me sitë teli, në shtëpinë e Lirisë. Doli donte t'ia çonte nipit në qytet, por të shtunën nuk shkoi; problemi i mbjelljeve, plugimi i moçalishtes, dorëzimi i duhanit në ndërmarrjen e grumbullimit... e lepuri kishte ngordhur.

Mbërritën te çezma e vreshtit, në të dalë të fshatit, afër qytetit. Ilia ndali makinën. Të gjithë shoferët qëndronin tek ajo çezmë. Uji zhurmonte nëpër gurë. Cicëronin harabelat majë plepave.

— Urdhëroni mollë të mira, — u dëgjua një zë burri pas tyre.

Doli u shtang, pastaj u kthye rrëmbimthi nga erdhi zëri. Ai që shiste mollë, kishte ngulur vështrimin mbi siluetën e shofer Ilos, që lante makinën, dhe nuk e vuri re fare vajzën që afrohej drejt tij. Në dorë mbante një mollë që e fshinte herë pas here me mëngën e xhaketës.

— Mollë me pesë... — tha ai mekanikisht, pa e pasur mendjen. Doli ia mori mollën më shpejt se ai ta tërhiqte dorën pas.

— Dikur këto mollë i kemi ngrënë pa lekë, ti e mban mend, — tha ajo. Në zë kishte mëri dhe keqardhje.

— ...

— Më patën thënë se ishe katandisur në një matrapaz qyteti, por s'desha ta besoja.

Ai turfullonte me vete a belbëzonte, s'merrej vesh. Llërët e mëdha i mbante mbledhur nën sqetulla, sikur donte t'i shtypte e t'i fshihte aty.

— Eh, o Gjokë... Ja se si...

Deshi t'i thoshte një fjalë të rëndë, turp a diçka tjetër, por nuk mundi dhe veç psherëtiu. E lëshoi mollën përtokë dhe ajo u rrokullis drejt këmbëve të tij. Vajza i ktheu krahët dhe eci me nxitim drejt makinës. Shofer Ilia ishte shtangur.

— Ah, ç'ia bëre, — përsëriti ai disa herë.

S'kishte dëgjuar gjë, por mollën që rrokullisej nën këmbët e tjetrit e kishte parë. Makina ishte nisur. Gjoka vështronte renë e pluhurit që mbeti pas. «Dikur këto mollë i kemi ngrënë pa lekë», i gjemonte në vesh. U ul afër arkës së mollëve. Biçikletën e kishte lënë ndanë rrugës, mbështetur te guri i bardhë i kilometrit tridhjetë e nëntë. Ndjeu të ftohtë në tëmtha. Iu afrua një grup fëmijësh, por ai s'i ndjeu. I kërkuan mollë duke i zgjatur lekët.

— Nuk shes, — u përgjigj ai si nëpër tym, me sytë përhumur nga makina që ngrinte re të murme pluhuri drejt qiellit. I hipi biçikletës dhe u nis drejt qytetit...

*
* *
*

«Turp, turp, sa poshtë ke rënë, ku ke arritur, o Gjokë»... Doli nuk kishte thënë asnjërin nga këto fjalë, megjithatë... Kishte disa kohë që ai nuk e kuptonte fare se ç'po ndodhte me të. Në fillim e pati nisur thjesht. Kishte shitur disa kilogramë mollë që ia pati lënë i ati. Kishte dalë gati rastësisht nga pazari i qytetit atë ditë. Mërzitej pa punë dhe dilte. Kurse babai tregun e qytetit e kishte vendin e tij të preferuar. Domsodo, kishin goxha pemëtore rreth e rrotull shtëpisë. Pastaj shiti edhe një ditë tjetër, të dielën e parë të tetorit dhe sesi i ishte dukur vetja. Në fillim edhe i kishte ardhur zor, por më tej ishte mësuar. Madje tani, edhe kur qëllonte që ndonjë vogëlush t'i zgjaste në pëllëmbë tri qindarka për një kokërr mollë, vetvetiu ai i zgjidhte një kokërr të vogël e të brejtur nga krimbi.

Më pas, tregu ishte mbyllur në qytet. Të atin e kishin thirrur njëherë në këshillin e lagjes për t'i çuar prodhimet në dyqanin e shtetit, por ai s'kishte dëgjuar. Kishte vendosur t'i tregtonte rrugëve, në të dalë të qytetit. Jabanxhinjtë dhe shoferët kanë parë të madhe, thoshte ai. Po për këtë ai s'kishte më këmbë, ndaj puna i mbeti Gjokës.

Kalonin ditë dhe ai, agronom Gjoka, as që po kujtohej për të filluar punë aty ku e kishin emëruar në fillim, në kooperativën e thellë malore të Kodrasit.

Të gjithë thoshin se Gjoka kishte duar të arta për frutikulturë. E pse të mos e mbanin diku në fermën e frutikulturës pranë qytetit? I ati shpresonte, ndaj shpresonte edhe ai.

Hyri në shtëpi. Mbështeti biçikletën pas portës dhe eci drejt kopshtit prapa shtëpisë.

E ëma i thirri që lart nga kati i sipërm. Nuk iu përgjigj. U ul mbi trungun e prerë të qershisë. Po binte mbrëmja.

... Edhe atëherë mbrëmje ishte. Mbrëmje korriku. Ai ishte zgjatur pranë dritares së saj. E dinte që Doli diku atje flinte. Kishte pirë një gotë raki, as vetë s'e dinte pse, por ja që atë mbrëmje e kishte hedhur një gotë. Nuk dinte se ç'do t'i thoshte, mjaft që të pëshpëriste emrin e saj. Vetëm kaq.

Një vijë uji zbriste nga tuneli i Qafëthanës dhe zbardhte nën dritaren e barakës ku flinin vajzat e kursit të tyre! Ishte ujë i ftohtë, ndaj thoshin se zbardheshin gurët.

Gjoka pëshpëriti me zë të paktë emrin e saj. Veç krakavitjeve të gjinkallave dhe ujit që zhurmonte nën këmbët e tij, nuk dëgjohej gjë tjetër. Mbërtheu duart mbi shtyllën e drunjtë në cep të barakës.

— Doli! — Asnjë përgjigje. Vajzat flinin herët se edhe çoheshin herët. Tutje nga qyteti ndihej fërshëllima e trenit të punës që shtronte trasenë. Mbi degët e drurëve aty pranë lodronte drita e hënës. Sërish thirri emrin e saj. U dëgjua kërcitja e kanatit të dritares që u çel. As vetë s'e

kuptoi pse u mundua të fshihej. Tek largohej i hutuar, u llapashit në ujin e ftohtë të vijës. «Plluq... Pllaq... Plluq...»

Dëgjoji të qeshurat e vajzave që nxorën kokën në dritare.

Atë natë me zor e kishte marrë gjumi. Të nesërmen priti që Doli t'i thoshte diçka, por kjo s'ndodhi.

Ata i kishin folur shumë njëri-tjetrit me sy e me zemër, por fjalë s'kishin mundur të këmbenin. Veç një ditë, tek rrëshqitnin të dy me vagonetin e veglave të punës, Gjoka i kishte thënë se kishte lexuar një tregim të bukur të Çehovit, që tregonte se si rrëshqitnin me saja në borë një djalë dhe një vajzë, së cilës i dukej se ai i pëshpëriste: — «Nadja, të dua...» Doli i kishte thënë se e kishte lexuar dhe i kishte pëlqyer ai tregim. Ai e kishte parë me kureshtje.

Kishin ardhur ditët e fundit të aksionit, por asgjë s'kishte ndryshuar midis tyre. Megjithatë të dy kishin një shpresë të fshehtë. Në qytetin e tyre të vogël do të kishin rast ta shihnin shpesh njëri-tjetrin dhe atëherë, ndoshta, ai do t'ia thoshte të gjitha, të gjitha...

U çua nga trangu i qershisë dhe eci drejt pjergullës së madhe që ishte mbështetur në trupin e mollës karapashe.

E kishin emëruar në kooperativën më malore të zonës dhe ai nuk kishte pranuar. Në fillim i ati ishte bërë shkas, pastaj Gjokës edhe sikur i kishte pëlqyer. Një nga ata të kuadrit në ko-

mitet i kishte premtuar të atit për ta afruar diku më pranë. Mik nuk e kishin vërtet, por, kur ai i komitetit kishte marrë diplomën, notat, dhe kishte mësuar se ishte djalë i vetëm... kishte thënë se do t'i gjenin një vend diku afër, mbase edhe brenda në qytet.

«Pritëm që pritëm, — kishte thënë i ati, — le të presim edhe ca.» — E kështu kishte mbetur puna. Në fillim Gjoka mërzitej vetëm në shtëpi, po pastaj puna me drurët e kopshtit e kishte përkëmbur dhe nuk e ndiente vetminë.

... Fërkoji sytë me pëllëmbë dhe shpupuriti flokët. Kështu bënte gjithmonë kur donte të zgjidhte diçka të vështirë, që i pushtonte mendjen. U mbështet te hardhia. Lëvoren e thatë ia shkërmoqi me duar. Nën të lëvrinë insektet e zbuluara nën dritën e diellit... Kopshtin me drurët e zhveshur nga vjeshta e kishte përballë. Sa herë ishte lodhur e djersitur tek ato pemë! I kishte krasitur vetë, i kishte spërkatur dhe punuar si jo më mirë. Le pastaj ajo vjeshtë që po mbaronte! Sa e begatë kishte qenë, me mollët erë-mira, me ftonjtë verdhoshë, me vilet e zeza të rrushit dhe kokrrat e tyre qelibar!

Punën me kopshtin e kishte filluar që vitin e parë të studimeve, në verë, pasi ishte kthyer nga shkolla. Do të fuste shkencën. I ati ishte i kënaqur pa masë. Disa ditë më pas i ati i pati thënë se duhej ta prisnin qershinë e vjetër, te qoshja e shtëpisë.

— Pse? — e kishte pyetur ai.

— E ç'ta duam? Mbjellim një mollë të hershme në vend të saj. Qershitë e saj nuk shkojnë fare!

I biri nuk e kishte nuhatur dot nëse i ati e kishte fjalën se «nuk shkojnë për pazar, apo nuk vlejné si lloj gjysmë i egër». Kishte pranuar ta prisnin. Ai mbase do të donte të kishin mbjellë një ftua, por... «Rrobat e tua mbajnë erë ftua», i thoshte gjithmonë Doli.

Të nesërmen kishte filluar nga puna. Trupin e saj e preu shpejt. Qershia ra mbi një mollë dhe theu dy degë. Të atit i kishte ardhur keq dhe i kishte bërtitur. Gjoka nuk ia kishte vënë veshin. Për tre-katër vjet të thyerat i zëvendësoj me shartesat më të mira, kishte thënë. Pastaj kishte filluar të çelte gropën për ta shkukur trungun me gjithë rrënjë. Duart i digjnin nga bishti i lopatës i gdhendur keq. Djersët i kullonin mbi ballin e gjerë dhe i merrnin vetuliat. «Ajo i ka qejf ftonjtë», — tha gati me zë dhe iu bë se aty, përfund avllisë me gurë, pa Dolin, me një shami të bardhë rreth kokës. La kazmën dhe u ul të ndizte një cigare. Tërë atë ditë nuk e hoqi nga mendja Dolin, duke e përfytyruar s'dinte sesi. Pasdite doli në rrugë. Por më kot. Nuk e takoi dot gjëkund.

Të nesërmen ai tha me vete se sigurisht do ta shkulte trungun e qershisë. Gropën e kishte hapur të gjerë, i kishte prerë dhe disa rrënjë, por ajo s'donte të lëkundej. I ati i shkante shpesh dhe herë pas here i thoshte të pushonte.

— Ke kohë, mos u ngut.

Këtë ia pëshpëriste kaq shpesh, sa erdhi një kohë dhe atij zunë t'i cingëriseshin nervat nga kjo përkujdesje. Donte të ngutej, as vetë s'po e kuptonte se pse...

Punoj pa ngritur kokën. Edhe bukë nuk hëngri.

Vonë në mbrëmje u kujtua përsëri për Dolin. Hodhi kazmën në gropën gjysmë të çelur dhe doli në rrugë... Në shtëpi u kthye vonë. E ëma ishte merakosur. I lodhur më kot rrugëve, ra të flinte pa ngrënë. Gjumi e zuri shpejt. U ngrit pa gdhirë. E tundi me të dyja duart trungun e qershisë, të cilën vetëm rrënja e mbante në këmbë.

«Kjo duhet të jetë e fortë, — mendoj, — por unë do ta shkul.» Dukej se do të ishte një ditë tepër e lodhshme. Kishte ndenjur me orë të tëra mbi shkallaren e drunjtë me tri këmbë nën tendat e hardhive, kur i krasiste (dhe atëherë kishte qenë student), kishte punuar tërë kopshtin me bel qilizmë, me të lëvizur dheun, dhe prapë s'kishte ndier të lodhur të tillë. E ja, trungu i qershisë, në vendin e së cilës do të mbillte... Çfarë? Tjetër punë se çfarë, mjaft që tani ta shkulte. Pasdite e kishte palosur përtokë dhe e kishte zvarritur përfund oborrit. I drobitur, ishte shtrirë të çlodhej në dhomën e freskët nga veriu... E kishte zënë gjumi. E ëma s'e kishte zgjuar as për të ngrënë darkë. Vonë, në mesnatë, kishte hapur sytë. Befas ishte kujtuar për Dolin. Kishte parë orën. Dymbëdhjetë e gjysmë. Kishte buzëqeshur hidhur. Pastaj sërish kishte fjetur.

Të gjitha këto i solli ndër mend atë ditë që takoi Dolin te çezma. Kurrë nuk e kishte ndier veten aq ngushtë. Një plogështi i kishte mbërthyer trupin. Në dhomën e bukës gjeti të emën dhe një fqinjë, Sanijen. I ati nuk ishte. Sapo u dha në derë, gratë lëvizën dhe morën fjalën. Mbi tryezë e ëma kishte vënë në frutierë mollë karapashe të lyera si me vaj dhe starkinga të kuqe.

Ai nuk ua vuri veshin bisedave të tyre.

— Të lumshin duart, të vish të na i presësh cazë edhe neve mollët për mot, — ia bëri fqinja.

— Si? — tha ai.

Si nëpër turbullirë, iu kujtua se e ëma i kishte folur një ditë për mbesën e Sanijes, që ishte farmacistë... Buzëqeshi shëmtuar. Vështroi mollët mbi frutierë.

«Dikur i hanim pa lekë», kishte thënë Doli.

U çua duke i lënë gratë në muhabetin e tyre dhe u ndeh në dritare. Gropa e qershisë, me dhe të murmë, kishte mbetur e hapur gati për t'u mbjellë asaj vjeshte. Doli jashtë.

«Sa turp, — mendoj. — Kjo gropë duhet mbjellë sa më parë.» Po afronte mbrëmja. Nga perëndimi qielli ishte përflakur. Tëmthat i digjnin. Eci drejt qendrës së qytetit. I bëhej se kishte humbur diçka nga vetja, diçka të madhe, të cilën po e ndiente pas kaq kohe...

— Duhet të filloj menjëherë... — tha me zë të paktë.

Lëshoi duart poshtë. Nxitoi hapin.

— Nesër ti duhet të nisesh, — i tha vetes me zë. — Kjo që ke bërë deri tani, s'është veçse një kotësi për të ardhur keq.

Pastaj nënqeshi hidhur.

— «Më parë duhet ta mbjellësh atë gropë me një filiz ftoi», — tha.

Doli në shëtitore, ku kishte shumë njerëz.

PLAKU I NJË FSHATI

Plaku u çua duke u shtritur nga këndi i ngroh-
të pas stufës dhe bëri për nga pragu i portës.
Ishte ende natë, po për moshën e tij ishte e
zakonshme të hynin në kufijtë e njëra-tjetrës
dita dhe nata. U mbështet në kanatin e vjetër
të portës me dhoga pishe e, duke vështruar obo-
rrin, vetiu ngriti sytë drejt qiellit. I picërroi nga
flokët e borës që i ranë mbi vetulla e qepalla.

— Ua! Paska shtruar! — tha me zë në errë-
sirë.

Ishte bora e parë e atij viti, që binte me flokë
të mëdhenj dhe të dendur. Muret e murme të shtë-
pive dhe avllitë dukeshin si të përgjumura nën
atë fijëzim të dendur që kishte mbuluar strehët.

U fut brenda. Porsa vështroi të nipin që flinte,
nënqeshi.

Do të zgjohet dhe do të kërkojë burrë prej dëbore, me sy, veshë dhe gojë prej thëngjijve të zinj, të shuar, mendoi.

Mori ashkla druri të thata dhe ndezi zjarrin me prushin e mbuluar me hi që në mbrëmje.

Kujtoi se vetëm një natë më parë ishte krejt ndryshe. Ai kishte mbledhur purtekat e fasuleve, të lidhura vandak që në vjeshtën e vonë e që i pati mbështetur mbi trungun e mollës së vjetër të oborrit. I kishte vendosur shtrirë, nën strehët e hajatit, mbi dy drurë, që të mos kalbeshin nga dimri. Pastaj kishte zënë plasat e derës së ahurit të bagëtive me rrecka të vjetra dhe plastmasë, sikur ta kishte ndier se atë natë do të trokiste dimri me borë dhe ngrica.

U mundua të kujtonte gjithçka që duhej ta kishte vënë në vendin e vet dhe ta kishte siguruar përpara se ta zinte dimri.

Dalëngadalë kishte zbardhur. Bora flokonte më rrallë. Doli jashtë. Erdhi për qark shtëpisë. Këmbët i linin vrage. Erdhi edhe një herë qark, deri te porta e jashtme, pastaj deri te ahuri i bagëtive. E hapi derën. Avulli i ra në fytyrë dhe sakaq i shkriu mbi vetulla dhe mbi flokë okitën e hollë.

Harabelat uleshin pa frikë mbi parvaz të dritares, madje edhe në pragun e gurtë të ahurit, fill nën këmbët e tij, dhe s'donin t'ia dinin se aty afër gjendej një njeri. Mbylli derën dhe doli në rrugë. La pas shtëpinë dhe eci ngadalë drejt sheshit të fshatit.

Ashtu i paktë nga trupi, rrondokop, me këmbë të shkurtra dhe të hapura, me duar të lëshuara poshtë pas shpine, kishte vite që ecejakte çdo mëngjes, nga shtëpia gjer te çezma, dimër e verë.

Te çezma me dy sylynjarë të bronztë, që sillnin ujë nga burimet më të ftohta të Moravës, mbajti çapin. Herë-herë floktonte borë e rrallë. Tutje fshatit dëgjoheshin lehjet e një qeni. Tufat e mëllenjave ngriheshin të trembura nga dheu i zi, nën gjerdhet e rrëzuara nga bora, sapo kjo platitej me zhurmë nga ndonjë degë peme.

— T'i shoh si m'u gdhinë nga Taqua, — pëshpëriti Plaku. Pa u menduar gjatë, u nis andej, për te familja e fundit e fshatit, për tek e shtata...

Kohë më parë, fshati i tij në gji të malit kishte qenë i madh, me më shumë se dyqind shtëpi, por më tej... lufta, gjermani, që e pati djegur tri herë dhe që pati vrarë burrat, kishin bërë të tyren... Pa edhe dimrat që pasuan luftën kishin qenë të egër. Me borë dhe bukë pak! Kështu që mjaft nga fshatarët e tij morën poshtë fushës...

Plaku s'kishte dëgjuar të luante nga fshati. I dhimbsej gjithçka: që nga druri i vjetër i kumbullës përbri oborrit dhe deri te gurët e rrugëve të kalldrëmta.

Kështu kishte mbetur me të dy djemtë, atje në fshatin e tij, në zemër të malit, ku zinin fill ujërat e Devollit.

Në fshat tani bëheshin gjithë-gjithë shtatë

familje! Taqoja me shtëpinë në fund të bregores, Vasili i Dhimos në krah të tij, Jorgoja në të majtë të çezmës, në të djathtë Sotiri, Vasili i Plakut afër dyqanit, dhe në fund, ngjitur me shkollën dhe muzeun, shtëpia e Kristos, më tutje... Hëm, më tutje?!...

Plaku kujtoi me mend dhe tha me sek të brendshëm:

— Më tutje është Lefka, Pandi i Thomait, Pandi, Vasili i Ilos, Gaqua i Thinës... — Rrudhi ballin. Nuk dëshironte të kujtonte shtëpi të tjera pa njerëz, që ngriheshin mbi faqen e malit si karabina.

Picërroi sytë dhe u nis nëpër dëborën që kërcente nën këmbët e tij, krap, krap, drejt shtëpisë së Taqos.

Shtyu portën. Guri i rrumbullakët që kishte nga pas, lëshoi një zë të çjerrë duke u fërkuar me plloçat e ngrira të oborrit.

— Po akoma flini, bre Taqo?! — gjëmoi Plaku, kur ende nuk kishte hyrë mirë në derë.

Nga brenda u dëgjua zhurmë.

— Hajde, hajde, — u gjegj zëri i Taqos. Plaku shkundi borën dhe hyri brenda. Thuajse atë pak kohë që ndenji, ndenji në këmbë. Sa bënte të ulej, çohej dhe fap ia behte te televizori. Merrte që sipër tij një fotografi dhe e këqyrte.

— Vasili është, djali që kemi ushtar, — sqaronte e reja e Taqos.

— E njoh, moj, si nuk e njoh, — ia kthente Plaku si i fyer. Pastaj shtonte:

— Po një nuse s'i keni gjetur, xhanëm?

— Nusën e gjen vetë ai, ja, sa të kthehet, — tha e ëma. Plaku nuk foli. Bëri të ulej, pa ua vënë veshin ankimeve të Taqos për dimrin e shpejtë, për këmbët me reumatizëm pleqërie, për mërzitjen...

Plaku u drejtua me hap të shpejtë nga tavolina pas derës.

— E paske blerë këtë libër, o Taqo?, hə? — tha dhe fshiu me pëllëmbë kapakun e librit «Mes njerëzve të thjeshtë», ashtu si vetiu. — E lexove? — pyeti përsëri.

— Kam edhe ca, po s'më ndajnë mirë xarxallat, — u ankua Taqoja.

— Thotë, thotë edhe për ne malësorët shoku Enver Hoxha këtu, — tha fytyrëndritur dhe përsëri fshiu me pëllëmbë kopertinën e librit. Diçka tha edhe Taqoja gjatë-gjatë, por që Plakut iu dëgjuan vetëm fjalët e fundit: «Them të rri këtë dimër andej.»

— Ku, bre Taqo, — kërcëu Plaku, sikur ta kishin pickuar, duke e parë në bebëzat e syrit. Tjetri guxoi ta përsëdytte fjalën:

— Po ja, andej nga djali i madh, nga Myzeqeja. — Plaku u thartua në fytyrë.

— S'është për këllqet tona ky dimër i egër, bre, — tha Taqoja me ankim, duke parë me bishtin e syrit Plakun që kërciste nofullat.

— Shko, shko, se pa ty s'bëhet Myzeqeja, — tha me qesëndi të hapur Plaku. Tjetri u mblodh

në këndin e krevatit pas sobës. Plaku e kishte marrë me të egër.

— He, o, rrëmëtyra! S'i pëlqeka dimri ynë, që na ka rritur e na ka bërë kaq, po dashka më të ngrohtë nga Myzeqeja, — fliste sikur të mos ishte aty brenda Taqoja, në krah të tij.

— Ke rrjedhur nga mendtë, matuf je bërë, — iu hakërrua ballazi.

— Po jo, bre, jo, këto ma ngrenë mendjen dhe rehatnë, mua, — dhe bëri me kokë për nga dera, ku sapo kishte dalë e reja, — pa unë s'luanja nga vendi, jo, — tha Taqua pa ia ndarë sytë si i zënë në faj.

Plaku e vështroi gjatë, por nuk i folë më. Boll, iu kthye mendja, mendoj.

Kishin qenë shokë të vjetër dhe ia patën dëgjuar fjalën njëri-tjetrit. Plaku erdhi rrotull edhe ca nëpër dhomë duke përtypur inatin, pastaj doli në oborr.

— Dimër i bukur, — tha me zërin e hollë si me vete.

U fut tek shtëpia e Vasilit të Dhimos, pastaj hyri edhe tek Jorgua.

Fshati i tij vërtet ishte i vogël, vetëm me shtatë familje, por për Plakun ishte i madh, shumë i madh, siç kishte qenë përpara luftës, prej dyqind e kusur shtëpish. Ai fshat, në zemër të malit, kishte qenë strehëza e batalionit partizan që vepronte asaj ane. Sa e sa aksione kishin zënë fill që nga fshati i tij?! Dhe tri herë pushtuesit kishin marrë malin përpjetë për të shkatërruar e djegur strehëzën e

partizanëve. Tri herë flakët kishin pushtuar qiellin. Herën e fundit, në shtatorin e dyzetetreshit, pushtuesi dogji e vrau ç'gjeti në fshat. Partizanët e batalionit luftonin larg, në Gramoz.

Atë ditë u vranë të njësitit të fshatit: Ilo Bodi, Ilua i Kicit, Niko Shkrepi, Pandi i Vanthisë, Papu Spirua... U vranë edhe dy partizanët e plagosur që ishin rrethuar në shtëpinë e Vangjelit...

Pastaj erdhën vitet e para të Çlirimit dhe ja, si e qysh...

Në fshat mbetën vetëm shtatë familje dhe shtëpi pa njerëz, të shpërndara mbi bregoren e malit, shumë.

Plaku nuk desh t'i kujtonte ato ditë kur vinin dhe i linin çelësat e shtëpive të mbetura pa njerëz. E fundit kishte ikur Lefka... Ai ndjeu ngalez mallëngjimi. Nuk dëshironte të humbiste nëpër kujtime të tilla. Iu dha këmbëve në të përpjetë dhe përballë shtëpisë së Jorgos qëndroi. Vështroi nga shtëpia e Thinës, gati gërmadhë. Psherëtiu.

Njerëzit ia patën lënë ato shtëpi me dhimbje, se i linin kështu një pjesë të jetës së tyre, i linin piskamat e foshnjave të porsalindura dhe gërmimën e pleqve të kërrusur nga vitet, i linin psherëtimat e dashurikave të fshehura nëpër zemra e të pëshpëritura mes lotëve netve nën velenxat e rënda, i linin kujtimet, gazin dhe helmet e tyre.

Plakut i bëhej se i kishin lënë gjëra të gjalla, me shpirt, ndaj kujdesej për shtëpitë e boshatisura ashtu si çdo të kujdeseshin edhe të zotët

vetë... Ishte i sigurt se kështu do të bënin të gjithë po të ishin në vendin e tij, Vasili, Pandi, Lefka, Kici...

Te Jorgoja ndenji pak. I la në dorë dy-tri kokrra arra dhe lajthi Arjanës së vogël dhe doli.

— Kam punë, — tha kur e lutën të qëndronte edhe pak, — dua të vete një çikë edhe gjer te Lefka!

— E po mirë! — ia kthyen ata dhe e përcollën deri te dera. «Te Lefka», — kishte thënë Plaku, dhe ata të Jorgos nuk e kishin lutur më të qëndronte. Ishte bërë kështu e zakonshme. Ata, të gjithë, gjashtë familjet e fshatit, ishin mësuar prej vitesh me ecejaket dhe vizitat e përditshme të Plakut, aq sa nuk guxonin të sillnin ndër mend atë ditë, kur nuk do ta kishin më...

Shkundi dëborën e këmbëve te pragu i portës, pastaj e hapi me çelësin e madh që tërë kohës e kishte mbajtur në dorë. Nga hapësira e kanateve bora kishte rrjedhur në dysheme e ngrirë. Plaku vështroi kllapat e liruar.

— Shiko, shiko! Lefkës i hykërka dëborë brenda! — U mëshoi kllapave lart dhe i mbylli. Në njërin dhomë fërgëllonin gjethet e thata të dukshkut.

«Zahireja e bagëtive», buzëqeshi ai. Ngjiti shkallët e katit të dytë dhe hyri në dhomën e zjarrit, aty ku kishte ndenjtur edhe Lefka. U ul në këndin përkrah vatrës. Vinte era e athët e baltës së oxhakut dhe e dërrasave prej pishë të dyshemesë.

— Lefka ishte grua e mirë! Hë, Lefkë, Lefkë!
—mërmëriti Plaku. Erdhi rrotull nëpër dhomë.

— Po si s'u bëre e gjallë, këtu e një vit të tërë, të vije një herë, moj Lefkë! — U rrudh me dhembje. Edhe pse e dinte që e përpjeta e Moravës, që nga lëmi i bereqetit e gjer lart në fshat nuk ishte për këmbët e Lefkës, ia kishte ënda ta shihte edhe një herë atë grua të paktë e kurrizdalë rrugicave të fshatit si vite më parë.

Përshekoi dyshemenë e korridorit që kërciste nën hapat e tij dhe u fut në dhomën e Partizanit. Frynte erë nëpër hatullat e çatisë dhe sillte fjolla bore në dhomën pa tavan. Çoi kokën. Trarët e çatisë ishin hepuar nën peshën e borës. Një nga ata të mesit ishte thyer dhe varej gati një pëllëmbë poshtë të tjerëve. Plaku kafshoi buzën sa i dhambi.

— Ç'bëhet kështu, xhanëm?! — tha me zërin e hollë në të ngjirur. E vështroi për një kohë të gjatë.

— Po në rëntë borë e madhe? Hë?! E di ç'bëhet këtu apo jo?! Na hape punë, na hape, — tha nën buzë dhe si vetiu fërkonte pëllëmbët e duarve me njëra-tjetrën.

— Do të të rregulloj, do të të rregulloj, — dhe u afrua te dritarja që shihte poshtë fshatit, duke përsëritur po të njëjtat fjalë. Uji i Kroit të Shumtë dëgjohej të gurgullonte si gjithmonë. Çatia e mullirit, që aty, dukej si një kapuç i bardhë që i ishte vënë një qenieje të stërmadhe, pasi anëmbanë tij nxinte vendi përmes ujërave.

Degët e arrës, mbështetur në anën e prapme të tij, ishin mbuluar me borë. Mbi bregore, te shtëpia e Vasilit të tij, oxhaku tymonte me fjolla të dendura. Fëmijët kishin dalë në oborr dhe luanin me topa bore. Qeshnin me zë. Plaku nuk e dëgjonte të qeshurën e tyre, por e ndiente. Qeshnin dhe gëzonin fëmijët... Fytyra e Plakut ishte mbushur plot dritë. I madhi u pengua dhe u përplas me burrin e bardhë prej bore. U shemb për tokë me gjithë të. Vajza e vogël qeshte fort duke përplasur pëllëmbët e vogla mbi gjunjë. Qeshte edhe djali i mbetur shtrirë mbi burrin e borës. Qeshte edhe Plaku me zë që nga shtëpia e Lefkës, pas xhamave të dritares.

— Gëzojnë nipat, — tha dhe bëri të hynte në dhomën tjetër. Drejt faqes së malit nxitonin silueta njerëzish me kazma në krahë. Atë vjeshtë arat e malit i kishin mbjellë me grurë. Ishte koha të hapnin lehet. Pastaj, te çezma në shesh të fshatit, dalloi dhe skuadrën e kooperativistëve të fshatit të tij të merrnin monopatin. Plaku u thartua në fytyrë.

— Hë, ju mundi qyqja, ju mundi! Të vijne gjyrsarët t'ju zgjojnë nga gjumi, — tha me inat. — Hë, rrëmëtyrat e djallit. — U ktheu shpinën dhe doli i bezdisur.

— Do bëjmë një ditë edhe ne një brigadë më vete, xhanëm, apo jo?

Këtë ia kishte thënë asaj vjeshte edhe kryetarit të kooperativës.

— Duhet të jeni mbi njëzet e pesë veta, — ia kishte kthyer ai.

— Po mirë, aq bëhemi ne, — i kishte thënë Plaku, — ja, edhe ne edhe fëmijët e shkollës bëhemi që ç'ke me të! — Kryetari kishte qeshur.

— Ju s'hyni në defterët e kooperativës, — i kishte thënë. Plaku e kishte parë pa qejf dhe me mërzi. Deshi t'i mbrehte njëherë qetë me të, se s'ishte parë gjëkund ta hiqnin nga lista e punës, ja ashtu, me një fjalë goje, por kishte dëgjuar fjalë të mira për të, dhe, veç kësaj, po sipas Plakut, s'shitej kali me një të penguar, ndaj s'e kishte cytur më tutje. Veç, ajo dëshira për t'u bërë një brigadë më vete me burra, gra, djem e vajza nga fshati i tij e digjte. Vështroi tutje fshatit dhe psherëtiu. Pa nga shtëpia e Vasilit të tij. Diç iu kujtua për të birin. Rrudhi ballin me mëri.

Edhe atë ditë kështu ishte rrudhur.

Ishte pranverë e viteve të shkuara. Një pranverë që të duket se zbret nga mali bashkë me gurgullimën e ujërave të borës që shterin dhe fijëzat e brishta të barit jeshil. Arave ishte endur ajo era e ngrohtë e tokës që të deh dhe të turbullon.

Një mëngjes të tillë, tek rrinte ulur në sofatin e gurtë para portës, i kishte thënë i biri:

— Baba!

— ...

Plaku e kishte vështruar në sy.

— Më kanë premtuar një punë në minierë, me zanat...

Plaku kishte kapsallitur sytë.

— E pastaj? — kishte pyetur me një mllef të papërmbajtur, duke ndier ç'deshi të thoshte i biri me ato fjalë.

— Fol, bre, pastaj?! — i ishte hakërruar i ati dhe ishte çuar vendit. Sytë i ishin skuqur prej inatit. I biri e kishte parë që e kishte shkelur rëndë dhe ishte hequr brenda portës.

Kurrë nuk ishte bërë fjalë ndonjëherë nga të tijtë për të lënë fshatin e për të gjetur punë gjatë, poshtë fushës... dhe ja, i biri...

Plaku, pa ditur se ç'bënte, kishte rrëmbyer parmendën varur në gardhin e oborrit, e kishte hedhur në sup dhe, pa pushuar mërmërimat dhe sharjet nëpër dhëmbë, kishte marrë tragën e ngushtë të livadheve mbi fshat, me dy mushkat e vëna përpara, të tijën dhe të Taqos. Tërë atë ditë pati lëruar si për të nxjerrë inatin, bashkë me Taqon. Ishin kthyer në fshat vonë në mbrëmje. I biri s'i kishte dalë fare në sy. E ndiente që e kishte shkelur me Plakun.

Kur solli ndër mend këtë skenë, Plakut i vërshoi gjaku i valë nëpër damarë.

Përpara se të linte shtëpinë e Lefkës, u kthye edhe një herë te dhoma e Partizanit. Hynte drita e zbehtë e borës.

Ja, nga ajo dritarja që binte në kopsht e kishte mbajtur zjarrin ndezur me dy pushkë për gjashtë orë Partizani. Pastaj i ishin mbaruar të flamosurit fishekë, dhe më tutje... Plaku mbylli sytë. Nuk donte ta sillte ndër mend skenën që kishte parë atë ditë të zezë. Ai kishte qenë nga

të parët që ishte futur në dhomën ku mbante erë barut të djegur. E kishin gjetur me një rën dorë mbështetur në hekurin e automatikut, mbi gjoks. Kishte marrë gjashtë plagë. Plaku i kishte mbyllur kapakët e syve me pëllëmbët që i dridheshin.

U vrenjt në ato kujtime. Psherëtiu thellë dhe sikur u çlirua prej tyre.

Çoi kokën. E mati edhe një herë me sy largësinë nga trari i thyer në dysHEME.

— Ty të mbajtën gjallë atëherë, kur ishte gjëmë, moj shtëpia e Lefkës, e jo sot. Nuk të lë Plaku ty të shembesh, jo! — tha me sek. U hoq nën shkallë. Nga stiva e druve të mbetura prej kohësh e të përlyera me jargë kërmilli, u mundua të gjente një dru të gjatë për ta vendosur nën trarin e thyer, po të gjitha ishin të shkurtra dhe gati të kalbura.

— U pa puna! Do shkuar në pyll, — tha Plaku e nënqeshi.

— Këto masa t'i kishte marrë me kohë, o Plak! Ç'janë këto lajthitje?! Dimër vinte, ku i dihej? A...! — tha me qortim.

Doli jashtë. Dielli ndriçonte i zbehtë nëpër re. Zbriti në shesh të fshatit dhe eci nga shtëpia. Në rrugë pa djalin e Sotirit që kthehej nga fusha me mushkën e ngarkuar me bukë dhe me një tog gazetash mbi samar.

— Tungjatjeta, o Plak! — përshëndeti djali.

— Si je, bre Peti, si je, bre bir? — ia ktheu Plaku me zërin e hollë e të ngjirur që i ngjante kuisjes së drurëve të thyer nga era e bora. Mu-

shka ndaloi vetë, dy-tre metra më tutje të zotit. Djali nxori nga mesi i samarit një gazetë dhe ia lëshoi në dorë Plakut.

— Më rrofsh, bre bir, më rrofsh!

Djali bëri të nisej me një buzëqeshje të lehtë në buzë.

— Dale, bre! — ia bëri Plaku. Peti u kthye përballë tij. — Sa dëborë kishte poshtë? — pyeti duke iu afruar edhe më.

— Ja, sa këtu.

— Punonin, punonin?

— Po, po, — tha djali duke tundur kokën kur ndoqi mushkën nga pas.

— E po e shikon, mirë, gjene, mirë. Dilman punohet...! — foli Plaku me zë më shumë për vete, se s'kishte njeri tjetër që ta dëgjonte. Djali e dinte se kjo ishte pyetja që përmbliidhte tërë merakun e plakut për fushën poshtë. Tani, kur po u afrohej të tetëdhjetave, këmbët s'i bënë më të merrte poshtë fushës, dy a tri orë larg, si në të ri.

Hyri në shtëpi. Pas pak filloi të binte borë.

Po në hedhtë shumë sonte, mendoi me frikë, duke sjellë ndër mend shtëpinë e Lefkës. Kërceu drejt e në këmbë. Doli dhe u drejtua nga vendi ku mbante veglat e punës, pas murit të prapmë të shtëpisë, në hajatin mbuluar me një çati të llamarintë që të mos i zinte shiu dhe bora. Mori në dorë sëpatën dhe eci përmes fshatit. La shtëpinë e Taqos, nga ku dukej përroi dhe në fund të tij, mbështetur mbi trungun e arrës së madhe,

mulliri. U var bregut tatëpjetë. Monopati i ngushtë i pyllit, që shtrihej pas mullirit, ishte i zënë nga bora. Dukej se andej moti kishte hedhur më shumë. Kaloi bregun dhe në të përpjetë filloi të dihaste me forcë.

— Hë, dhe një lotkë dhe arrij në pyllin pas mullirit, — thoshte me vete. Dëbora shkundej me zhurmë nga drurët e pishave dhe të aheve. Ishte mugëtirë. Dielli, herë-herë, dilte midis reve i vakët. Ja, sa të arrinte te mulliri, dhe vetëm pak më tutje do ta priste një manar¹⁾ të drejtë e të shëndoshë ahu për të mbajtur trarin e thyer në shtëpinë e Lefkës.

Frynte erë e ftohtë. Dridheshin diku nëpër drurë gjethet e mardhura dhe të thata, që bora e parë i kishte zënë ashtu papritur. Te mulliri qëndroi. Nuk donte ta besonte se ishte lodhur. Guri i sofatit ishte i mbuluar me borë. E rrahu me pëllëmbë dhe u ul mbi të. Uji gurgullonte mbytur nëpër kadet e drunjta.

Vite të tëra kishte punuar si mullis Plaku, e të gjithë në fshat ashtu e mbanin mend: mullis. Edhe kur ishin bërë kooperativë e poshtë fushës ishin ndërtuar mullinj e fabrika mielli që bluanin me qindra kuintalë bereqet në ditë, Plaku nuk kishte hequr dorë nga mulliri i tij dhe nga shërbimi që i bënte dita me ditë. Mullirit të tij s'i ngrinte uji kurrë, se, siç thoshte Plaku, ishte ujë i kulluar dhe i ngrohtë.

1) Dru ahu pa degë.

Iu kujtua ai vit kur ia patën nevojën mullirit në fshatin e tij, atje në zemër të malit.

Kishte bërë i ftohtë i madh dhe lumenjtë poshtë fushës kishin ngrirë dhe ishin bërë kallkan. Mulliri me korent, që ishte ngritur në qendër të kooperativës, kishte qenë me defekt të rëndë ato ditë, kurse mulliri i Plakut mbahej që mbahej. Ishin menduar ata të kryesisë dhe i kishin dhënë karar të ngjitnin bereqetin me mushka dhe me mushka të zbritnin miell, por veçta bluanin te mulliri i Plakut. Vërtet që pak bluante ai mulli, po Plaku ishte gati të punonte me natë e me ditë (këtë ai ua kishte thënë edhe në kryesi, kur e kishin thirrur). Nder ishte për Plakun, nder ishte edhe për fshatin e mullirin e tyre, që do të mbante me bukë në ditë të vështira një kooperativë të tërë... Dhe ashtu bëri. Por një natë jazi i ishte pakësuar nga uji dhe kadet e drunjta i ngrinte akulli. Plaku fët e kishte mbledhur mendjen. Uji duhej të rridhte nëpër kade ndryshe... akulli bënte gjëmën. Dhe i ishte përveshur Plaku jazit përpjetë me këmbët në ujë; thyej akullin dhe nxirr në breg me dy duar, gjersa kishte pastruar buzët e jazit dhe uji kishte rrjedhur si më parë nëpër kade, dhe trokashka kishte kënduar përsëri, «trak e trak, trak e trak».

Plaku kishte dalë fitimtar, dhe gaz më të madh zor se kishte ndier.

Po atë pranverë kishte martuar djalin e vogël me një nuse nga fusha. Dasma e djalit të tij

kishte qenë ngjarje e shënuar për tërë fshatin prej shtatë familjesh. Dhe nusja i kishte dalë e mirë, i kishte lindur dy nipër dhe prisnin një tjetër nipkë a mbeskë.

U mbush me gaz. U çua dhe eci drejt pyllit.

— Do ta shtojmë fshatin, do ta shtojmë, — tha me zë, — po. Dhe solli ndër mend nipin e Taqos që kthehej nga ushtria, çupën e Kristos e djalin e Vasilit të Dhimos, kishte edhe Sotiri një çupë, por ishte e mitur! E mitur, posi, por do bëhet, ama, do bëhet edhe për nuse.

I rrahu zemra fort, ja, ashtu si trokthi i një kali në pranverë... U fut tashmë në pyll dhe kërkonte me sy manarët e drejtë të aheve. E gjeti një jo larg dy pishave. E mati edhe një herë me syrin e stërvitur të druvarit. Filloi nga «hë»-të me të rrahurën e sëpatës. S'shkoi shumë dhe druri u platit mbi dëborë duke thyer degëzat e gjata. E krasiti shpejt dhe i la vetëm një degë të njomë e të fortë në krye, si oputë, për ta tërhequr. Dita kishte kthyer. Plaku e dinte se tani nuk kishte shumë kohë; ja, sa të thyhej pasditja, do të errësohej e nëpër pyll do të endeshin egërsirat. Do të fillonte edhe e ftohta, e ftohta e hidhur e malit.

Hodhi sëpatën në parakrah, afër pëllëmbës, mbërtheu drurin në degën oputë dhe e çoi në lartësinë mbi gjoks. U vu për rrugë në të tatëpjetë. Çapitej ngadalë në borën e butë, që i arrinte deri afër gjunjëve.

«Kështu nuk qenka keq, — mendoi Plaku.

— Sa të arrij te mulliri... Pastaj është e përpjetë. Po le të jetë, atje është më afër fshati, ama.» Fundin e drurit që tërhiqte e kishte lëshuar mbi ujin e jazit që rridhte në mulli. Vetë qëndronte në anë.

— Të ndih edhe uji, o Plak, — i thoshte vetes, — gjer te mulliri, ja, mirë kështu, po mandej...? Mandej do ta kesh ca zor në të përpjetë. — Arriti te kumbulla e egër mbi jaz. Këtu kishte qenë atëherë, kur i biri i kishte sjellë lajmin se i kishte lindur e reja djalë. U kujtua përsëri për foshnjën që prisnin t'u lindte. U mbush me frymë dhe eci përpara, i sigurt, nëpër tragën e ngushtë të dëborës. Filloi e ftohta. Fundi i drurit në vijën e ujit u përplas pas një guri të madh dhe druri e tërhoqi Plakun fort me vete. Ai u lëkund dhe u rrëzua galiç me dy këmbët dhe njërenë dorë në ujë.

— Ptu, — shau nëpër dhëmbë. — Pleqëri, pleqëri! — Nënqeshi hidhur. Shkundi dëborën me dorën e lagur dhe kapi degën e manarit. Ecte ngadalë. Këmbët gjithnjë e më shumë po i mardhnin. Edhe një herë gati po rrëzohej, por u mbajt pas degëve dhe shkurreve. Pastaj, fare afër, shqoi mullirin përmes degëve të zhveshura. Mbështeti manarin mbi strehët e mbuluara nga bora. Fytyrën e kishte të dirsur dhe vetullat i kishin zënë fijëza akulli nga e ftohta. U ul të çlodhej.

— Do të çlodhesh pak, fare pak, — i tha

vetes, — se ashtu e do puna. — Iu bë se dëgjoji hungërimën e bishave.

— Të bëjnë veshët, o Plak, edhe erën s'e dallon dot prej ujkut. — U kot pak mbi gurin e sofatit, pastaj u çua. Fijëzonte borë e rrallë. Ngriti kokën drejt qiellit të errët. Mbërtheu degën e ahut mbi gjoks dhe çau dëborën në të përpjetë. Nuk mundi gjatë.

Ja, ja, sa të nxehen këmbët e lagura, dhe... Dëbora çahet ngadalë, duke lënë pas një vijë të thellë. Eci një metër... tre... dhjetë... «Krap», «krap», «krap», kërciste dëbora nën këmbët e tij. Në fillim ngadalë, pastaj më shpejt. Frynte erë dhe bora që binte ishte dendësuar. Qëndroi. Ngriti lart mbi gjoks degën oputë të drurit, e mbërtheu mirë me dorë trupin e manarit që zgjatej pas tij dhe filloi të ecte. Çorapet e leshta i ishin kallkanosur me borë e i kishin zënë bilbila akulli. Manari linte vrage. U dëgjua për herë të parë hungërima e ujqve. Ai ktheu kokën drejt mullirit.

— Bëj durim, o Plak, bëj durim. Të presin, dëgjon? Të pret dhoma e Partizanit, të pret Plaka, djemtë, të pret Dritani, bre, — tha për nipin e rritur, — ja, atje në breg do ketë dalë. Hajde, hop. — E çoi drurin peshë nga frika se mos i rrokullisej nga monopati. Eci pak metra dhe ndjeu t'i shteronin fuqitë.

— Hë, — u tha këmbëve me të butë duke i përkëdhelur dhe fërkuar me dorë. — Bëhuni trime. Edhe pak, ja, deri në kodër, pastaj... Pastaj një zë dhe vjen gjithë fshati po të doni...

«Kërëk, kërëk, kërëk», shtypej bora.

Një hap, dy... Përpara se të rrëzohej, qëndroi.

«Kërëk, kërëk, kërëk», u rrëzua me fytyrën e skuqur të kredhur në borë. U çua dhe buzëqeshi hidhur.

— Mos, bre Plak, e lësho veten. — Një hap, dy... Manarin e shtrëngonte fort nën sqetull dhe me dorën tjetër degën e tij mbi gjoks. Bregu tani nuk do të ishte edhe shumë larg. Vështroi andej, po bora e dendur dhe era e pengonin.

U dëgjuan ulërime ujqish më afër. Nuk i erdhi mirë.

— Ata punën e tyre, unë timen, — tha me mospërfillje. U rropat edhe një herë për rrugë. Një hap, dy... U rrëzua. Druri i ahut e mori nën vete. Ndjeu të sëmbuar në ijë.

— Hë, Plak, Plak! Nuk e ke mirë kështu! — E lëshoi drurin ngadalë nën vete dhe u ul mbi të. I dhimbnin ijët sa s'mbushej dot me frymë. Poshtë shtrihej lugina e vogël dhe më tej mulliri. Picërroi sytë nëpër mjegullën e borës. Qepallat i rëndonin.

— Hë, ja, do vijë, do vijë përsëri pranvera. — Iu bë se atë luginë të vogël në mes të malit e shihte të avullonte më nge dhe të derdhte plisat e zinj e të thërrmuar si bukëvale. Atë lëndinë, më të mirën e fshatit, e punonin të gjithë bashkë. Vinin edhe gjyrsarët për ndihmë. Dilte edhe Plaku. E mbillnin me grurë e me patate. Edhe për këtë pranverë me patate e kishte radhën të mbillej.

— Sivjet do bërë e re edhe avllia rreth shtëpisë, se ka dy vjet që i kanë rrjedhur gurët. Poshtë avllisë së tyre shtrihej fusha e paktë e fshatit: gjithë-gjithë tri ngastra tokë. Atë që zinte fill tek avllia e shtëpisë së tij e punonte çdo vit Plaku. Dhe ata të kooperativës e kishin fjetur mendjen prej saj.

E ai do t'i përvishej edhe këtë pranverë. Atje mbi avlli do të qëndronte plaka me të nipin e porsalindur, nga nusja e djalit të dytë. Djalë do të bënte, doemos, se nusen e kishte të mirë. Do të mblidhte njëherë gjethet e thata të pemëve dhe kërcejtë e kopanishtat gjysmë të kalbura. Do t'u vinte zjarrin në qoshen e arës, si çdo vit. Dritani do të mblidhte gurët e vegjël. Ç'gurë, xhanëm! Ata i mblidhte vetë Plaku, po Dritani do të luante pranë zjarrit me ndonjë lastar të prerë nga mollët. Pastaj do ta lëronte tokën gjer në mbrëmje vonë, kur fryn era e vakët e fushës e të than djersën mbi gjoks.

U shkund dhe u çua. Mbërtheu manarin me duar dhe bëri të nisej. Gjunjët s'i bindeshin.

— Hë, de, hë, se do merakosni tërë fshatin!
— tha si me ankim. U lëkund mbi dëborë sa majtas e djathtas dhe në vend.

— Ho ho, ç'është kështu me ty, o Plak, —
tha me përbuzje dhe mëri. Mblodhi të gjitha forcat dhe... Krap, krap, krap, ngjishej bora. Ecte. Lëkundej sa majtas e djathtas. Ecte, ecte.

— Ja, edhe pak, ja, edhe pak, — i thoshte

vetes Plaku me të lutur. Iu bë se dalloi dritat e fshatit.

— Vërtet duken dritat e fshatit? — Dëbora binte e dendur. I buçitnin veshët. Tani edhe ulërimën e erës dhe të egërsirave nuk e dëgjonte më. Edhe për të ecur, nuk po e kuptonte më, ecte apo qëndronte i mbërthyer në vend. Duart i ishin gozhduar mbi dru dhe nuk donin ta lëshonin. Bora binte me flokë të dendur. Iu bë se dëgjoi të lehurat e një qeni dhe kanatin e portës së Taqos që hapej duke u fërkuar pas pllloçave të oborrit. Iu bë se dëgjoi të qarën e një fëmije.

— Nipi, nipi qan kështu. I porsalinduri qan kështu me zë të hollë. — Vetullat dhe flokët mbi ballë i ishin bërë si strehë. Iu bë se e thirrën.

I vure në merak djemtë dhe tërë fshatin, o Plak. Ja, po të thërresin. Apo dëgjohet uji i çezmës që rrjedh nëpër sylinjarë?

Po, edhe uji dëgjohet. Dëgjohet që rrjedh nëpër pllloçat e rrugëve. Edhe trokashka e mullirit dëgjohet.

Pastaj iu bë se e thirrën fare afër.

— Plak, o Plaaak! — Oshëtiu tërë pylli: — Plaaaak! Pastaj vuri buzën në gaz e iu bë se hodhi në sup manarin e drurit të ahut që mbannte shtrënguar në duar dhe nxitoi me hap të shpejtë në tragën e ngushtë hapur mbi dëborë.

Ngado e thërritnin:

O Plaaaak... Dhe pylli oshëtinte: O Plaaaak! Dhe trokashkat e drunjta të mullirit thërritnin: O Plaaaak... Dhe njerëzit e fshatit të tij të madh thërritnin: O Plaaak! O Plaaak... o Plaaak...